



المؤسسة الإسلامية للشباب

**Fondazioni i Rinisë Islame**  
**Stiftung der Islamischen Jugend**  
**Foundation of Islamic Youth**

---

Seebacherstrasse 67  
CH-8052 Zürich  
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

[www.islamischen.ch](http://www.islamischen.ch)  
✉ [Islamischen@freesurf.ch](mailto:Islamischen@freesurf.ch)  
[info@islamischen.ch](mailto:info@islamischen.ch)

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

# SHENJA MË E MADHE

Sejjid Nursi

Botuar nga: Sozler

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

NJË PARALAJMËRIM DHE TREGIMI I QËLLIMIT .....	4
PARATHËNIE.....	6
PROVAT E EKZISTENCËS SHENJA MË E MADHE.....	15
KAPITULLI I PARË.....	15
SHËNIM:.....	84
KAPITULLI I DYTË.....	85
PROVAT E NJËSISË HYJNORE.....	85
E VËRTETA E PARË – ABSOLUTE.....	86
E VËRTETA E DYTË: PERËNDIA ABSOLUTE.....	87
E VËRTETA E TRETË: PËRKRYERJET DHE PLOTËSIMET.....	88
E VËRTETA E KATËRT: SOVRANITETI ABSOLUT.....	89
MISTERI I PARË:.....	101
MISTERI I DYTË:.....	102

## **NJË PARALAJMËRIM DHE TREGIMI I QËLLIMIT**

Jo gjithkush do të jetë i mundur t'i kuptojë të gjitha çështjet e trajtuara në këtë libër tepër domethënës, por askush nuk do të mbetet pa pjesë. Në qoftë se dikush do të hynte në një kopsht, është e kuptueshme se duart e tij nuk mund të arrijnë të gjitha frutet që ndodhen në të; por sasia që ai do të kapë do të ishte për të e mjaftueshme; kopshti nuk ekziston vetëm për të; ai ekziston edhe për ata, krahët e të cilëve janë më të gjatë se të tijat. Ndodhen pesë shkaqe që e bëjnë këtë libër të vështirë për t'u kuptuar.

**I PARI:** Unë i kam shkruar vërejtjet sipas shkallës sime të të kuptuarit e për vete dhe nuk i kam shkruar sipas shkallës së të kuptuarit dhe konceptimit të të tjerëve, siç është rasti me librat e tjerë.

**I DYTË:** Meqënëse realiteti i Njësisë Hyjnore është zhvilluar në këtë libër në shkallën më të gjerë, nëpërmjet treguesit të *“Emrit më të madh hyjnor”*, çështjet e diskutuara janë tej mase të gjëra, shumë të thella dhe nganjëherë mjaftë të gjata. Gjithësecili nuk mund t'i marrë vesh këto çështje menjëherë.

**I TRETË:** Meqënëse çdo çështje përbën një të vërtetë të madhe e të gjërë, një fjalë e vetme ndonjëherë zgjatet sa e gjithë faqja ose më shumë. Kjo bëhet me qëllim që të mos thyhet e vërteta në diskutim. Prandaj ndodhen shumë shënime para-prake për një provë të vetme.

I KATËRTI: Meqë pjesa më e madhe e çështjeve të përfshira në këtë libër ka shumë prova e dëshmi, diskutimi nganjëherë bëhet fjalëshumë nga përfshirja e dhjetë ose njëzet provave nëpërmjet një demonstrimi. Dhe aftësitë e kufizuara mendore nuk mund ta kapin.

I PESTI: Është e vërtetë që unë e mora treguesin e dritave të këtij libri nga shkëlqimet e Ramazanit. Veçse libri u shkrua me nxitim dhe u mjaftova me draftin e parë; Në kohën kur trupi im ishte rrënuar nga sëmundja, unë ndjeva për më tepër se nuk po shkruaja me vullnetin e me dëshirën time, por gjithçka më vinte në zemër. Kështu nuk e pashë me vend të risistemoja apo të rindreqja ato që kisha shkruar sipas mendimeve të mia. Kjo bëri që libri të bëhej i vështirë në të kuptuar.

Por, pavarësisht nga mangësitë dhe vështirësitë që vijnë nga këto pesë shkaqe, kjo trajtesë ka një rëndësi shumë të madhe...

Kjo trajtesë që është një realitet i *“Shenjës më të madhe”* dhe koment i saj, është rrezatimi i shtatë (nga koleksioni i rrezatimive) dhe prova e parë e besimit (nga koleksioni - Shkopi i Musait *alejhis-selâm*)

Kjo trajtesë përbëhet nga një parathënie dhe nga dy kapituj. Parathënia sqaron katër çështje të rëndësishme; kapitulli i parë përmban në arabisht komentin e *“Shenjës më të madhe”*, ndërsa kapitulli i dytë shtjellon argumentet e kapitullit të parë.

Shumë është shpjeguar në parathënien që vijon, por nuk ka qenë qëllimi për t’u zgjatur kaq në të. Fakti që u shkrua kështu gjatë- tregon nevojën e këtij shkrimi. Në realitet, disa njerëz mund ta vlerësojnë atë shumë të shkurtër pavarësisht nga gjatësia që ka...

## PARATHËNIE



وَمَا خَلَقْنَا الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا عِبَادًا

Me Emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

“Unë nuk i krijova xhindët dhe njerëzit veçse që ata të Më adhurojnë”.<sup>1</sup>

Nga misteri i këtij verseti madhështor kupto-het se qëllimi dhe urtësia e ardhjes së njeriut në këtë botë janë:

Njohja e Krijuesit të Gjithësisë; besimi tek Ai si dhe adhurimi i Tij. Atëherë detyra themelore e njeriut dhe obligimi që i kërkohet janë: të njohë Zotin e Lartësuar e t'i besojë Atij; të pranojë ekzistencën dhe Njësinë e Tij me përlësi, nënshtrim e me besim të sigurtë e të plotë. Sepse njeriu që, për nga natyra e tij, dëshiron jetë të përhershme dhe ekzistencë të pavdekshme; Ai që shpresat e të cilit kundërshtohen nga dhimbje e vuajtje të panumërta për të, çdo objekt apo plotësim

---

<sup>1</sup> Kur'an, 51: 56

përveç besimit në Zot dhe përveç mjeteve që të çojnë tek ai besim, i cili është themeli dhe çelësi i asaj jete të përhershme, duhet të vlerësohen si të ulëta e madje të zhvlerësohen në shumicën e rasteve.

Meqenëse kjo e vërtetë është provuar me dëshmi e argumente të fuqishme tek: “*Trajtesa e dritës*”, ne do t'i refero-hemi komentit të saj duke e shtjelluar këtu, brenda strukturave të katër çështjeve, vetëm dy humnera, të cilat në këtë shekull trondisin sigurinë e besimit dhe ngjallin hezitim. Mjetet e shpëtimit nga këto dy humnera janë këto dy çështje:

ÇËSHTJA E PARË: Siç u vërtetua hollësisht tek “*Shkreptima e trembëdhjetë*” e “*Letrës së tridhjetë e një*” tek e cila thuhej:

Për shembull: Në lidhje me shikimin e hënës së re në fillim të muajit të Ramazanit, në qoftë se dy njerëz të zakonshëm e vërtetojnë shfaqjen e hënës së re me dëshminë e tyre dhe ndërkohë me mijëra dijetarë e njerëz të ngritur e mohojnë një gjë të tillë duke thënë: “Ne nuk e kemi parë atë,” mohimi i tyre është i pavlefshëm e i pafuqishëm për të bindur. Sepse kur është fjala për të vërtetuar ose provuar, çdo njeri përforcon dhe mbështet tjetrin duke bërë të arrihet konsensusi. Ndërsa kur bëhet fjalë për mohimin, atëherë s'do të kishte ndryshim midis një njeriu apo një mijë njerëzve se nga cili buroi mohimi. Këtu secili qëndron i vetmuar e i veçuar: Ai që vërteton a provon diçka, shikon matanë vetvetes dhe e gjykon çështjen ashtu siç është. Kështu në shembullin që dhamë, në qoftë se dikush thotë: “Hëna është në qiell” dhe ndërkohë shoku i tij e mbështet dhe e vërteton duke drejtuar gishtat e tij nga hëna, këta të dy bashkohen e përforcohen në gjykimin dhe vërtetimin e tyre. Kurse në lidhje me mohimin dhe mospranimin, mohuesi nuk e

shikon çështjen ashtu siç është dhe nuk mund ta bëjë një gjë të tillë. Prandaj ekziston parimi i mirënjohur: *“Mohimi i papërvaktuar dhe jo i drejtuar te vendi i veçantë, nuk mund të provohet.”*

Për shembull: Në qoftë se unë vërtetoj ekzistencën e diçkaje në botë, ndërkohë që ti e mohon atë, unë me lehtësi mund ta konfirmoj me një tregues të vetëm ekzistencën e saj.

Kurse ti, që të justifikosh mohimin tënd, domethënë të vërtetosh mosekzistencën e sendit, duhet të kërkosht plotësisht anë e mbanë botës, madje të kontrollosh çdo aspekt të shekujve të kaluar. Vetëm atëherë ti mund të thuash: *“Ajo gjë nuk ekziston, dhe kurrë nuk ka ekzistuar.”*

Meqenëse ata që e mohojnë nuk e shohin çështjen ashtu siç është, por e gjykojnë sipas dëshirave, mendjeve dhe vizioneve të tyre, ata kurrësesi nuk do të forcojnë e mbështesin njëri-tjetrin, pasi tek ata perdet e shikimit janë të ndryshme, gjithashtu janë të ndryshme tek ata edhe shkaqet që i pengojnë ata nga njohja;

Ndonjëri mund të thotë: *“Unë nuk e shoh atë gjë; prandaj sipas mendimit dhe besimit tim ajo nuk ekziston.”* Por asnjëri nuk mund të thotë: *“Ajo gjë në fakt nuk ekziston.”* Në rast se dikush e shpreh këtë mohim, sidomos në çështjet e besimit, të cilat përfshijnë të gjithë universin-fjala e tij është një shpifje e një gënjeshtër e madhe sa vetë bota. Ai që e shpreh këtë nuk mund të flasë të vërtetën dhe fjala e tij kurrë nuk mund të jetë e drejtë e të korrigjohet.

Shkurtazi, përfundimi është një i vetëm në rastin e pohimit dhe çdo shembull pohimi mbështet të gjithë shembujt e tjerë. Kurse mohimi nuk është një i vetëm por shumë; shumllojshmëria buron nga thënia e çdo njeriu në lidhje me vetveten, si: *“Mendimi im ose pikëpamja ime është...; Unë besoj se...”* si dhe shkaqe të tjera të cilat mbulojnë shikimin e saktë dhe shtohen e ndryshojnë sipas

personave. Prandaj përfundimet janë të shumta e të veçuara. Si rrjedhojë nuk arrihet mbështetje e plotë.

Duke u nisur nga ky realitet me të cilin filluam: *“S’ka rëndësi pse shumica e jobesim-tarëve dhe e mohuesve kundërshtojnë besimin....”* Por tani, në kohën kur është e domosdoshme të mos ndikohet siguria e besimit të besimtarët e të mos i lëkundet nga asnjë lloj dyshimi e hezitimi, ne shohim në këtë kohë se mohimet e filozofëve të Evropës kanë shkaktuar dyshim të një numër syleshësh të mjerë duke shkatërruar kështu sigurinë e besimit të tyre dhe duke u zhdukur atyre lumturinë e përhershme. Sepse ky mohim i tyre e ka transformuar kuptimin e vdekjes, e cila godet çdo ditë me mijëra njerëz, nga kuptimi i vërtetë i saj si përfundim i misionit të njeriut në tokë, duke e kujtuar atë si një formë e asgjësimit të përher-shëm, si kapitullim i plotë dhe fund i tmerrshëm; varri me derën e tij gjithnjë të hapur, në mënyrë të vazhdueshme kërcënon mohuesin me asgjësim dhe helmon jetën e tij me dëshpërimet me të hidhura. Atëherë vlerësoje sa i madh e i bekuar është besimi dhe mirësia e tij dhe kupto gjithashtu se ai është esenca e jetës.

**ÇËSHITJA E DYTË:** Në lidhje me një problem që i nënshtrohet diskutimit në një art apo artizanat, ata që qëndrojnë jashtë rrethit të atij arti apo artizanati nuk mund të flasin me siguri e besueshmëri sado të mëdhenj të jenë, të arsimuar apo të shquar, as gjykimet e tyre nuk mund të pranohen si vendimtare. Gjithashtu ata nuk mund të hyjnë në grupin e dijetarëve të konsensusit të artit.

Për shembull: Gjykimi i një inxhinieri të madh në diagnostikimin dhe kurimin e një sëmundjeje nuk e ka të njëjtën vlerë as me atë të mjekut më të ulët. Kështu, në mënyrë të veçantë, fjalët e mohimit të një filozofi materialist nuk kanë peshë e vlerë, sidomos të atij që largohet vazhdimisht

nga shpirtërorja, që është i pagdhundur e më i pandjeshëm për dritën dhe që inteligjenca e të cilit është ngushtuar vetëm tek ajo çka i sheh syri... Fjalët e një njeriu të tillë janë të pavlefshme për t'u marrë në konsideratë në lidhje me çështjet shpirtërore.

Në çështjet e shenjta shpirtërore e në ato që lidhen me Njësinë Hyjnore ka një konsensus të plotë midis qindra e mijëra dijetarëve nga popuj të besimit të tillë si *Shejh Gejlani (k.s.) (u shenjtëroftë sekreti i tij)*, i cili pa fronin e lartë të All-llahut, ndërsa vetë ishte akoma në tokë, e që u përpoq për nëntëdhjetë vjet duke u ngjitur me punë të drejta në gradat shpirtërore derisa iu zbuluan të vërtetat e besimit në të trija format e sigurisë.

Meqenëse gjendja është kështu, çfarë vlere kanë fjalët e filozofëve? A nuk është kundërshtimi dhe mohimi i tyre aq i mbytur e i ulët sa që i ngjason zukatjes së një mushkonje para gjëmimit të rrufesë?

Esenca e mosbesimit që kundërshton të vërtetat e Islamit dhe lufton kundër tyre është: *“mobim”*, *“inJORANCë”* dhe *“mospranim”*. Edhe në qoftë se në formën e jashtme ajo të duket se është një mohim i ndonjë lloji apo një tregues ekzistence, megjithatë, në realitet është mohim e mosqenie. Kurse besimi është *“njohje”*, *“ekzistencë”*, *“pohim”* dhe *“gjykim”*. Madje edhe një aspekt negativ i fesë është derë për një realitet pozitiv ose një perde që e mbulon atë.

Në qoftë se jobesimtarët të cilët luftojnë kundra besimit, do të përpiqeshin me vështirësinë më të madhe të pohojnë e pranojnë besimet e tyre negative e t'i bëjnë ato të pranueshme në formën e *“pranimit të mosqënies”* e të *“besimit për të paqenën”* atëherë mosbesimi i tyre nga një aspekt mund të vlerësohet si një formë njohjeje ose gjykim i gabuar, ndërsa në lidhje me *“mospranimin”*, *“mobimin”* dhe *“refuzimin”* diçka që bëhet lehtë, kjo është inJORANCë absolute dhe mungesë e plotë gjykimi.

Bindjet që ndodhen në mosbesim janë dy llojesh:

I pari nuk e jep vlerësimin e të vërtetave të Islamit. Ky është një pranim i gabuar, besim i pabazë dhe gjykim i padrejtë i veçantë për të. Ky lloj mosbesimi është jashtë objektit të bisedës sonë; ai nuk ka lidhje me ne, as ne nuk kemi lidhje me të.

Lloji i dytë kundërshton të vërtetat e besimit dhe lufton kundra tyre. Edhe ky është dy llojesh:

I pari është refuzim. Ai përbëhet thjesht nga mospranimi për të pohuar. Ky mohim është një lloj injorance ose mosgjykim dhe ndodh lehtë. Edhe ky lloj është jashtë objektit të diskutimit tonë.

I dyti është pranim i mosqenies, është pranim me zemër i të paqenës; ky lloj mohimi është gjykim dhe i shkakton njeriut konformizëm (nënshtrim) dhe si rrjedhojë detyrohet të pohojë mohimin e vet. Ky mohim përfshin dy lloje:

I pari thotë: Ndonjë gjë nuk ekziston në një vend të caktuar ose në një drejtim të caktuar. Ky lloj mohimi i përcaktuar mund të provohet, por edhe ky qëndron jashtë diskutimit tonë.

I dyti përbëhet nga mohimi e mospranimi i çështjeve të shenjta të besimit, të përgjithshme e gjithpërfshirëse, të cilat lidhen me këtë botë, krijimin, botën tjetër, dhe vijueshmërinë e epokave të ndryshme. Ky lloj mohimi, siç e vërtetuar në çështjen e parë, nuk mund të provohet absolutisht, sepse ai kërkon që të ketë një vizion gjithëpërfshirës për universin, të shikojë botën tjetër e të vështrojë pa kufi çdo aspekt të kohës.

Humnera e dytë dhe mjetet për të shpëtuar nga ajo: Edhe kjo përbëhet nga dy çështje:

E PARA: Mendjet që ngushtohen para *“madhështisë”*, *“madhësisë”* dhe *“pafundësisë”* dhe neglizhojnë për të kuptuar përfundimin e shkujdesjes e të mëkatit ose janë zhytur në botën materiale e piren pas asaj. Këto mendje nxitojnë në mohim dhe nuk pranojnë nga krenaria për njohuritë që kanë çështjet e mëdha për shkak të paaftësive të tyre për t'i përfshirë ato. Vërtet! Ata nuk mund të kapin çështjet shumë të gjera e të thella të besimit brenda mendjeve të tyre të ngushta e të thata, domethënë t'i vërtetojnë ato në zemrat e tyre të prishura e të vdekura ndaj aspekteve shpirtërore.

Ata hedhin vetveten në mosbesim, në ç'udhëzim e mbyten. Ata po të mundeshin të shikonin natyrën e vërtetë të mosbesimit të tyre si dhe esencën e ç'udhëzimit, do të shihnin se ajo që është e pranueshme në besim për *“madhësinë”*, e përshtatshme me të dhe e domosdoshme kundërshtohet nga mosbesimi i tyre, i cili përmban e fsheh absurditete të shumta e pamundësi .

Risalein-Nur (*“Trajtesa e dritës”*) e ka provuar këtë të vërtetë me qindra krahasime që dalin me të njëjtin përfundim si: dy dhe dy bëjnë katër.

Për shembull, ai që nuk pranon besimin e domosdoshmërisë së ekzistencës së Tij që është i Lartësuar, që nuk pranon përjetësinë dhe atributet gjithpërfshirëse të Krijuesit Fuqiptotë, madhësh-tinë e Tij dhe madhështinë e attributeve të Tij të Larta, atëherë ai do ta transformonte domos-doshmërinë e egzistencës së Krijuesit, përjetësinë e Tij që i takon gjithëlavdia dhe atributet e Tija Hyjnore duke i kaluar ato tek të gjitha qeniet e papërcaktuara në numër, madje tek një infinit atome, që të mundej të pranonte mohimin e tij ose të braktisë mendjen , ashtu si sofistat idiote duke mohuar si qenien e tij po ashtu edhe atë të krijesave.

Prandaj të gjitha të vërtetat e imanit (besimit) dhe Islamit mbështeten tek *“madhështia”* e cila është dinjiteti i atyre të vërtetave dhe e kërkuar nga natyra e tyre. Ato të vërteta vendosen në zemrat e



يَا مَنْ لَمْ يَمْلِكِ الْأَمْوَالَ ۝ يَا مَنْ لَا يُحْصِي الْعِبَادَ شِتَاكَهُ  
 يَا مَنْ لَا تَصِفُ الْحَلَاقُ جَلَالَهُ ۝ يَا مَنْ لَا يَسْأَلُ الْأَوْهَامَ كُفْتَهُ  
 يَا مَنْ لَا يَذْرُوكُ الْأَبْصَارَ كَالَهُ ۝ يَا مَنْ لَا يَنْبَغُ الْإِفْهَامُ صِفَانَهُ  
 يَا مَنْ لَا يَسْأَلُ الْأَفْكَارَ كِبْرِيَانَهُ ۝ يَا مَنْ لَا يُحْسِنُ الْإِنْسَانُ نَعْوَتَهُ  
 يَا مَنْ لَا يَرُدُّ الْعِبَادَ قَضَائَهُ ۝ يَا مَنْ ظَهَرَ فِي كُلِّ شَيْءٍ آيَاتُهُ  
 سُجَّانَكَ يَا لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ الْأَمَانُ الْأَمَانُ نَجِّنَا مِنَ الْبِتَارِ

- Ti që përveç mbretërisë Tënde, asnjë mbretëri nuk ekziston;
- Ti që lëvdatat e Tua nuk mund të numërohen nga shërbëtorët e Tu;
- Ti që lavdia Jote nuk mund të përshkruhet nga krijesat e Tua ;
- Ti që plotësimi Yt shtrihet përtej të gjitha vizioneve;
- Ti që Atributet Tua kalojnë të gjitha limitet e të kuptuarit;
- Ti që madhështia Jote është përtej kapjes së mendimit e perceptimit;
- Ti që cilësitë e Tua njeriu nuk mund t'i përshkruaj siç duhet;

O Ti që vendimin dhe caktimin tënd nuk mund ta kthejnë robërit e Tu;

O Ti që shenjat e Tua janë shfaqur në çdo gjë.”

“Ty të takon Lavdia, nuk ka zot tjetër përveç Teje, na mbro, na mbro. Na shpëto nga zjarri.”

Të gjitha këto tregojnë: madhështi, krenari e lavdi dhe përbëjnë një perde të domosdoshme.

## PROVAT E EKZISTENCËS SHENJA MË E MADHE KAPITULLI I PARË

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ  
سُبْحَانَ اللَّهِ السَّمَوَاتِ السَّبْعِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ  
إِلَّا يَسُبِّحُ بِحَمْدِهِ وَلَكِنْ لَا تَفْقَهُونَ تَسْبِيحَهُمْ أَنَّهُ كَانَ خَلْقًا عَفْوًا

“Shtatë qiejt dhe toka dhe të gjitha qeniet brenda tyre ngrejnë lart lavdërimet e Tij; Nuk ka ndonjë gjë veçse i thur lavde Atij; Por ju nuk e kuptoni se si ato përlëvdojnë. Sigurisht Ai është shumë Zemërgjerë e Fajëfalës” (Kur'an, 17: 44)

[Ky mekam (vendqëndrim) i dytë, përveç shpjegimit të këtij ajeti madhështor, sqaron gjithashtu provat e stacionit të parë që është trajtuar në arabisht, por i përkthyer këtu].

Megenëse ky verset i lartë, ashtu si versetet e tjera kur'anore, përmend së pari qiejt, atë faqe brilante që deklaroi Njësinë e Zotit të Lartësuar, njerëzit në të gjitha kohët kur hedhin vështrimin tek qiejt mbeten të çuditur, të mahnitur e të gëzuar, sepse në vështrimin e tyre është shpallja e Krijuesit të këtij kozmosi. Atëherë le të fillojmë edhe ne me qiejt.

Në të vërtetë, çdo udhëtar që vjen në bujtinën dhe mbretërinë e kësaj bote, sa herë që hap sytë e sodit, shikon Atë të Gjithmëshirshëm e Bujar, i Cili është Pronari i kësaj bujtine, sheh një ekspozitë shumë të mrekullueshme, shikon një kamp stërvitor shumë madhështor, dhe një vend argëtimi shumë të këndshëm e tërheqës, sheh një libër të hapur i cili është shumë i thellë në kuptime e plotë urtësi. Ndërkohë udhëtari pyet: kush është autori i këtij libri të madh? Dhe kush është sundimtari i kësaj mbretërie të lartë? Në këtë moment prezantohet tek ai faqja e bukur e qiejve e përshkruar me mbishkrimin e hijshëm të yjeve. Ajo faqe i thërret atij duke i thënë:

*“Më shih mua dhe unë do të të jap mundësinë të njohësh atë që kërkon.”* Atëherë udhëtari hedh vështrimin dhe shikon se një tregues i artit Hyjnor po kryen detyra të ndryshme në qiell. Disa nga ata trupa janë njëmijë herë më të mëdha se toka dhe kanë një lëvizje rrotullimi shtatëdhjetë herë më të shpejtë se predha. Ai tregues i bën ata trupa të lëvizin shpejt, në harmoni e pa u përplasur me njëri-tjetrin; Ai u shkakton atyre kandilave apo llambave të ndizen vazhdimisht pa përdorur vaj; Ai i drejton ato pafundësi trupash pa asnjë zhurmë, defekt apo çrregullim; Ai tregues ka caktuar diellin dhe hënën - ato trupa të mëdhenj qiellorë që të kryejnë detyrat e tyre përkatëse pa u përplasur me njëri-tjetrin; Ai administron brenda një largësie e një hapësire të pafund midis dy

poleve e gjithçka që ekziston, duke i drejtuar në të njëjtën kohë, me të njëjtën fuqi e në të njëjtën mënyrë pa mangësinë më të vogël; Ai i nënshtron ato trupa të mëdhenj qiellorë të cilët kanë në vetvete fuqi natyrore të pallogaritshme;

Ai u shkakton atyre trupave të manovrojnë si një ushtri e disiplinuar mirë dhe atëherë duke e bërë tokën të rrotullohet gjatë natës e ditës, Ai i shfaq qiejt në çdo natë e në çdo vit në forma të ndryshme, si një ekran kinemaje me anë të të cilit i tregohen audiencës së krijimit skenat e vërteta dhe ato të përfytyruara. Kjo madhështi e dukshme dhe ajo e vërtetë që shfaqet brenda veprimtarisë Hyjnore përbëhet nga nënshtrimi, organizimi, administrimi, rrotullimi, rregulli, pastrimi e komandimi. Kjo e vërtetë me madhësinë e gjithpërfshirjen dëshmon për domosdoshmërinë e ekzistencës dhe Njesisë së Krijuesit të qiejve si dhe vërteton se ekzistenca e Tij është më e qartë dhe më e dukshme se e qiejve.

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْوَاحِبُ الْوَجُودِ الَّذِي دَلَّ عَلَى وُجُوبِ وُجُودِهِ فِي وَحْدِيهِ  
السَّمَوَاتُ يَجْمَعُ مَا فِيهَا بِشَهَادَةِ عَظَمَةِ إِحْاطَةِ حَقِيقَةِ النَّجْدِ وَالْتَدْبِيرِ  
وَالْتَدْوِيرِ وَالتَّطْيِيمِ وَالتَّطْوِيفِ وَالتَّوْطِيفِ الْوَاسِعَةِ الْمَكْمَلَةِ بِالشَّهَادَةِ

Pastaj ai vend tubimi çudirash i njohur si hapësirë apo atmosferë, i thërret me zë buçitës atij udhëtari që vjen si mik në këtë botë duke i thënë: “Më shiko mua! Ti mund të zbulosh e të gjesh nëpërmjet meje objektin e kërkimit tënd, Atë që të dërgoi ty këtu! Ndërkaq udhëtari shikon tek fytyra e hidhur, por e mirë e atmosferës dhe dëgjon bubullimat e frikshme por të gëzueshme të rrufesë dhe kupton se: Retë e varura midis qiellit dhe tokës po ujisin kopshtin e botës në mënyrën më të mëshirshme me një urtësi të madhe, furnizojnë banorët e tokës me ujën e jetës, zbusin

nxehtësinë e jetës dhe shpejtojnë të japin ndihmesë kudo që të jetë e nevojshme. Megjithëse këto re të rënda kryejnë funksione të shumta, si këto që u përmendën dhe detyra të tjera, retë e mëdha të afta për të mbushur qiellin, ndonjëherë fshehin vetveten duke u tërhequr të gjitha pjesët e tyre për të pushuar, në atë mënyrë që asnjë gjurmë nuk mund të shihet, tamam si një ushtri me disiplinë të fortë e cila shfaq dhe e fsheh vetveten konform urdhërave të befasishme. Dhe me dhënien e urdhërit për të zbrazur shi, retë mblidhen për një orë, ose për pak minuta; mbushin qiellin dhe presin në gatishmëri të plotë ashtu si ushtari që pret urdhërin e komandantit për veprim.

Më vonë udhëtari vështron erën në atmosferë dhe sheh se ajo përdoret në shumë detyra e funksione me urtësi të madhe e bujari. Është tamam sikur çdo atom i pajetë e i pavetëdijshëm të dëgjonte apo vërente urdhërat që i vijnë nga komandanti i të gjitha qenieve pa harruar asnjë nga ato detyra dhe i zbaton ato në formën e urdhëruar me anë të fuqisë së Atij komandanti. Si rrjedhim Ai u jep frymëmarrje të gjitha qenieve dhe u çon lëndët e nevojshme të gjitha gjallesave si, nxehtësinë, dritën, elektricitetin. Ajri, gjithashtu ndihmon në pjalmimin e bimëve. Të gjitha funksionet e përgjithshme dhe shërbimet tregojnë se ai vihet në shërbim, nga një dorë e fshehtë, në mënyrën më të vetëdijshme, më me njohuri dhe më jetëdhënëse.

Atëherë udhëtari shikon shiun dhe sheh se brenda atyre pikave të buta, të shndëritshme e të ëmbla të sjella nga thesari i fshehur i mëshirës, ndodhen shumë dhurata të mëshirshme e funksione sikur vetë mëshira e dhuruar të mishërohej duke u derdhur nga sytë e thesarit hyjnor në formën e atyre pikave. Është kjo arsyeja që shiu është quajtur *“mëshirë.”*

Pastaj udhëtari vështron shkrepimën, dëgjon rrufenë dhe shikon se të dyja këto, gjithashtu kryejnë detyra të çuditshme. Ndërkaq ai ktheu shikimin brenda mendjes së tij e cila i thotë: Reja e pavetëdijshme dhe e pajetë e cila i ngjason pambukut të prishur, natyrisht nuk ka njohuri për ne; kur ajo vjen për të na ndihmuar, këtë nuk e bën për shkak se ajo ndjen keqardhje për ne; as nuk shfaqet e nuk zhduket pa marrë urdhëresa, por ajo vepron në harmoni me urdhërat e të Plotpushtet-shmit e të Gjithmëshirshmit, që fshihet pa lënë gjurmë e pastaj shfaqet papritmas për të filluar punën e saj; Ajo e mbush dhe e boshatis atmosferën nga çasti në çast duke zbatuar urdhërin e Sunduesit absolut, gjithmonë Aktiv e të Lartësuar.

Ajo shkruan vazhdimisht me urtësi, në tabelën e qiellit; fshin duke e hequr e duke e transformuar atë në *“tabelë fshirje e konfirmimi”* e duke dhënë një përshkrim të zvogëluar të *“tubimit të ringjalljes e të krijimitit.”* Sepse retë i ngjiten erës, me urdhërin e Krijuesit të Gjithëditur e shumë bujar, Bamirës e Përkujdesës dhe marrin nëpër-mjet saj, thesaret e shirave ku secili thesar është aq i rëndë sa një mal, dhe shpejtojnë në tokë për t'u dhënë ndihmesë nevojtarëve. Është sikur ajo të vajtonte nga keqardhja për gjendjen e tyre; Ajo duke derdhur lotët e saja i shkakton tokës të buzëqesh me lulet, ato zbusin nxehtësinë e diellit, spërkasin me ujë kopshtet si dhe lajnë e pastrojnë faqen e tokës nga pluhurat me qëllim që ajo të shkëlqejë e të ndriçojë.

Ai udhëtar kurioz atëherë i thotë mendjes së tij: “Kjo erë e pavetëdijshme, e pajetë, e pavullnetshme, gjithnjë e tronditur, e stuhishme dhe e çoroditur, vijnë në ekzistencë dhe shfaqen për shkak të saj - dhe formës së saj të jashtme - qindra e mijëra detyra e funksione, shumë mirësi e mbështetje që përmbajnë plot urtësi, mëshirë e përsosmëri, çka vërteton qartë se kjo erë e zellshme e shërbëtore e palodhshme, kurrësesi nuk vepron nga vetvetja, por vepron në përputhje me urdhërat e Krijuesit të Gjithëditur dhe të Atij komandanti Bamirës. Është tamam sikur çdo

grimcë të ishte e vetëdijshme për çdo detyrë, ashtu si një ushtar vigjilent që kupton e dëgjon çdo urdhër të komandantit, pasi ajo i bindet çdo urdhërese që kalon përmes ajrit. Ai mbështet të gjitha kafshët për frymëmarrje e për të jetuar, të gjitha bimët për endëzime e për t'u zhvilluar, dhe kultivon të gjithë lëndën e domosdoshme për mbijetesën e tyre. Ajo drejton dhe administron retë, bën të mundur ecjen e anijeve që lundrojnë pa lëndë djegëse dhe ndërmjetëson në përcjelljen e tingujve, zërave e ndërlidhjeve, veçanërisht nëpër-mjet telefonave, telegrafëve e radiofonive. Gjithashtu kryen funksione e shërbime të tjera universale. Tani secili nga këto atome përbëhet nga dy lëndë të thjeshta si azoti dhe oksigjeni dhe secili i ngjason tjetrit dhe gjenden në qindra e mijëra lloje të ndryshme anembanë globit; Ndërkohë udhëtari thotë: Unë dal me përfundimin se ato funksionojnë e shërbejnë me rregullsinë më të madhe nga një dorë e fshehur, ashtu siç e bën të qartë verseti Kur'anor:

وَتَصْرِيفِ الرِّيحِ وَالسَّحَابِ الْمُسْتَبِينِ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ

“...Dhe në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara mes qiellit e tokës... (ka prova për atë popull që arsyeton).” (Kur'an 2: 164)

Ai që, nëpërmjet vendosjes së erërave, i përdor ato në detyra e funksione të panumërta, që me anë të urdhëresës së erërave i përdor ato në detyra të pafund të mëshirës dhe që e krijon ajrin në këtë formë, Një i Tillë mundet vetëm të jetë Krijuesi i ekzistencës së domosdoshme, Fuqiplotë mbi çdo gjë, i Gjithëditur e Bujar.

Atëherë ai vështron shiun dhe sheh se brenda tij ka mirësi e dobi aq të shumta sa numri i pikave të shiut, aq shumë tregues hyjnorë sa pikat e shiut dhe shumë urtësi Hyjnore sa atomet e tij. Ato

pika të këndshme, të ëmbla e të bekuara, për më tepër janë krijuar në mënyrë aq të bukur e të rregullt saqë shiu që dërgohet veçanërisht në kohën e verës çohet dhe shkakton rënien me një masë e rregull të tillë saqë as erërat e stuhishme, të cilat bëjnë të përplasen objektet e mëdha, nuk mund ta shkatërrojnë këtë ekuilibër e rregull; pikat nuk përplasen me njëra-tjetrën dhe nuk bashkohen në një mënyrë që të bëhen masa apo sasi të mëdha të dëmshme uji. Uji që përbëhet nga dy elemente të thjeshtë, si hidrogjeni dhe oksigjeni, përdoret edhe për qindra e mijëra detyra e funksione të ndryshme që tregojnë një urtësi e janë kuptimplotë, veçanërisht te qeniet e gjalla, në një kohë që elementet që ai përbëhej ishin të pajetë e të pavetëdijshme.

Atëherë shiu, i cili është mëshirë e mishëruar në formë, vetëm mund të prodhohet në thesarin e paparë të *“Mëshiruesit, Mëshirëbërësit”* dhe rënia e tij në tokë është si një komentim i ajetit kur'anor:

هُوَ الَّذِي يُنَزِّلُ الْغَيْثَ مِنْ بَعْدِ مَا قَفَّظُوا وَيَنْشُرُ رَحْمَتَهُ

“...Dhe Ai është që e lëshon shiun, pasi që ata t'i kenë humbur shpresat dhe Ai shtrin mëshirën e Vet...” (Kur'an 42: 28)

Pastaj udhëtari dëgjon rrufenë dhe shikon shkrepimën. Ndërkohë kupton se këto dy dukuri qiellore të çuditshme janë si një komentim i plotë i verseteve:

وَلِيَسِّحَ الرِّعْدُ لِلْبَرْقِ

“...Ndërkaq bubullima e rrufesë e madhëron (Zotin e Vetëm) me falenderimin e Tij.” (Kur'an 13: 13)

## يَكَادُ سَنَا بَرْقُهُ يَذْهَبُ بِالْأَبْصَارِ

“...Shkëlqimi i vetëtimës së dritës së resë gati sa s'të merr të parit.” (Kur'an: 24: 43)

Ato të dyja gjithashtu njoftojnë për ardhjen e shiut dhe kështu sihariqojnë nevojtarët.

Po, kjo folje e befasishme e zërit të mreku-llueshëm të qiejve; mbushja e qiellit të errët me shkrepëtimën dhe zjarrin e ndezjes që trishton çdo qenie, dhe ndezja e reve të mëdha që u ngjasojnë maleve prej pambuku ose tubacioneve që shpërthejnë me ujë e borë, këto dhe fenomene të ngjashme me to, zgjojnë njeriun e shkujdesur dhe janë si goditje për atë, shikimi i të cilit është drejtuar poshtë në tokë. Ata i thonë atij: Ngrije kokën! Shiko veprimet e mrekullueshme të Krijuesit shumë aktiv e Fuqiptotë, i Cili dëshiron të prezantojë madhështinë e Tij tek shërbëtorët e Vet. Gjithashtu ato tregojnë se ti nuk je lënë në dëshirat e tekta e tua. Veç kësaj ato njoftojnë se këto dukuri e ngjarje kanë një pronar e një qëllim. Çdonjëra nga ato shkaktohet të përmbushë një detyrë të veçantë dhe secila vihet në shërbim nga Rregullatori i Gjithëditur e nga Drejtuesi i të gjitha gjërave.

Në këtë moment udhëtari kureshtar dëgjon dëshminë e lartë e të dukshme për të vërtetën që përbëhet nga nënshtrimi i erërave, rënia e shirave dhe drejtimi i dukurive natyrore dhe thotë: *“Unë deklaroj besimin te Zoti”*.

Ajo që është pohuar në shkallën e dytë të vendqëndrimit të parë, shpreh vërejtjet e udhëtarit në lidhje me hapësirën dhe qiejt.

\* \* \*

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْوَاجِبُ الَّتِي دَلَّ عَلَى وُجُوبِ وُجُودِهِ  
الْجَوْمُجْمَعِ مَا فِيهِ بِشَهَادَةِ عَظْمَةِ إِحَاطَةِ حَقِيقَةِ التَّخْفِيرِ  
وَالْتَضَرُّفِ وَالْتَنْزِيلِ وَالتَّذْبِيرِ الْوَاسِعَةِ الْمُكَمَّلَةِ بِالسَّاهِدَةِ

Tani udhëtari reflektues, i mësuar tashmë me udhëtimin hulumtues, gjen rruzullin tokësor t'i drejtohet atij duke i thënë: Përse shëtit në atmosferë, nepër qiej e hapësirë? Eja tek unë të të njoh me Atë që kërkon. Shiko funksionet që unë kryej dhe lexo çfarë është shkruar në fletët e mia. Ndërkohë udhëtari hedh vështrimin dhe sheh se globi tokësor, ashtu si një mevlevi ashik, vizaton lëvizjet e tij të dyfishta përreth fushës së madhe të mahsherit (tubimit të madh), një rreth i cili përcakton ditët, vitet dhe stinët. Pra, toka, është si një anije e madhe hyjnore e ngarkuar me qindra e mijëra nga lloje të ndryshme ushqimi dhe me pajisjet e nevojshme për të gjitha qeniet e gjalla, duke notuar me ekuilibrin më të madh në oqeanin e hapësirës e duke u rrotulluar rreth diellit.

Ndërkaq, udhëtari vështron faqet e tokës dhe sheh se secila nga faqet e saja bën të njohur Krijuesin e tokës në mijëra shenja. Ai duke qenë i pamundur t'i lexojë të gjitha faqet e saja, shikon vetëm te faqja që tregon krijimin edhe dislokimin e qenieve të gjalla në pranverë. Ai sheh format e anëtarëve të panumërt të qindra e mijëra llojeve që janë shfaqur në saktësinë më të madhe prej një lënde të thjeshtë dhe që ushqehen në mënyrën më të mëshirshme. Atëherë, në një mënyrë të mrekullueshme, disa prej farërave u jepen fletë për të fluturuar. Ato marrin fletë e kështu shpërndahen me shumë rregull e me kujdes të madh si dhe ushqehen mirë. Kënaqësi të pafund

dhe lloje të shijshme ushqimi, në formën më të butë e të mëshirshme, u sillet atyre nga dheu i thatë, nga rrënjët, farërat dhe pikat e ngjashme me njëra-tjetrën. Në çdo pranverë qindra e mijëra lloje ushqimesh e pajisjesh ngarkohen si në një vagon transporti hekurudhor dhe dërgohen tek qeniet e gjalla në rregullin më të përsosur, të cilat i marrin nga depot e të panjohurës; Dërgimi i qumshit të ëmbël e të pastër për fëmijët e vegjël nga pompat e gjokseve të nënave duke u shkuar atyre si dhuratë me mëshirën dhe urtësinë shumë të madhe. Natyrisht kjo vetëkuptohet se është një nga treguesit e mëshirës së Mëshiruesit, Mëshirëbërësit dhe e Bamirësit të pashoq.

Në mënyrë të përmbledhur udhëtari kuptoi nga shikimi i faqes së jetës pranverore se ajo është shembull nga qindra e mijëra shembuj e prova të tubimit të madh të ringjalljes në mahsher. Gjithashtu është një komentim praktik i këtij ajeti kur'anor:

فَانظُرْ إِلَىٰ آثَارِ رَحْمَةِ اللَّهِ كَيْفَ يُحْيِي الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا إِنَّ ذَٰلِكَ لِحُجَّتِ الْبُحْرِ الْمَوْتَىٰ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

“...Shiko pra shenjat e mëshirës së All-llahut, se si e ngjall tokën pas vdekjes së saj, e s'ka dyshim se Ai është që do t'i ngjallë të vdekurit, sepse Ai për çdo gjë është i Plotfuqishëm” (Kur'an, 30: 50)

Me fjalë të tjera, ky ajet kur'anor mund të thuhet se shpreh në mënyrë të mrekullueshme kuptimet e ardhura në këtë faqe, domethënë të pranverës.

Kështu udhëtari kuptoi se toka në të gjitha faqet e saja, në mënyrë të përshtatshme me përmasat e

tyre shfaq e shpreh frazën: **لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ** - *Nuk ka zot tjetër përveç Atij.*

Në shprehjen e kuptimit të mbajtur nga udhëtari, me anë të dëshmisë së përmbledhur të njëjës prej njëzet aspekteve të njëjës faqe të vetme nga më shumë se njëzet faqet e globit është folur në “*Shkallën e tretë*” të vendqëndrimit të parë.

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْوَاحِدُ الَّذِي دَلَّ عَلَى وُجُوبِ وُجُودِهِ فِي وَحْدِيَّةِ  
الْأَرْضِ بِجَمِيعِ مَا فِيهَا وَمَا عَلَيْهَا بِشَهَادَةِ عَظَمَةِ إِحَاطَةِ حَقِيقَةِ  
التَّخْوِيرِ وَالتَّذْيِيرِ وَالتَّرْبِيَةِ وَالْفِتَاحِيَّةِ وَتَوْزِيعِ الْبُذُورِ وَالْحَافِظَةِ  
وَالْإِدَارَةِ وَالْإِعَاشَةِ لِجَمِيعِ ذَوَى الْحَيَاتِ وَالرَّحْمَانِيَّةِ وَالرَّحِيمِيَّةِ  
الْعَامَّةِ الشَّامِلَةِ الْمُكْتَلَمَةِ بِالمُسَاهَدَةِ

\* \* \*

Më vonë ai udhëtar refkletues, sa herë që lexonte një faqe të kozmosit i rrënjosej besimi i tij, i cili është çelësi i lumturisë, iu shtuan njohuritë e tij për Zotin e Lartësuar që është çelësi i progresit nëpër shkallët shpirtërore; shikimit të tij iu zbulua edhe një shkallë tjetër nga e vërteta e besimit në Zotin e Lartësuar që është burimi e themeli i fortë i plotësimeve dhe integritetit. Megjithëse ai përparoi duke dëgjuar mësimet perfekte e bindëse të dhëna nga qielli, nga hapësira dhe toka, por vazhdoi të kërkonte më shumë sa herë që ato fletë i jepnin kënaqësi të mëdha shpirtërore e shije e gëzime në botën e brendshme, të cilat e inkurajuan e i ngjallën pasionin për të ditur më shumë. Ndërkohë ai dëgjon jehonën e madhërimit prej deteve e lumenjve të mëdhenj dhe dëgjon

gurgullimën e tyre të trishtueshme. Në shumë mënyra ato i thonë: Na shih neve dhe lexo gjithashtu shenjat tona! Duke i vështruar me vëmendje, udhëtari ynë shikon çka vijon: Detet që vazhdimisht dallgëzohen fuqishëm, të cilët nga natyra shpërndahen, derdhen e mbyten, i sheh se ato kanë rrethuar globin tokësor dhe së bashku me tokën rrotullohen me një shpejtësi shumë të madhe në një rreth prej njëzet e pesë mijë vitesh.

Por, pavarësisht nga kjo, detet nuk derdhen, nuk përmbysin apo të cënojnë tokën, fqinjën e tyre të thatë e cila qëndron puqur me të. Padyshim ato qëndrojnë të qetë, lëvizin dhe mbrohen me urdhërin e të Plotftuqishmit e të Madhështisë absolute. Pastaj duke shikuar në thellësitë e deteve, udhëtari shikoi se përveç xhevahireve shumë të bukur, të stolisur e simetrik, ndodheshin mijëra lloje të ndryshme kafshësh që ushqeheshin, drejtoheshin dhe që u përcaktohej lindja dhe vdekja në mënyrë shumë të disiplinuar; ushqimet e tyre vijnë thjesht nga rëra dhe uji i kripur. Kjo vërteton në mënyrë të pakundërshtueshme ekzistencën e të Plotëfuqishmit, të Gjithëlavdishmit e Hirëplotë, Administruesit e Jetëdhënësit të tyre. Atëherë udhëtari hedh vështrimin tek lumenjtë dhe sheh se përfitimi, dobitë e natyrshme tek to, funksionet që ato kryejnë dhe rimbushja e tyre e vazhdueshme, realizohet nga një urtësi e mëshirë dhe në mënyrë të pakontestueshme, provojnë se ato lumenj, burime, rrëke, rrjedha e kanale të lundrueshme, rrjedhin nga thesari i mëshirës së të Gjithëmëshirshmit, Krijuesit Zemërgjerë e Bujar.

Ato burojnë dhe rrjedhin e shpërndahen në mënyrë të jashtzakonshme, saqë thuhet, sipas kuptimit të një hadithi, se: *“Katër lumenj rrjedhin nga Parajsa (Xbenneti).”* Domethënë ato kalojnë shumë përtej limiteve a llogaritjeve të shkakësisë së jashtme. Prandaj ato, nuk rrjedhin veçse nga thesari i parajsës shpirtërore, nga bollëku i burimeve të padukshme e të pashtershme.

Për shembull: Nili i bekuar, i cili e transformoi shkretëtirën e Egjiptit në një parajsë dynjaje, buron nga një mal që ndodhet në jug i cili quhet mali i hënës. Ai rrjedh pa shteruar kurrë, tamam sikur të ishte një det i vogël. Në qoftë se uji që rrjedh poshtë do të mblidhej e të grumbullohej vetëm për gjashtë muaj në formën e një mali e të ngrihej lart, padyshim ai do të bëhej më i madh se ai mal. Por vendi te mali ku uji depozitohet është më i vogël se 1/6 e masës së tij. Ndërsa në lidhje me ujin i cili rimbush lumin, shiu që hyn në rezervuarin e lumit është shumë i rrallë e i pakët në atë zonë të nxehtë dhe gëlltitet shpejt nga toka e etur; si rrjedhim është i pamundur të ruaj ekuilibrin e lumit.

Për këtë arsye u transmetua se burimet e bekuara të Nilit, në mënyrë të mrekullueshme, vijnë nga parajsja e padukshme. Ky hadith ka një kuptim të thellë dhe shpreh një të vërtetë të bukur.

Atëherë udhëtari shikoi një dëshmi e një realitet të vetëm nga mijëra dëshmi e prova të tilla që janë aq të mëdha sa vetë lumenjtë e oqeanet. Ai gjithashtu kuptoi se detet, lumenjtë dhe të gjitha rrjedhat dëshmojnë njëzëri me fuqinë e madhësisë se oqeaneve duke shprehur:

لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ “Nuk ka Zot tjetër veçse Atij” dhe dolën si dëshmitarë për dëshminë e tyre të gjitha krijesat që banojnë në to.

Duke shprehur e përcjellë dëshminë e detërave e lumenjve, ne folëm në “Shkallën e katërt” të mekemit të parë:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْوَاجِبُ الوجودِ الَّذِي دَلَّ عَلَى وُجُوبِ وُجُودِهِ فِي وَحْدِيَّةِ  
 جَمِيعِ الْعَالَمِ وَالْأَنْهَارِ بِجَمِيعِ مَا فِيهَا بِشَهَادَةِ عَظَمَةِ إِحْاطَةِ حَقِيقَتِهِ  
 الشَّخِيرِ وَالْمَخَافَةِ وَالْإِذْحَارِ وَالْإِدَارَةِ الْوَاسِعَةِ الْمُنْتَظَمَةِ بِالشَّاهِدَةِ

\* \* \*

Në këtë kohë, gjatë udhëtimit të mendueshëm, udhëtarit i bëhet thirrje nga malet e fushat të cilat i thonë: “*Lexo edhe faqen tonë gjithashtu.*” Ai, duke soditur, vështron se funksionet universale të maleve dhe dobitë e tyre të përgjithshme përbëjnë një madhështi e urtësi çka hutojnë mendjen. Për shembull, shfaqja e maleve duke dalë nga toka me urdhërin e Zotit të tyre, qetëson trazirën e tokës dhe zbut inatin dhe zemërimin që shkaktohen nga turbullirat e saj të brendshme; Ndërsa malet dalin e ngrihen lart, toka fillon të marrë frymë e shpëton nga dridhjet, lëkundjet shkatërruese e nga trazirat. Kështu ajo qetësohet e ndjek rrotullimin e saj, siç e ka për detyrë. Ky rrotullim nuk është më turbullues. Ashtu siç ngrihen direktët e anijeve për të ruajtur ekuilibrin e për t'i mbrojtur anijet nga tronditja e mbytja, në të njëjtën mënyrë malet shërbejnë si shtylla - me depo e magazina - për anijen e tokës me qëllim që ta mbrojnë atë nga lëkundjet e që t'i japin asaj qëndrueshmëri dhe ekuilibër. Kur'ani i Shenjtë e tregon këtë kuptim në shumë ajete (versete) kur'anore, e midis tyre:

وَالْجِبَالِ أَوْتَادًا ۖ وَالْقِبْلَيْنَا فِي بَارَوَائِي ۖ وَالْجِبَالِ أَرْسِيًّا

“(Dhe i kemi bërë) malet si shtylla mbështetëse.” (Kur'an, 78: 7); “(Dhe tokën) Ne e kemi shtrirë dhe e kemi vendosur në të male të qëndrueshëm” (Kur'an, 50: 7); “Dhe malet Ai i ka ngulur fort.” (Kur'an, 79: 32)

Gjithashtu në malet janë depozituar e ruajtur të gjitha llojet e burimeve të ujrave, mineraleve, lëndëve dhe ilaçeve për të cilat kanë nevojë gjallesat.

Ato janë depozituar me një urtësi, janë dërguar me një bujari, janë rezervuar me një rregull e aftësi saqë në mënyrë të pakundërshtueshme provojnë se këto male janë magazina rezervash që veprojnë me urdhërin dhe janë në shërbimin e të vetmit Krijues, fuqia e të Cilit është e pakufishme dhe Urtësia e Tij është e pafund.

Kështu udhëtari e shikon atë urtësi universale të brendaqenësishme të malet dhe fushat, atë urtësi të cilën e nxori si përfundim se ajo ekzistonte edhe në gjërat e tjera që janë me madhësinë e maleve dhe gjerësinë e fushave. Ndërkaq ai shikoi se malet dhe fushat, me çfarë ato përmbajnë, përbëjnë një deklaratë për Njësinë e Zotit të Lartësuar, një deklaratë aq të fuqishme e të fortë sa vetë malet, dhe aq të gjerë e të shtrirë sa fushat. Atëherë ai me respekt tha: *“Besoj në Zotin e Lartësuar.”*

Në shprehjen e këtij kuptimi u fol në “Shkallën e pestë” të “Vendqëndrimit të parë.”

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْوَاجِبُ الْوُجُودَ الَّذِي دَلَّ عَلَى وُجُوبِ وُجُودِهِ جَمِيعُ  
 الْعَالَمِ وَالْقَضَائِي بِجَمِيعِ مَا فِيهَا وَعَلَيْهَا بِسْمَتِهَا عَظَمَةُ إِحْسَانِهِ  
 حَقِيقَةُ الْإِدْحَارِ وَالْإِدَارَةِ وَنَشْرُ الْبُذُورِ وَالْحَافِظَةُ وَالْمُتَدَبِّرُ  
 الْأَخْيَاطِ وَالزَّائِيَةُ الْوَاسِعَةُ الْعَامَّةُ الْمُنْتَظَمَةُ الْكَلِمَةُ بِالشَّاهِدَةِ

\* \* \*

Ndërsa udhëtari po shëtiste duke reflektuar për malet e fushat, befas u hap para mendimit të tij dera e botës së pemëve dhe e bimëve e cila e fton atë duke i thënë: *“Eja tek ne e shëtit në kopshtin tonë dhe lexo mbishkrimet tona.”* Gjatë hyrjes ai pa se pemët edhe bimët po mbanin një kuvend të madh e të këndshëm i cili mbahej për të deklaruar fuqinë e Njesisë së Zotit të Lartësuar. Gjithashtu ato kishin bërë një rreth për t'i bërë lutje e falenderime Krijuesit; Udhëtari kuptoi nga vetë aparenca e të gjitha pemëve dhe bimëve se llojet e tyre të ndryshme deklarorin njëzëri:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ *“Nuk ka zot tjetër përveç All-llahut.”* Sepse ai zbuloi tre të vërteta të mëdha e universale që tregonin e provonin se të gjitha pemët frutëdhënëse e bimët me gjuhët e tyre simetrike e retorike, me frazat e luleve të tyre joshëse e fjalëshumë dhe me fjalët elokumente të frutave të mirëorganizuara po dëshmonin lavdinë e Zotit të Lartësuar dhe deklarorin frazën:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ *“Nuk ka zot tjetër përveç Atij.”*

**E VËRTETA E PARË:** Ashtu siç shihen në çdo lloj peme e bime në formën më të dukshme mirësia, bujaria dhe zemërgjerësia e qëllimshme, në të njëjtën mënyrë, këto kuptime duhet të shihen në tërësinë e pemëve dhe bimëve të cilat janë të qarta si drita e diellit.

E VËRTETA E DYTË: Dallimi dhe ndryshimi i mendueshëm e i qëllimshëm si dhe diferenca midis llojeve të ndryshme kurrësesi nuk mund t'u atribuohen shkaqeve (rastësisë); zbulimi i mëshirshëm e i qëllimshëm dhe shkëlqimi i pandarë të ato duhet të shihen si qartësia e dritës të varietetet e pakufishme të llojeve. Ato eksopozojnë vetveten se janë veprat dhe vultat e Krijuesit të Gjithëditur.

E VËRTETA E TRETË: Çelja dhe lulëzimi i të gjithë anëtarëve të veçantë të qindra e mijëra lloje të asaj bote të pafund, ku secila nga ato, në formën dhe llojin e saj të dallueshëm, me rregullin më të madh, me peshën dhe bukurinë, me vitalitetin e urtësinë dhe pa asnjë defekt; dhe shfaqja e atyre farërave nga toka në forma të dallueshme e të veçanta... pa dyshim se kjo përbën një të vërtetë më brilante se Dielli. Provat e kësaj të vërtete janë aq të shumta sa lulet dhe sa frutet e gjetet që dalin në pranverë.

Ndërkohë udhëtari tha:

الْحَمْدُ لِلَّهِ عَلَى نِعْمَةِ الْإِيمَانِ

“Lavdi Zotit për mirësinë e besimit!”

Për shprehjen e këtyre të vërtetave dhe dëshmive të dhëna për to kemi folur në shkallën e gjashtë të vendqëndrimit të parë.

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْوَاحِدُ الْوَجُودُ الَّذِي دَلَّ عَلَى وُجُوبِ وُجُودِهِ فِي وَحْدِيَّةِ  
 إِجْمَاعِ جَمِيعِ أَنْوَاعِ الْأَشْجَارِ وَالنَّبَاتَاتِ الْمُسْتَحْتَابَاتِ النَّاطِقَاتِ بِكَلِمَاتِ  
 أَوْزَانِهَا الْمَوْزُونَاتِ الْفَصِيحَاتِ وَأَزْهَارِهَا الْمُرْتَبَاتِ الْجَزْبَلَاتِ  
 وَأَثْمَارِهَا الْمُنْتَظَّمَاتِ الْبَلِيغَاتِ بِشَهَادَتِ عَظَمَةِ إِحَاطَةِ حَقِيقَةِ الْإِنْمَاءِ  
 وَالْإِكْرَامِ وَالْإِحْسَانِ بِقَصْدِ وَرَحْمَةٍ وَحَقِيقَةِ التَّمْيِيزِ وَاللِّتْرَابِ  
 وَالضُّمُورِ بِإِرَادَةٍ وَحِكْمَةٍ مَعَ قَطْعِيَّةِ دَلَالَةِ حَقِيقَةٍ فَفُجَّ جَمِيعِ  
 صُورِهَا الْمَوْزُونَاتِ الْمُرْتَبَاتِ الْمُنْتَابِتَةِ الشُّوعَةِ الْعَبِيرِ الْخُدُودَةِ مِنْ  
 نَوَاتِيحِ وَجَبَاتٍ مُنْمَا شَلَّةٍ مُنْتَشَابِيَةٍ مَحْصُورَةٍ مَعْدُودَةٍ

\* \* \*

Ndërsa po kthehej, udhëtari i apasionuar të cilit tashmë i është forcuar dëshira e etja nga ai udhëtim hulumtues, i gëzuar nga kënaqësia e qëndrimit të tij tek e vërteta, për gjetjen e kopshteve të besimit, duke u kthyer nga kopshti i pranverës me një tufë aq të madhe lulësh sa madhësia e pranverës nga lulet e njohjes së besimit, papritmas bota e shpendëve dhe e kafshëve hapet para mendjes së tij të dhënë pas të vërtetës dhe arsyes së shëndoshë; ato shpendë e kafshë e ftojnë atë me qindra e mijëra tinguj të ndryshëm e gjuhë të ndryshme për të hyrë në atë botë të madhe duke i uruar mirëseardhje në mbretërinë e tyre. Ndërkohë ai futet e sheh se të gjitha shpendët e kafshët me speciet, llojet, grupet e tufa e tyre po deklarorin në heshtje e me zë të lartë me gjuhët që ato

dispononin, frazën **لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ** “Nuk ka zot tjetër përveç Atij.” Sikur faqja e tokës të ishte një vend i gjërë lutjesh dhe një asamble për përmendjen e lavdisë së Zotit të Lartësuar; dhe se secila nga ato

në vetvete ishte si një odë (poemë) që i ishte kushtuar Zotit të Lartësuar, ishte si një fjalë që deklaronte lartësinë e Tij, një shkronjë që tregonte mëshirën e Tij; secila nga ato përshkruanin Krijuesin dhe i bënin Atij falenderime e lëvdata. Tamam sikur shqisat e atyre shpendëve dhe kafshëve, ndjenjat, fuqitë, gjymtyrët, aparatet dhe instrumentet e tyre sikur të ishin fjalë të peshuara e të vendosura në formë të rimuara dhe sikur të ishin shprehje retorike dhe të përkryera. Udhëtari pa tre të vërteta të mëdha gjithëpërfshirëse të cilat në formë vendimtare, tregonin falenderimet që ato i jepnin Krijuesit e Furnizuesit të tyre dhe dëshmonin me atë fjalë e shprehje Njësinë e Zotit të Lartësuar

**E VËRTETA E PARË:** Është e vërteta e krijimit të atyre krijesave nga asgjëja, që kurrësesi nuk mund t'i atribuohen rastësisë, forcës së verbër apo natyrës së shurdhër. Ardhja e tyre në ekzistencë, qenia e tyre e prodhuar në një mënyrë të qëllimshme e njohëse, me urtësi e dëshirë, e gjithë kjo është një e vërtetë që dëshmon ekzistencën e domosdoshme të Krijuesit të perherëshëm, që dëshmon të vërtetën e shtatë attributeve të Tij dhe Njësinë, që është një dëshmi i përsëritur dhe e vërtetuar nga vetë numri i të gjitha gjallesave.

**E VËRTETA E DYTË:** Kjo shfaqet nga dallimi i bërë ndërmjet atyre qenieve të pafund, për sa i përket formës, sasisë, llojit, zbukurimit e stolisjes së tyre, një e vërtetë kjo aq e madhe dhe e fuqishme saqë askush, përveç Krijuesit të Plotfuqishëm e të Gjithëditur, nuk mund të ishte përgjegjës për këtë të vërtetë e për mijëra mrekullira e shembuj të urtësisë hyjnore që ajo përmban.

**E VËRTETA E TRETË:** Shfaqja e atyre krijesave të panumërta në llojet e format e ndryshme, secila nga ato është një mrekulli e urtësisë; Shfaqja e tyre nga vezët dhe pikat e ujit, sperma, duke

qenë të ngjashme me njëra-tjetrën ose të përafërta dhe që pëkufizohen e përcaktohen në numër. E gjitha kjo duke u realizuar në formën më të rregullt simetrike e të pagabueshme, natyrisht është një e vërtetë aq brilante saqë ndriçohet me prova e dëshmi aq të shumta sa vetë numri i kafshëve e i shpendëve.

Nga konsensusi i këtyre të vërtetave, të gjitha llojet e kafshëve dhe shpendëve dëshmojnë njëzëri duke thënë: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ “Nuk ka zot tjetër përveç Atij.”

Është sikur e gjithë toka, ashtu si një njeri shumë i madh, të thotë: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ “Nuk ka zot tjetër përveç Atij” në një mënyrë të përshtashme me madhësinë dhe shtrirjen e saj duke ua përçuar dëshminë e saj edhe banorëve të qiellit.

Këto të vërteta janë trajtuar në *shkallën e shtatë të vendqëndrimit të parë*.

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْوَاحِبُ الوجودِ الَّذِي دَلَّ عَلَى وُجُوبِ وُجُودِهِ فِي  
وَحْدِيَّتِهِ إِثْقَاقُ جَمِيعِ أَنْوَاعِ الْحَيَوَانَاتِ وَالطَّيُورِ الْحَامِدَاتِ الشَّاهِدَاتِ  
بِكَلِمَاتِ حَوَائِثِهَا وَقَوَائِمِهَا وَحَسَنَاتِهَا وَلَطَائِفِهَا الْمَوْزُونَاتِ  
الْمُنْتَظَرَاتِ لِقَصِيصَاتِ وَبِكَلِمَاتِ جَمَازَاتِهَا وَجَوَارِحِهَا وَأَعْضَائِهَا  
وَالْأَرْبَابِ الْمَكْتَلَةِ الْبَلِيغَاتِ بِشَهَادَةِ عَظْمَةِ إِحَاطَةِ حَقِيقَةِ  
الْإِبْحَادِ وَالضَّنْعِ وَالْإِبْدَاعِ بِالْإِرَادَةِ وَحَقِيقَةِ التَّمْيِيزِ وَالتَّرْبِيَةِ  
بِالْقَضِ وَحَقِيقَةِ التَّقْدِيرِ وَالنَّصُورِ بِالْحُكْمَةِ مَعَ قَطْعِيَّةِ دَلَالَةِ  
حَقِيقَةِ فَرَجِ جَمِيعِ صُورِهَا الْمُنْتَظَرَةِ الْمُخَالَفَةِ الْمَتَّوَعَةِ الْعَبْدِ الْمَحْضُورَةِ مِنْ  
نَيْصَاتِ وَقَطْرَاتِ تَمَائِلِ مُتَشَابِهَةِ مَحْضُورَةٍ مُخَدَّوَةٍ

\* \* \*

Tani udhëtar i meditetues dëshiron të futet në botën e njeriut, në botën e humanizmit, me qëllim që të ngjitet në shkallë të pakufishme të njohjes hyjnore dhe në stadet e pozitave të larta dritëdhënëse. Në këtë shkallë atij i bëhet ftesë nga humanizmi i cili kryesohet nga pejgamberët. Ai e pranon ftesën. Duke vështruar, së pari vendqëndrimet e kohës së shkuar, ai pa se të gjithë profetët (*shpëtimi qoftë mbi ta*), e që përfaqësojnë llojin më dritëdhënës e perfekt njerëzor, po recitonin e persërisnin në grupe frazën: **لَا إِلَهَ إِلَّا الْمُر** “Nuk ka zot tjetër përveç Atij” e duke përmendur All-llahun. Ata të gjithë, me forcën e mrekullive të panumërta brilante e vërtetuese të misionit të tyre, shpallnin Njësinë e Zotit të Lartësuar dhe me qëllim që të përparojë njerëzimi

duke u larguar nga shkalla shtazore për t'u ngjitur tek shkalla engjëllore, ata udhëzonin njerëzit e i ftonin tek besimi në Zotin e Vetëm. Udhëtari bie në gjunjë me respekt e vlerësim tek kjo shkallë drite dhe i kushton vëmendje mësimit. Ai pa se në dorën e secilit nga ata mësues (qeniet më të larta e më të shquara humane) ndodheshin mrekulli që u ishin dhuruar nga Krijuesi i të gjitha botërave si shenja konfirmimi për misionin e tyre. Për më tepër, një grup i madh njerëzish, një komunitet i tërë kishte vërtetuar pretendimet e tyre dhe ishin futur në besim nëpërmjet thirrjes së atyre peygamberëve. Kështu udhëtari mundi të vleresonte gradën dhe fuqinë e Njesisë. Kjo e vërtetë e pranuar dhe e vërtetuar nga këta qindra e mijëra individë të përgjegjshëm e të drejtë, e duke e miratuar me konsensus të plotë, padyshim që është e sigurtë dhe e qëndrueshme.

Ai kuptoi gjithashtu se njerëzit e rrugës së shtrembër, duke mohuar këtë të vërtetë të pranuar e të vërtetuar nga shumë dëshmitarë të drejtë, po bënë një faj shumë të rëndë dhe një krim shumë të madh dhe kuptoi se ata mohues, si rrjedhim i kundërshtimit të tyre, u bënë të meritueshëm për një dënim pikëllues.

Ai gjithashtu njohu se ata të cilët e pranuan të vërtetën dhe i besuan asaj ishin njerëzit më të drejtë e më të ndershëm. Papritmas, një shkallë shumë e lartë e shenjtërisë së besimit dhe e lartësisë së Njesisë u shfaq përpara tij.

Po, mrekullitë e pafund që Zoti i Lartësuar ua dhuroi profetëve (*paqja qoftë mbi ta*) - secila prej tyre, duke qenë si një konfirmim i misionit të tyre; goditjet qiellore që ranë mbi kundërshtarët e tyre ku secila ishte provë e vërtetësisë së Profetësisë; përsosmëria e tyre individuale që ishte si një tregues i drejtësisë së tyre. Mësimet e tyre të vërteta; forca e besimit të tyre që dëshmonte ndershmërinë e tyre; serioziteti i tyre i lartë dhe gatishmëria për vetëflim; librat e shenjtë dhe

fletët e mbajtura nga duart e tyre; nxënësit e tyre të panumërt të cilët duke ndjekur rrugën e tyre gjetën udhëzimin e vërtetë, gjetën integrimin e tyre njerëzor dhe dritën, duke provuar kështu edhe njëherë të vërtetën e mësimëve; Miratimi unanimit të gjithë profetëve, paralajmëruesve seriozë, dhe miratimi i ndjekësve të tyre në të gjitha çështjet pozitive; E gjitha kjo përbën një provë aq të fuqishme saqë asnjë fuqi në tokë nuk mund të konfrontohet me të, dhe çdo dyshim apo hezitim do të shkrihet para kësaj të vërtete të fuqishme.

Ndërkohë udhëtari mësoi se urtësia e pranimit dhe e besimit në të gjithë peygamberët është një nga kolonat e besimit, dhe se kjo përfaqëson një burim tjetër force. Kështu, ai gjeti një dobi të madhe besimi nga mësimet e tyre. Ne kemi folur në shkallën e tetë të vendqëndrimit të parë që tregon kuptimin e këtij leksioni.

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الَّذِي دَلَّ عَلَىٰ جُوبٍ وَجُودِهِ فِي وَحْدَيْهِ  
اجْمَاعُ جَمِيعِ الْأَنْبِيَاءِ بِقُوَّةِ مُعْجَزَاتِهِمُ الْبَاهِرَةِ الْمُصَدِّقَةِ الْمُصَدِّقَةِ

\* \* \*

Ndërsa udhëtari kërkues po provonte shije të larta të së vërtetës nga forca e besimit e ndërsa po vinte nga asambleja e profetëve, paqja dhe bekimet e Zotit të Lartësuar qofshin mbi ta, tani e gjen veten të ftuar nga ata të cilët vërtetuan pretendimet e profetëve me provat më të fuqishme e vendimtare; Këta janë pikërisht ata që njihen si njerëzit e zgjedhur e të pastër, ose të drejtit. Ata e ftojnë udhëtarin në shkollat e tyre, në klasat e të cilëve pa nga njerëzit gjenialë dhe qindra e mijëra shkollarë e studiues të mirëfilltë të cilët provonin me argumente të fuqishme “Çështjet e afirmuara të besimit” ku në krye të atyre çështjeve qëndron domosdoshmëria e ekzistencës së Zotit të Lartësuar

dhe Njësia i Tij. Ata i provonin me demonstrime të thella saqë nuk linin më vend për dyshim. Natyrisht, fakti që ata janë të të njejtimit mendim përse u përket parimeve e shtyllave të besimit, pavarësisht nga ndryshimi që kanë në aftësi e në pikëpamje ku çdo njeri mbështetet në forcën e argumentit dhe sigurisë së tij. Nuk ka dyshim se kjo është një provë vendimtare të cilën askush nuk mund ta kundërshtojë përveç atij që ka zgjuarsia më të thellë se sa zgjuarsia e tyre, dhe në qoftë se argumenti i tij do të ishte më i fortë se sa argumentet e atyre të gjithëve. Mirëpo kjo është e pamundur. Si rrjedhojë, mohuesi mund t'i kundërshtojë ato vetëm me injorancën e tij të jashtme, mund t'i refuzojë vetëm me kryeneçësi ose me kokëfortësi e duke mbyllur sytë kundrejt asaj drite. Gjendja është se ai që mbyll sytë e tij, do të thotë se ai po bën pikërisht ditën e tij natë për vetveten. Udhëtari mësoi se dritat e përhapura në këtë klasë të gjerë e të madhe nga këta shkollarë të thellë e të respektuar patën ndriçuar gjysmën e globit për më shumë se njëmijë vjet. Ai gjeti në të moral e forcë shpirtërore saqë e gjithë fuqia e kombinuar e njerëzve të mohimit nuk do të mundej ta lëkundte apo ta shkatërronte.

Një aluzion i shkurtuar është përmendur në shkallën e nëntë të vendqëndrimit të parë, është ai mësim që mësoi udhëtari në këtë klasë.

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الَّذِي دَلَّ عَلَىٰ وُجُوبِ وُجُودِهِ فِي وَحْدَتِهِ تَأْتِئًا  
جَمِيعِ الْأَصْفِيَاءِ بِقُوَّةِ بَرَاهِينِهِمُ الزَّاهِرَةِ الْحَقَّقَةِ النَّصِيحَةِ  
\* \* \*

Udhëtari soditës u afrua drejt klasës së dijetarëve me një dëshirë të zjarrtë me qëllim që të shtonte besimin e zbulimin e tij dhe për të parë e provuar dritat e shijet të cilat duhet të vështrohen me

një fuqizim e zhvillim të vazhdueshëm të fesë, e të cilat ishin në rrugën e ngjitjes prej shkallës ILMUL-JEKIN “*Shkalla e njohjes së sigurisë*” dhe drejtë shkallës AJNUL-JEKIN “*Shikimi i sigurisë.*” Ndërkohë me mijëra e miliona Evlija, udhëheqës shpirtërorë të cilët luftuan për hir të së vërtetës, që e përçuan të vërtetën e që arritën tek shkalla e “*Shikimit të sigurisë*” në hijen e ngjitjes së Muhammedit (*alejhis-selâm*) e në gjurmët e këmbëve të tij (*shpëtimi qofitë mbi të*). Këta i bënë thirrje udhëtarit për te një vend në një bujtinë, një vend ku përmendej Zoti i Lartësuar e ku jepej mësim dhe edukim i lartë. Ai vend ishte shumë dritëdhënëse, i gjerë e i qartë, i cili përbëhej nga shumë kuvende dhikri për përmendjen e All-llahut, e nga bujtina të vogla të panumërta.

Në hyrje ai gjeti se ata - udhëheqës shpirtërorë - njerëzit e shpëtimit dhe të kerameteve (provave apo akteve të jashtëzakonshme që i realizonin me fuqinë e Zotit të Lartësuar). Ku të gjithë me

unanimitet po deklarorin: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ “*Nuk ka zot tjetër përveç All-llahut*” duke u mbështetur tek dëshmitë e tyre, për të padukshmen dhe tek kerametet që ato kishin mundur t’i realizonin me ndihmën e Zotit të Lartësuar; Ata të gjithë po shpallnin domosdoshmërinë e ekzistencës dhe unitetit të Zotit të Lartësuar. Udhëtari ndërkaq vështron se sa e qartë dhe e dukshme duhet të jetë e vërteta te këta gjeni të shenjtë. Këta njohës shpirtërorë të cilët perfaqësojnë xhemâte të shumta dritëdhënëse e që ndjekin tarikate (metoda) të ndryshme të vërteta, i vështruan ngjyrat e panumërta të shfaqura nga Dielli i përhershëm i All-llahut, ashtu siç vështrohen shtatë ngjyrat e shfaqura nga dielli në qiell.

Ky unanimitet i këtyre njerëzve shpirtërorë i bashkohet unanimitetit të profetëve (*paqja dhe bekimi qofshin mbi ta*), dhe atij të njerëzve të zgjedhur, duke formuar kështu konsensusin më te lartë. Pa

dyschim që kjo përbën një të vërtetë e një provë më të ndritshme se dita që tregon ekzistencën e diellit.

Kështu është përmendur në shkallën e dhjetë të vendqëndrimit të parë; një aluzion i shkurtër e i dobishëm të cilin e nxori udhëtari ynë nga bujtina e sufizmit.

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الَّذِي دَلَّ عَلَىٰ وُجُوبِ وُجُودِهِ فِي وَحْدَتِهِ إِجْمَاعِ  
الْأَوْلِيَاءِ بِكُشْفِيَاتِهِمْ وَكَرَامَاتِهِمِ الظَّاهِرَةِ الْمَحْقُوقَةِ الْمَصْدَقَةِ  
\* \* \*

Tani udhëtari ynë nëpër botë, duke qenë i vetëdijshëm se dashuria për Zotin që buron nga besimi në Krijuesin e që vjen nga njohja e Tij se është persosmëria e plotësimi më i madh njerëzor dhe më e rëndësishmja, e madje është burimi i të gjitha plotësimeve dhe origjina e tyre, ai shprehu dëshirën, e me të gjitha fuqitë e tij të jashtme e të brendshme, me qëllim që të përparojë edhe më shumë në forcimin e besimit të tij e në zhvillimin dhe zgjerimin e njohurive të tij. Për këtë arsye ai ngriti kokën dhe duke vështruar nga qiejt tha me vete: Jeta është gjëja më e çmuar në gjithësi dhe të gjitha gjërat i janë nënshtruar jetës. Më e vlefshmjia tek gjallesat janë krijesat me shpirt dhe më të çmuarat midis tyre janë qeniet e ndërgjegj-shme.

Çdo shekull e çdo vit rruzulli funksionon me boshatisjen e rimbushjen e vetvetes me gjallesa me qëllim që ta shtojë këtë lëndë, e cila është më e vyera.

Atëherë udhëtari tha: Padyshim se qiejt madhështorë e të stolisur duhet të kenë krijesa e banorë të përshtatshëm prej gjallesave, shpirtëro-reve e qenieve të vetëdijshme, sepse shumë rrëfenja e burime autentike kanë treguar e vërtetuar shikimin e melekëve (engjëjve) dhe komunikimin me ta

që nga lashtësia. Si për shembull, shfaqja e Xhebrailit (*alejhis-selâm*) në prezencë të Muhammedit (*alejhis-selâm*) e në shikimin e shokëve të tij (*Zoti qoftë i kënaqur me ta*). Ndërkohë, udhëtari thotë me vete: Ah sikur të arrija e të shihja banorët e qiejve e të dija mendimet e tyre në këtë çështje! Pasi fjalët e tyre, në lidhje me Krijuesin e kozmosit janë më të rëndësishmet. Ndërsa ai po mendonte me vete, papritmas, dëgjoji një zë qiellor t'i thotë: Në qoftë se ti dëshiron të na takosh e të dëgjosh mësimin tonë, atëherë dije se para gjithë të tjerëve ne kemi besuar në çështjet e fesë të sjella nga të gjithë profetët ,ku në pararojë të tyre qëndron Profeti Muhamed (*sal-l All-llabu alejbi ve sel-lem*) me Kur'anin e Shenjtë.

Atëherë, gjithashtu, të gjithë shpirtërat e pastër nga ne që jemi shfaqur para njerëzve kemi dëshmuar unanimisht e pa përjashtim për domosdoshmërinë e ekzistencës së Krijuesit të universit, për Njësinë e Tij dhe për Atributet e Tij të shenjta. Ky unanimitet e kjo përputhshmëri e plotë e atyre deklaratave të panumërta janë një udhërrëfyes ashtu si dielli. Kështu drita e besimit tek udhëtari ndriçoi dhe u ngjit nga toka për në qiell. Një aluzion i shkurtër për mësimin që udhëtari mori nga engjëjt ne e kemi dhënë në shkallën e njëmbëdhjetë të vendqëndrimit të parë.

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْوَاحِبُ الْوَجُودِ الَّذِي دَلَّ عَلَى وُجُوبِ وُجُودِهِ فِي  
وَعَدَتِهِ إِتِّفَاقَ الْمَلَائِكَةِ الْمُتَمَكِّلِينَ لِأَنْظَارِ النَّاسِ وَالْمُتَكَلِّمِينَ  
مَعَ خَوَاصِّ الْبَشَرِ بِأَخْبَارِهِمُ التَّطَابِقَةَ التَّوَافِقَةَ

\* \* \*

Pastaj udhëtari i ndezur e kureshtar, duke pas mësuar nga gjuhët e specieve të ndryshme të krijimit në botën e dukshme, dëshiroi të studiojë e të udhëtojë nëpër botën e ndërmjetme duke dashur të gjejë të vërtetën. Këtu para tij hapet dera e mendjeve të shëndosha e dritëdhënëse dhe ajo e zemrave të pastërta e të ndritëshme të cilat janë esencat e njeriut. Me to ai arriti të bëhet fruti i universit, pavarësisht nga përmasat e vogëla e të holla të tyre, ato mund të shtrihen e të përqafojnë pothuajse të gjithë kozmosin.

Udhëtari shikoi një sërë ngushticash njerëzore duke lidhur botën e padukshme me botën e dukshme si dhe lidhjet midis atyre dy botërave, përse ato kanë të bëjnë me njeriun. Ndërkohë, duke iu drejtuar mendjes dhe zemrës së tij, ai tha: Avituni! natyrisht rruga më e shkurtër që të çon tek e vërteta është nëpërmjet shembujve si ju të dyja. Ejani të përfitojmë duke studiuar cilësitë, natyrat dhe ngjyrat te mendjet dhe zemrat e pajisura me besim të pastër. Pasi ky është një mësim që nuk merret nga gjuhët si në rastet e mëparshme. Duke filluar studimin e tij shikoi se të gjitha mendjet e shëndosha dritëdhënëse pajtohen me besimin e pastër e të qartë në Njësinë Hyjnore; të gjitha janë me një bindje të plotë, të sigurtë e të palëkundur në sigurinë e besimit në një Zot të vetëm, pavarësisht nga dallimi i qartë dhe ndryshimi në medhhebet e në pikëpamjet e tyre. Ata kështu u mbështetën në një të vërtetë të vetme e të pandryshuar; të gjitha këto mendje në besimin tek domosdoshmëria e Njësisë janë zinxhirë dritëdhënëses që nuk këputen kurrë dhe i ngjajnë një dritareje të gjerë ndriçuese e cila është hapur drejt botës së të vërtetës.

Ai gjithashtu pa se të gjitha zemrat e pastërta e të ndritshme pajtohen midis tyre në zbulesat Hyjnore dhe në dëshmitë e shtyllave të besimit me një unanimitet të plotë dhe janë të një mendimi në lidhje me Njësinë Hyjnore, pavarësisht ndryshi-meve në mënyrat, metodat dhe tarikatet e tyre. Secila nga këto zemra të ndritshme i gjason një fronti shumë të vogël mbi të cilin

drejtohet Njohja Hyjnore, dhe është një pasqyrë e dritave të treguesve të përhershëm duke u kthyer e duke u bashkuar me të vërtetën, e duke e shfaqur atë. Ato ngjasojnë me shumë dritare të hapura drejt diellit të së vërtetës. Me fjalë të tjera, tërësia e këtyre zemrave përbëjnë një pasqyrë shumë të madhe, ashtu si oqeani përpara atij dielli.

Unanimiteti i këtyre zemrave dhe mendjeve në domosdoshmërinë e ekzistencës së Zotit të Lartësuar dhe të Njesisë së Tij, padyshim është argumenti më i plotë dhe udhëzuesi më i madh, më i besueshëm e më i sigurtë. Sepse, kurrsesi, nuk do të ishte e mundur apo e konceptueshme që një supozim, përveç të vërtetës, ose një mendim i pasaktë apo një atribut i pabazë të mashtronte për shekuj me rradhë këta sy të mprehtë, këto zemra të pastërta e të ndritshme dhe këto mendje të zgjuara e dritëdhënëse.

Madje as edhe sofisti idiot, i cili mohon kozmosin nuk do të pajtohej me mendjet e prishura të cilat i konsiderojnë të mundshme gjërat e tilla.

Të gjithë këtë udhëtari ynë e kuptoi dhe tha me mendje dhe me zemër: *“Unë besova në Zotin e Vetëm”*.

Një aluzion për njohjen e besimit që udhëtari e përfitoi nga mendjet e shëndosha dhe zemrat e pastërta, është përmendur në shkallën e dymbë-dhjetë e të trembëdhjetë tek vendqëndrimi i parë.

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الرَّاجِبُ الْوُجُودَ الَّذِي دَلَّ عَلَى وُجُوبِ وُجُودِهِ فِي وَحْدَانِيَةِ إِجْمَاعِ  
 الْعُمُولِ الْمُسْتَقْبَلَةِ الْمُتَوَرِّدَةِ بِإِغْتِنَا دَانِيَا الْمُتَوَافِقَةَ وَبِقِنَاعَاتِهَا وَبِقِنَايَتِهَا  
 الْمَطَابِقَةَ مَعَ تَحَالُفِ الْإِنْسِغَادَاتِ وَالْمَذَاهِبِ وَكَلَّا دَلَّ عَلَى وُجُوبِ  
 وُجُودِهِ فِي وَحْدَانِيَةِ إِقْتِافِ الْعُلُوبِ السَّائِمَةِ التَّوَرَاتِيَةِ بِكُشْفِيَاتِهَا  
 الْمُنْتَطَابِقَةَ وَبِمِشَا هِدَايَاتِهَا الْمُتَوَافِقَةَ مَعَ تَبَايُنِ الْمَسَائِكِ وَالْمَشَارِبِ

\* \* \*

Atëherë ai udhëtar, duke shikuar më nga afër tek bota e padukshme e duke udhëtuar nëpër të me mendjen dhe zemrën e tij, troket me kureshtje derën e asaj bote, dhe mendon e thotë me vete: Çfarë thotë bota e padukshme? Si rrjedhojë me të ndodhi çka vijon:

Qenia që dëshiron të bëjë Vetveten të njohur në botën fizike, në botën e dukshme, me aq shumë krijesa të stolisura e të përkryera; Ai që na shtynë neve ta duam me aq mirësi e begati të zbukuruara e të ëmbla; Ai i Cili dëshiron të zbulojë plotësimet e mbuluara të Tij nëpërmjet veprave shumë të mrekullueshme e të vyera; që e dëshiron të gjithë këtë në një mënyrë më të qartë se sa ligjërrata e folja. Një Qenie e tillë, mendoj udhëtari, medoemos duhet të jetë pas perdes së të padukshmes. Gjithashtu ajo Qenie, domosdoshmë-risht e prezenton vetveten përmes të ligjëruarit dhe foljes, në të njëjtën mënyrë siç bën përmes veprave e gjendjes. Udhëtari kështu u drejtua tek bota e të padukshmes dhe duke thënë: Ne duhet t'a njohim këtë Qenie, Krijuesin, nga treguesit e Tij futet në atë botë me zemrën dhe me sytë e mendjes së tij dhe shikoi çka vijon: E vërteta e zbulesës ose e Shpalljes Hyjnore sundon të gjithë shembujt, të gjitha pjesët dhe anët e botës së padukshme “GAJB” me një tregues shumë të fuqishëm.

Dëshmia e ekzistencës dhe e Njesisë së Krijuesit shfaqet nga Zoti, Njohësi i botës së padukshme. Ajo është dëshmia e shpalljes dhe e frymëzimit, e cila është shumë më e fortë se sa dëshmia e Kozmosit dhe qënieve të krijuara. Krijuesi nuk e lë prezantimin e Qenies së Tij, as treguesit e ekzistencës së Njesisë së Tij të mbyllura e të kufizuara vetëm në dëshminë e krijesave, por flet me fjalë parapërditësie që i përshtaten madhësisë së Tij. Fjalët e të gjithë njerëzve që paraqiten në vende të ndryshme e që inspirohen nga “*Njohja*” dhe nga “*Fuqia*” e Tij janë të pakufishme; Ai, ashtu siç bën të njohur kuptimin e fjalës së Tij, në të njëjtën mënyrë bën që vetë akti i të folurit të tregojë një nga atributet e Tija.

Udhëtari kuptoi se e vërteta e Shpalljes është vërtetuar e qartësuar deri në atë pikë ku është e vetëkuptueshme nëpërmjet transmetimit të njëqindmijë profetëve (*paqja dhe bekimet qofshin mbi ta*), me anë të pajtimit dhe konsensusit të deklarimeve të tyre që lidhen me treguesin e Shpalljes Hyjnore; nëpërmjet dëshmimeve dhe provave që përmbajnë librat e shenjtë dhe fletët qiellore, të cilat janë udhërrëfyese dhe modelet e shumicës dërrmuese të njerëzimit, janë të mbështetura e të pranuar si të vërteta nga ana e tyre; dhe se ato janë frutet e dukshme të shpalljes Hyjnore. Udhëtari, për më tepër, kuptoi se e vërteta e Shpalljes tregon pesë të vërteta të shenjta:

E PARA: Të flasësh sipas nivelit mendor dhe konceptimit të njerëzve është një formë e zbritjes hyjnore që i bëri të aftë për të folur të gjitha krijesat e Tij të vetëdijshme, u mëson atyre çfarë të flasin dhe të kuptuarit dhe të folurit të tyre; Hyjnia e Tij kërkon që të derdh kuptimet e fjalës së Tij të parapërditësisë në fjalë që i lehtëson njeriut t'i lexojë midis fjalëve të tyre.

E DYTA: Ai që me qëllim që të njohë vetveten mbush kozmosin me krijesa të mrekullueshme dhe i pajis ato me gjuhë që flasin plotësimet e Tij, domosdoshmërisht Ai do ta njoh vetveten edhe me fjalët e Tij gjithashtu.

E TRETA: Është pjesë e Lavdisë së Tij si Krijues që t'i përgjigjet me fjalë ligjëratës dhe dhënieve të falenderimeve që bëhen nga njerëzit e vërtetë, nga njerëzit më të zgjedhur, më të butë e më të dashur ndër Krijesa.

E KATËRTA: Atributi i të folurit që është një domosdoshmëri dhe një tregues brilant i dy attributeve: “*Njobjes*” dhe i “*Jetës*” padyshim duhet të gjenden në një formë gjithëpërfshirëse e të përjetshme, në Qënien, njohuria e të Cilit është gjithëpërfshirëse dhe jeta e të Cilit është e Përjetshme.

E PESTA: Është rrjedhojë e Fuqisë Hyjnore që i krijoi krijesat të pafuqishme e me dëshirë, i bëri ato të varfër e të nevojshëm, i bëri të kenë ankth për të ardhmen dhe u dhuroi dashuri e adhurim. Është rrjedhojë që t'ia komunikojë ekzistencën e Hyjnisë së Vet nëpërmjet të folurit, Krijesës së Tij më të dashur e më të nevojshme duke i bërë ta ndjejnë ekzistencën e Tij ata që janë më të dëshiruar për të gjetur Krijuesin dhe Zotin e tyre .

Kështu udhëtari kuptoi se provat që tregojnë me unanimitet Njësinë e Ekzistencës së Domosdoshme, të cilat jepen nga shpalljet e përgjithshme hyjnore që përmbajnë të vërtetat e “*zbritjes Hyjnore*” dhe “*njobjes Hyjnore*” e përgjigjes së mëshirshme, e bisedës së lavdishme dhe të vetëkomunikimit të përhershëm, përbëjnë një provë më të fuqishme se sa dëshmia për vetë ekzistencën e Diellit në mes të ditës.

Udhëtari më vonë shikoi drejtimin e “*inspirimit*” dhe pa se inspirimi i drejtë e i vëtrtetë në fakt i ngjason “*shpalljes*” në disa drejtime dhe është një mënyrë e foljes Hyjnore. Megjithatë ndodhen dy dallime:

I PARI: Shpallja e cila është shumë më e lartë se frymëzimi vjen zakonisht nëpërmjet engjuve (melekëve), kurse frymëzimi zakonisht vjen direkt: Le të sjellim një krahasim për këtë:

Një mbret ka dy mënyra ligjërimi e urdhëri.

I pari përbëhet nga dërgimi i ndonjërit prej të dërguarve të tij tek ndonjë guvernator i pajisur me të gjithë autoritetin e monarkisë dhe madhësinë e saj. Ndonjëherë, me qëllim që të tregojë madhësinë e sovranitetit dhe rëndësinë e komandës së Tij, Ai mund të takohet me ndërmjetësin para se ai të largohet dhe atëherë mund të lëshohet dekreti.

I dyti: Përbëhet nga të folurit privatisht me personin e tij, jo me titullin e monarkut apo në emrin e mbretërisë përse u përket çështjeve private, të veçanta dhe në një trajtesë të pjesshme duke përdorur për këtë qëllim një shërbëtor të besuar ose një nga të varurit e Tij të zakonshëm. Në të njëjtën mënyrë, monarku i perhershëm mundet të flas në emrin e Zotit të të gjitha botërave dhe me titullin e Krijuesit të Kozmosit, të flasë me shpalljen ose inspirimin gjithëpërfshirës që kryen funksionin e shpalljes, ose Ai mund të flasë në mënyra të ndryshme e private si Zoti dhe Krijuesi i të gjitha qenieve të gjalla nga pas perdes dhe në një mënyrë që i përshtatet marrësit.

DALLIMI I DYTË: Shpallja është pa hije, e pastër dhe e rezervuar për të zgjedhurin. Inspirimi në kontrast, ka një hije, përzierje ngjyrash dhe është i përgjithshëm. Ndodhen disa lloje inspirimesh: si inspirimi i engjëjve, inspirimi i njerëzve dhe inspirimi i kafshëve. Kështu inspirimi

formon një fushë për shtimin e fjalëve të Zotit që janë aq të shumta sa pikat në oqean. Udhëtari ynë kuptoi se kjo çështje është në të vërtetë një lloj komentimi i versetit kur'anor:

لَوْ كَانَ الْبَحْرُ مِدَادًا لِكَلِمَاتِ رَبِّي لَنَفَذَ الْبَحْرُ قَبْلَ أَنْ نَعْلَمَ كَلِمَاتِ رَبِّي

“Sikur deti të ishte bojë për (të shkruar) fjalët e Zotit tim, sigurisht deti do të sosej para fjalëve të Zotit tim...” (Kur'an, 18: 109)

Ndërkohë udhëtari vështrroi natyrën dhe urtësinë e dëshmisë së inspirimit dhe pa se natyra e tij, urtësia dhe rezultati përbëheshin nga katër drita:

E Para: Është rezultati i dashurisë së Zotit dhe i mëshirës që Ai e bën të dashur Vetveten, nëpërmjet fjalës, pranisë dhe bisedës në të njëjtën mënyrë siç e bën të dashur Vetveten për krijesat nëpërmjet veprave të Tij.

E Dytë: Është kërkesë e mëshirës së Tij që ashtu siç u përgjigjet me veprim lutjeve të shërbetoreve të Tij. Ai gjithashtu duhet t'u përgjigjet atyre me fjalë pas perdeve.

E Treta: Është bashkëshoqërim i Hyjnisë që, ashtu siç u përgjigjet me vepra thirrjeve për ndihmë, lutjeve dhe kërkesave të atyre prej krijesave të Tij që janë goditur me fatkeqësi të rënda e mundime, po ashtu Ai duhet të nxitojë për t'u dhënë atyre ndihmë me fjalët e inspirimit që janë një formë bisede.

E Katërta: Zoti i Lartësuar e bën ekzistencën e Tij, praninë dhe mbrojtjen të kuptueshme me veprime për më të dobët e më të nevojshmit e Tij, më të varfërit dhe për krijesa të vetëdijshme që qëndrojnë në nevojë të madhe për të gjetur krijuesin, mbrojtësin, ruajtësin dhe rregullatorin.

Është një rrjedhojë e domosdoshme dhe esenciale e përkujdesjes Hyjnore dhe mëshirës Hyjnore që Ai ta komunikojë Praninë dhe ekzistencën e Tij nëpërmjet bisedimit nga prapa perdes së inspirimit të vërtetë për një individ të veçantë në një mënyrë të veçantë për ta dhe për kapacitetet e tyre me anë të telefonit të zemrave të tyre .

Atëherë udhëtari shikoi dëshminë e inspirimit dhe pa se në qoftë se Dielli për shembull, të kishte vetëdije e jetë dhe në qoftë se shtatë ngjyrat e dritës së Diellit të ishin shtatë atributet, rrezet dhe vetëtimat e dritës do të flisnin në një mënyrë të veçantë; Drita do të gjendej në objekte të tejdukshme, të ngjashme, e jo të ngjashme dhe do t'i fliste çdo lloj pasqyreje dhe objekti të ndritshëm, çdo cope qelqi, çdo pike dhe çdo atomi transparent në harmoni me kapacitetin e secilës. Kështu drita do t'i pergjigjej nevojave të secilës dhe ato si reagim mund të dëshmonin për ekzistencën e Diellit, pa penguar e pa ndërhyrë njëra e atyre tek tjetra dhe pa u përplasur një bisede me tjetrën.

Në të njëjtën mënyrë, biseda e sunduesit të lavdishëm, i para dhe I paspërjetësisë, e Krijuesit të të gjitha qenieve, e Të lartësuarit e Hirëplotë, e asaj Drite të përhershme dhe e Atij Dielli të përjetshëm, shfaqet tek të gjitha gjërat në përgjithësi e në trajtë gjithëpërfshirëse ashtu si “Dituria dhe Fuqia e Tij”, në një mënyrë të përshtatshme me kapacitetin e të gjitha gjërave. Asnjë kërkesë nuk ndërhyr tek tjetra, asnjë detyrë nuk pengon përmbushjen e një detyre të re, dhe asnjë bisedë nuk ngatërrohet me një tjetër. Të gjithë këtë udhëtari ynë e përceptoi si të vetëkuptueshme. Ai mësoi se të gjithë ato tregues, biseda dhe inspirime, të veçuara e të bashkuara dëshmuuan dhe provuan, me unanimitet praninë dhe domosdoshmërinë e ekzistencës dhe unitetit të atij Dielli parapërjetësie, e provuar me shkallën e njohjes së sigurtë, që iu afrua shkallës së vizionit të sigurisë.

Një aluzion të shkurtër prej mësimit që përfitoi udhëtari ynë kureshtar nga bota e të padukshmes, e përmendëm në shkallët katërmbëdhjetë e pesë-mbëdhjetë të vendqëndrimit të parë.

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْوَاحِدُ الْمَوْجِدُ الْوَاحِدُ الْأَحَدُ الَّذِي دَلَّ عَلَى وُجُوبِ وُجُودِهِ فِي  
 وَحْدَتِهِ إِجْمَاعُ جَمِيعِ الْوُجُوهِ الْمَقْتَضِيَةِ لِلتَّنَزُّلَاتِ الْإِلَهِيَّةِ  
 وَالْمَكَامَاتِ الشَّجَائِيَّةِ وَاللِّتْرَفَاتِ الرَّبَّانِيَّةِ وَاللِّفَا بِلَاتِ الرَّحْمَانِيَّةِ  
 عِنْدَ مُنَاجَاتِ عِبَادِهِ وَالِإِشْعَارَاتِ الصَّمَدَانِيَّةِ لَوْجُودِهِ لِخُلُوقَاتِهِ  
 وَكَذَلِكَ عَلَى وُجُوبِ وُجُودِهِ فِي وَحْدِيَّةِ إِتْقَانِ الْإِلَهَامَاتِ  
 الصَّادِقَةِ الْمُتَّصِفَةِ لِلتَّوَدُّدَاتِ الْإِلَهِيَّةِ وَالِإِجَابَاتِ الرَّحْمَانِيَّةِ  
 لِدَعْوَاتِ مَخْلُوقَاتِهِ وَالِإِمْدَادَاتِ الرَّبَّانِيَّةِ لِاسْتِعَاثَاتِ عِبَادِهِ  
 وَالِإِحْسَانَاتِ الشَّجَائِيَّةِ لَوْجُودِهِ بِصُنُوعَاتِهِ

\* \* \*

Atëherë udhëtari nëpërmjet Dynjasë iu drejtua mendjes se tij duke i thënë: Meqë po kërkoj Pronarin tim dhe Krijuesin përmes krijesave të kozmosit, unë duhet para çdo gjëje tjetër të vizitoj njeriun më të shquar ndër të gjithë krijesat, komandantin më të madh e më të famshëm midis tyre. Madje edhe sipas dëshmisë së armiqve të tij, njohësin më të mirë, më të lartin në bisedë dhe më të ndritshmin në mendje, i cili për katërmbëdhjetë shekuj ka dhënë dritë me vlerat e tij dhe me Kur'anin, Muhammedin (*alejhis-selâm*), Profetin arab (*paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të*). Kështu me qëllim që ta vizitojë atë dhe të kërkojë përgjigjen e kësaj pyetje ne duhet të shkojmë së bashku te më i miri i shekujve, te shekulli i lumturisë, shekulli i profetësisë. Atëherë ai, me mendjen e tij u

fut në atë shekull dhe shikoi se ai shekull u bë një nga shekujt e lumturisë së vërtetë për shkak të pejgamberit - Muhammed (*alejhis-selâm*), sepse me anë të dritës që ai solli, i transformoi njerëzit më primitivë e analfabetë në profesorë e njerëz të respektuar të botës.

Kështu udhëtari i foli mendjes së vet. Para se ta pyesim atë, në lidhje me Krijuesin tone, duhet të dimë e të mësojmë rreth vlerave të këtij gjeniu të jashtëzakonshëm, rreth vërtetësisë së fjalëve të tij dhe rreth njoftimeve dhe paralajmërimeve të tij .

Kështu ai filloi të shqyrtojë shumë prova vendimtare që ai gjeti. Ne shkurtazi do të tregojmë nëntë nga më të përgjithshmet.

E PARA: Të gjitha cilësitë e larta, veçoritë e shkëlqyera dhe karakteristikat humane gjenden tek ai person i jashtëzakonshëm, madje edhe sipas dëshmisë së armiqve të tij. Me qindra mrekulli u shfaqën në duart e tij sipas verseteve të qarta kur'anore ose haditheve që gëzojnë statusin e *“tavattur”* (*tavattur është një lloj raportimi që transmetohet nga autoritetet e shumta dhe rreth asaj nuk ka vënd për dyshim - përkthyesi*)

Shembuj nga këto mrekulli janë ndarja në dysh e Hënës:

وَأَنشَأَ الْقَمَرُ

“...dhe Hëna u çka më dysh...” (Kur'an, 54:1) me një tregues të vetëm të gishtit të tij; hedhja e një grushti pluhur në sytë e armiqve të Tij, duke u shkaktuar atyre të ikin e të marrin arratinë.

وَمَا رَمَيْتْ إِذْ رَمَيْتْ وَلَكِنَّ اللَّهَ رَمَى

“Nuk ishte veprimi yt kur ti hodhe (pluhurin në sytë e armikut), por ishte veprimi i All-llahut.” (Kur'an, 8:17); Dhënia ujë ushtrisë së tij të etur nga uji që shpërtheu e gufoi nga pesë gishtat e tij sikur të ishte burimi i Keutherit (një lum në parajsë). Meqenëse, midis atyre mrekullive që numërohen më shumë se treqind janë shtjelluar me prova vendimtare në një veper të mahnitshme e të vyer e të njohur si mrekullitë e Muhammedit (*alejhis-selâm*) te “*Letra e nëntëmbëdhjetë*” ne do ta lëmë diskutimin e mrekullive për atë libër dhe të lejojmë udhëtarin të vazhdojë duke folur.

Një personalitet, i cili përveç moraleve të tij fisnike, veçorive të larta dhe sjelljeve të përsosura, ka të gjitha këto mrekulli të ndritshme për të demonstruar, nuk ka dyshim se Ai është më i vërteti në fjalë ndër të gjithë njerëzit. Do të ishte e pakonceptueshme që ai të zbriste vetveten në mashtrim, hile, gënjështira e mëkate të cilat janë veprime të njerëzve të ulët.

E DYTA: Ai mban në dorën e tij një dekret nga Zoti i krijimit, një dekret i pranuar e i vërtetuar në çdo shekull nga më shumë se treqind milionë njerëz. Ky dekret, Kur'ani, i të Plotëfuqishmit Absolut është i mrekullueshëm në shtatë mënyra të ndryshme. Fakti që Kur'ani ka dyzet aspekte të ndryshme mrekullie dhe se ai është fjala e Krijuesit të të gjitha qenieve, meqenëse është shtjelluar me hollësi, me fakte të fuqishme në “*Fjalën e njëzet e pestë*” te trajtesa “*Mrekullitë e Kur'anit*” një shtjellim i shquar që është si dielli i Risalein-Nurit, ne e lëmë këtë çështje për atë veper, e le të dëgjojmë udhëtarin ndërsa ai thotë: Nuk ka asnjë gënjeshtër nga ana e personit, i cili është përçuesi dhe shpallësi i këtij dekreti, sepse po të kishte mashtrim kjo do të përbënte shkelje të atij dekreti dhe tradhti ndaj Atij që e lëshoi atë dekret.

E TRETA: Ai, peygamberi Muhammed (*sal-l All-llahu alejbi ve sel-lem*) u dërgua për një shariat të pastër (për një ligj të shenjtë), për një fe natyrale, Islamin, për një kod adhurimi, për lutje të

përshpirtshme, për thirrje të përgjithshme e për një besim të ngulitur. Ai është i pashembullt për çfarë u dërgua dhe nuk do të ketë, nuk është gjetur e as nuk do të gjendet njeri më i plotë se Ai. Sepse ligji që u shfaq nga një analfabetë, nga pejgamberi Muhammed (*alejhis-selâm*), i cili drejtoi një të pestën e njerëzimit për katërmëdhjetë shekuj në një mënyrë të drejtë e të saktë përmes urdhëresave të shumta të tij, natyrisht tregon se Ai është i pashoq. Për më tepër, Islami që u shfaq nga veprat, thëniet dhe gjendjet e brendshme të atij njeriu, që s'dinte të shkruante e të lexonte, tregon se ai është i parival, dhe as nuk do të mund të gjendej dikush tjetër si ai, sepse në çdo shekull ai, Islami, ka qenë për treqind milionë njerëz një udhëzues dhe strehë, ka qenë mësuesi e zhvilluesi i mendjeve të tyre, ndriçuesi e pastruesi i zemrave të tyre, ka qenë shkaku për përmirësimin, zhvillimin e shpirtërave të tyre, si dhe burim progresi e përparimi për shpirtërat e tyre.

Muhammedi (*alejhis-selâm*) është i pashoq në mënyrën në të cilën qëndronte në krye përsa i përket vënies në praktikë të të gjitha formave të adhurimit që gjenden në fenë e tij; Ai ishte i pari në përkushtim e në frikë të Zotit të Lartësuar duke zbatuar në mënyrën më të plotë detyrat e adhurimit, dhe me vëmendjen tek përqëndrimi i dimensioneve të tyre më të thella edhe kur ishte në luftë të vazhdueshme e në aktivitete të vështira; Ai në praktikimin e adhurimit nuk imitonte kërkend duke kombinuar në mënyrën më perfekte fillimin dhe fundin e progresit shpirtëror.

Në "*Xhevshen El Kebir*", midis mijëra lutjesh dhe kërkesash, ai e përshkruan Zotin e Lartësuar me një shkallë të tillë (mistike) sa që të gjithë shenjtorët dhe Evlijatë (të pastërtit) që kanë ardhur pas tij nuk kanë mundur të bëjnë një përshkrim të tillë të përpiktë, sikur edhe të bashkoheshin përpjekjet e tyre. Kjo tregon se Ai edhe në falje është i pashoqi.

Kushdo që shikon pjesën tek fillimi i *“Trajtesës për lutjet”*, e cila shtjellon disa anë të kuptimit të njëres nga nëntëdhjetë e nëntë pjesëve të *Xhevshen El Kebir*, do të thonte se nuk ka formë luteje si *“Xhevsheni”*.

Në komunikimin e mesazhit dhe në thirrjen e njerëzve tek e vërteta, ai shfaqti një qëndresë, guxim e një rezistencë të tillë sa që edhe shtete të mëdha, fe, madje edhe njerëzit e popullit të tij, e fisit dhe xhaxhai i tij e kundërshtuan në mënyrën më armiqësore, por ai nuk shfaqti as edhe shenjë më të vogël të ngurimit, ankthit apo frikës.

Fakti se ai me sukses sfidoi të gjithë botën duke e bërë Islamin mësuesin e lavdishëm të botës, provon se nuk ka njeri si ai dhe nuk mund të ketë përsa i përket përcjelljes së mesazhit dhe thirrjes për te Zoti i Lartësuar.

Në besimin e tij ai kishte një forcë të jashtë-zakonshme, një siguri të mrekullueshme, një thellësi e një gjëresi mendimi të mahnitshëm, dhe një bindje shumë të lartë duke ndriçuar të gjithë botën. Asnjë nga filozofitë e të urtëve dhe mësimet e udhëheqësve shpirtërorë nuk kanë qenë mundur, pavarësisht nga armiqësia e skajshme dhe mohimi, t'i shkaktonin sigurisë së tij, bindjes, besimit dhe vendosmërisë së tij as edhe dyshimin më të vogël, ngurrimin, dobësinë apo ankthin. Për më tepër, shenjtoret e të gjitha kohëve, të kryesuar nga shokët e Profetit, që janë pararoja në shkallët e besimit, kanë arritur në përfundimin, përsa i përket burimit të besimit të tij dhe e kanë vlerësuar si përfaqësuesin e shkallës më të lartë të besimit. Kjo tregon se edhe besimi i tij është i pakrahueshëm, prandaj udhëtari ynë, doli me përfundimin dhe vërtetoi me mendjen e tij se gënjeshtër, iluzioni dhe mashtrimi nuk kanë vend tek ai që solli atë ligj të shenjtë unik, atë Islam

të pakrahasueshëm, atë devocion të mahnitshëm adhurimi, atë lutje të shkëlqyeshme, atë thirrje universale të gjithanëshme dhe atë besim të mrekullueshëm.

E KATËRTA: Konsensusi i profetëve është një provë e fuqishme për Njësinë dhe ekzistencën e All-llahut dhe është dëshmi e fortë gjithashtu për vërtetësinë e këtij pejgamberi dhe për mesazhin e tij. Sepse të gjitha atributet e shenjta, mrekullitë dhe funksionet që tregojnë vërtetësinë dhe mesazhin e profetëve (*paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ta*), gjenden në masën më të lartë në personin e Muhammedit (*alejhis-selâm*) sipas dëshmisë së historisë. Ata pejgamberë predikuan me gojë ardhjen e personit të pejgamberit Muhammed (*sal-l All-llahu alejhi ve sel-lem*) dhe kanë dhënë sihariqe në Tevrat, në Ungjill, në Zebur dhe në suhufet (fletushkat) para tyre. Më shumë se njëzet nga shembujt më vendimtarë të këtyre sihariqeve të nxjerra nga shkrimet e shenjta janë shtjelluar e provuar në *“Letrën e nëntëmbdhjetë”*. E ngjashme me këtë, nëpërmjet të gjitha veprimeve dhe mrekullive të shoqëruara me prfoetësinë e tyre, ata kanë pohuar, sikur të kishin vënë firmën e tyre për misionin e atij fisniku, i cili është kryesori dhe më i ploti në detyrat dhe funksionet e profetësisë. Ata profet tregojnë me konsensusin gojor Njësinë Hyjnore, po ashtu dëshmojnë me anë të unanimitetit të veprave të tyre vërtetësinë e atij personaliteti të madh të pejgamberit Muhammed (*sal-l All-llahu alejhi ve sel-lem*). Edhe kjo u kuptua nga udhëtari ynë.

E PESTA: Në mënyrë të ngjashme, mijëra shenjtorë, të cilët arritën të vërtetën, realitetin, perfeksionimin, kerametet, prova zbulosa e dëshmi nëpërmjet instruktimit të këtij mësuesi të madh duke e ndjekur atë, dëshmojnë me unanimitet jo vetëm Njësinë Hyjnore, por gjithashtu edhe vërtetësinë dhe mesazhin e këtij personaliteti.

Përsëri, fakti se ata dëshmojnë përmes dritës së shenjtërisë disa nga të vërtetat që ai shpalli në lidhje me botën e padukshme dhe se ata i besojnë e i vërtetojnë të gjitha ato të vërteta, ose me dritën e besimit ose me njohurinë e sigurisë (ILMUL-JEKIN), ose me esencën e sigurisë (AJNUL-JEKIN), ose me të vërtetën e sigurisë (HAKKUL-JEKIN). Kjo gjithashtu demonstron, ashtu si dielli, shkallën e vërtetësisë e të ndershmerisë së atij njeriu të madh (*paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të*).

E GJASHTA: Me miliona nga studiuesit e pastër e të sigurtë dhe nga filozofët besimtarë, të cilët kanë arritur shkallën më të lartë të të mësuarit me anë të mësimdhënies dhe instruktimit të përfshira në të vërtetat e shenjta të ardhura nga personi i peygamberit Muhammed (*alejhis-selâm*), pavarësisht nga natyra e tij që s'dinte të shkruajë e të lexojë, dijet e larta që ai gjeti dhe njohuritë hyjnore që zbuloi, jo vetëm provojnë e vërtetojnë me unanimitet dhe me argumentet më të forta Njësinë Hyjnore që është themeli i misionit të tij, por gjithashtu dëshmojnë me unanimitet vërtetë-sinë e këtij mësuesi të lartë, udhëheqësi të madh si dhe vërtetësinë e fjalëve të tij. Edhe kjo është një provë aq e qartë sa drita e diellit. Risalein-Nur, gjithashtu me njëqind pjesët e saj është vetëm një pjesë e vetme e vërtetësisë së tij.

E SHTATA: Familja dhe shokët e peygamberit, të cilët me intuitën e tyre, njohurinë dhe arritjen shpirtërore janë më të shquarit, më të respektuarit, më të përkushtuarit dhe më sympreh-tët e njerëzve pas peygamberëve, kanë shikuar e shqyrtuar me vëmendjen më të madhe, me seriozitetin dhe përpikmërinë më të madhe të gjitha gjendjet, mendimet dhe rrethanat e këtij personaliteti, qofshin të fshehura apo të hapura. Ata të gjithë dolën me përfundimin se Ai ishte qenia më e vërtetë, më e lavdëruar dhe më e nderuar në botë. Edhe ky vërtetimi i tyre i palëkundur dhe besimi i fortë është një provë si dita që vërteton realitetin e Diellit.

E TETA: Kozmosi tregon Shpikësin e tij, Përshkruesin, Projektuesin që e krijoi atë sikur të ishte një pallat ose një libër, një ekspozitë apo një shfaqje. Në të njëjtën mënyrë, ai pa dyshim kërkon ekzistencën e dikujt që të shpreh përmbajtjet dhe kuptimet që gjenden në këtë libër të madh, që të mësojë dhe të tregojë qëllimet Hyjnore që qëndrojnë prapa krijimit të universit; që të tregojë urtësinë Hyjnore që qëndron në ndryshimet e kozmosit, që të mësojë rezultatin e lëvizjeve të qëllimshme të tij dhe të tregojë kuptimet e atij libri madhështorë. Meqënëse ekzistenca e tij kërkohet dhe është e domosdoshme, dhe funksionet e tij tregojnë vërtetësinë e këtij Pejgamberi të nderuar. Atëherë Ai, padyshim është nëpunësi më i lartë e më i vërtetë i Krijuesit të Kozmosit.

E NËNTA: Pas perdes ndodhet Një i vetëm, i Cili dëshiron, me këto krijesa mendjemprehta e të zgjuara, plotësimin e talentit të Tij dhe artin; të njohë Vetveten e për t'u bërë i dashur nëpërmjet këtyre krijesave të shumta të zbukuruara e të stolitura; për t'u lavdëruar e falenderuar përmes mirësive të panumërta e të vyera që Ai dhuron; Për t'i bërë njerëzit ta adhurojnë Atë Hyjni, me mirënjohje e vlerësim përmes mbështetjes së Tij të kujdesshme dhe mbrojtëse të jetës së tyre, dhe përmes furnizimit të Tij me ushqim dhe mirësi në një mënyrë të tillë sa që për të kënaqur shijet, orekset dhe ëndjet më të holla; për të shfaqur Hyjninë e Tij përmes ndryshimit të stinëve, të natës e të ditës, dhe përmes veprave të Tij madhështore e domethënëse të urtësisë dhe fuqisë së Tij të mahnitshme krijuese; për të shkaktuar tek këta njerëz që të besojnë në Hyjninë e Tij, me nënshtrim, përlulesi e bindje; të tregojë drejtësinë e Tij dhe vërtetësinë duke mbrojtur vazhdimisht virtytin dhe të virtytshmit e duke shkatërruar te keqen e të këqinjte, duke asgjësuar despotët dhe gënjeshtarët e duke i zhdukur ata me goditje qiellore. Padyshim do të ishte në anën e Kësaj Qenie të paparë Krijesa e Tij më e dashur dhe njeriu më i devotshëm, i cili duke u shërbyer qëllimeve, që sapo u përmendën, zbulon dhe shpjegon misterin e ekzistencës; që gjithmonë vepron në emrin e

Krijuesit të ekzistencës, që kërkon ndihmë e sukses prej Tij dhe që i merr ato vetëm nga Ai – Atëherë kush do të ishte ndonjë tjetër, përveç Muhammedit të Kurejshitve (*paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të*).

Më tej, duke iu drejtuar mendjes së tij, udhëtari tha: Meqenëse këto nëntë të vërteta dëshmojnë realitetin e këtij profeti fisnik, atëherë s'ka dyshim se ai duhet të jetë burim i krenarisë njerëzore dhe burim nderi për botën. Atëherë, në qoftë se ne e quajmë atë krenarinë e botës dhe krenarinë e bijve të Ademit kjo do të ishte shumë e përshtatshme.

Fakti se madhështia e dekretit të të Gjithëmëshirshmit, Kur'anit të mrekullueshëm, që ai mban në dorë, i cili ka pushtuar gjysmën e botës së bashku me plotësimet individuale dhe virtytet e larta, tregojnë se Ai është personaliteti më i rëndësishëm i botës, dhe fjala më e rëndësishme për sa i takon Krijuesit tonë është ajo që Ai shpreh.

Tani shiko: Themeli i të gjitha thirrjeve të këtij Profeti dhe qëllimi i të gjithë jetës së tij bazohet në fuqinë e mbështetur nga qindra mrekulli të qarta e të dukshme. Dhe mijëra të vërteta të larta themelore që përmban feja e shpallur provojnë e dëshmojnë ekzistencën e Ekzistuesit të domosdoshëm, Njësinë e Tij, Atributet dhe Emrat për ta vërtetuar, për ta shpallur e për ta bërë të njohur Atë.

Prandaj, ai është si Dielli në kozmos, prova më brilante e krijuesit tonë. Është ky personalitet që ne e thërrasim *“I Dasheduri i Zotit të Lartësuar”*.

Ndodhen tri forma të një konsensusi të pagabueshëm, ku secila nga ato pohon, vërtetohet dhe vendos firmën e dëshmitarit që dëshmon.

E PARA: Vërtetimi i bërë nga ajo asamble e ndritshme, e njohur dhe e shfaqur kudo në botë si familja e Muhammedit, paqa dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të; duke përfshirë mijëra shenjtorë të lartë me shikimet e tyre depërtuese dhe me aftësi për të kapur të panjohurën, të tillë si imam Aliu (*Zoti qoftë i kënaqur me të*), i cili tha: “*Edhe sikur të ngriheshin përdet, siguria ime nuk do të rritej*”.

Ndërsa Abdul Kadir Gejlani Gauth el-Azam (*iu shenjtëroftë sekreti i tij*), i cili pa Fronin e lartë dhe formën madhështore të Xhebrailit kur ishte ende në tokë.

E DYTA: Vërtetimi i bërë me besim të fortë që lejoi njerëzit të sakrifikojnë jetët e tyre dhe pasurinë e tyre, prindërit dhe fiset e tyre, nga asambleja e shquar e njohur si “*Shokët e Pejgamberit*” të cilët e gjetën veten e tyre midis njerëzve primitivë edhe në një mjedis analfabetësh, të zhveshur nga dukuritë e jetës sociale dhe nga mendimet politike; pa asnjë drejtim e pa asnjë libër të shenjtë, por ishin të humbur në errësirën e periudhës midis profetëve; dhe që në një kohë shumë të shkurtër u bënë profesorë, udhëheqës, sundimtarë të drejtë të popujve e të shteteve më të civilizuara e me përparim shoqëror e politik. Ata sunduan botën nga lindja në perëndim dhe kudo valvitën flamujt e drejtësisë së tyre.

E TRETA: Vërtetimi i mbështetur me unanimitet e njohuri të sigurt nga një grup studiuesish të përpiktë e të thellë, të cilët shfaqen në çdo periudhë kohe, që përparojnë në mënyrë të mahnitshme në çdo art dhe punë në fusha të ndryshme. Dëshmia e sjellur nga këta të gjithë për Njësinë Hyjnore nuk është e veçantë dhe individuale, por e përgjithshme, universale dhe e palëkundur. Sikur të bashkoheshin të gjithë demonët ekzistues nuk do të mundeshin ta sfidonin atë.

Të tilla ish in përfundimet e nxjerra nga udhëtari ynë.

Kështu u përmend një aluzion i shkurtër për mësimin që nxori udhëtari në shkollën e dritës, në shekullin e lumturisë profetike. Kur ai e vizitoi atë shekull të bekuar me mendjen e tij; Ai aluzion u shpreh në shkallën e gjashtëmbëdhjetë të vend-qëndrimit të parë.

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْوَاحِدُ الْوَجُدُ الْوَاحِدُ الَّذِي دَلَّ عَلَىٰ وَجُوبِ  
وُجُودِهِ فِي وَحْدِيَّتِهِ خَيْرٌ عَالِيٍّ وَشَرَفٌ نُّوعٍ بِنِجَادِهِ بِعَظَمَةِ سُلْطَنَةِ  
قُرَائِهِ وَحِشْمَةِ وَسَعَةِ دِينِهِ وَكَثْرَةِ كَلَامِهِ وَعُلُوِّيَّةِ أَحْلَاقِهِ حَتَّىٰ  
يَتَّصِفُ بِأَعْدَائِهِ وَكَذَلِكَ شَهِدَ وَبَرَّهَنَ بِقُوَّةِ مَاتِ الْمَجْرَاتِ الظَّاهِرَاتِ  
الْبَاهِرَاتِ الْمُصَدِّقَةِ الْمُصَدِّقَةِ وَبِقُوَّةِ الْإِفْحَاقِ نَوِي دِينِهِ السَّاطِعَةِ  
الْفَاعِلَةِ بِإِجْمَاعِ إِلِهِ دَوِيِّ الْأَنْوَارِ وَبِإِنْفَاقِ أَصْحَابِهِ دَوِيِّ الْأَبْصَارِ  
وَبِتَوَافُقِ مُحَقِّقِي أَمَلِهِ دَوِيِّ الْبَرَاهِينِ وَالْبَصَائِرِ النَّوَّارَةِ ﷻ

\* \* \*

Udhëtari i palodhshëm e i pangopur, i cili mësoi qëllimin e jetës në këtë botë dhe esencën e jetës që është feja, tani i drejtohet zemrës së tij dhe i thotë: le të shqyrtojme librin e njohur si Kur'ani i mrekullueshëm i cili është fjala e Atij që ne po kërkojmë, është fjala më e vyer dhe është libri më i vërtetë e i urtë në ekzistencë, e që ka sfiduar në çdo shekull këdo që nuk ka pranuar t'i

nënshtrohet. Le të shikojmë çfarë thotë ai, por së pari na duhet të vërtetojmë se ky libër është nga Krijuesi ynë.

Megenëse ky udhëtar jetoi në periudhën aktuale, ai së pari shikoi Risalein-Nurin, Shkël-qimet nga mrekullia e Kur'anit. Ai pa se njëqind e tridhjetë pjesët e Risalein-Nurit janë në vetvete një komentim i çmuar i verseteve kur'anore pasi ato zbulojnë pikat e tyre të holla dhe dritat e tyre ndriçuese, ose japin shpjegime të thella të përmbajtjes së atij libri. Risalein-Nuri lufton trimërisht për të shpërndarë të vërtetat e Kur'anit në të gjitha drejtimet. Në këtë shekull ateist askush nuk mund ta godasi atë çka vërteton se Kur'ani është udhërrëfyes i Risalein-Nurit, burimi i tij, autoriteti dhe dielli i tij; Vërteton se Kur'ani është fjala qiellore nga Zoti i Madhëruar dhe jo fjalë njeriu. Midis qindra provash në pjesët e ndryshme të Risalein-Nurit, prova e vetme e përfshirë në Fjalën e njëzet e pestë te fundi i *Letrës së nëntëmbëdhjetë*, vërteton dyzet aspekte të mrekullisë së Kur'anit në një mënyrë të tillë që kushdo që e sheh atë, duke mos shfaqur aspak kritikë e kundërshtim, admirojnë argumentet e tij, dhe shpreh lëvdata vlerësuese. Udhëtari e la këtë për Risalein-Nurin ta provoje; që Kur'ani është i mrekullueshëm, pra është Fjala e vërtetë e All-llahut, e duke u kthyer vetëm te një tregues i shkurtër i përbërë nga pak pika të cilat tregojnë madhështinë e Kur'anit.

PIKA E PARË: Kur'ani, siç dihet është mrekullia e profetit tonë Muhammedit (*sal-l All-llahu alejbi ve sel-lem*). me të gjitha mrekullitë dhe të vërtetat treguese të vërtetësisë së tij, ashtu edhe Muhammedi (*sal-l All-llahu alejbi ve sel-lem*), është mrekullia e Kur'anit me të gjitha mrekullitë e tij, me provat e profetësisë, me plotësimin e njohurive të tij dhe është provë vendimtare për qenien e Kur'anit si fjalë e Zotit të Lartësuar.

PIKA E DYTË: Kur'ani Famëlartë transformoi krejtësisht jetën shoqërore, ndriçoi horizontet dhe i mbushi ato me lumturi e vërtetësi; ai shkaktoi një revolucion të madh në shpirtërat dhe në zemrat e njerëzve, në mendjet, në individët e tyre, në jetën sociale e politike dhe shkaktoi këtë revolucion ta përjetësonte në një mënyrë të tillë, saqë për katërmbëdhjetë shekuj, në çdo moment, gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtë dhjetë e gjashtë versetet e tij të lexohen me ndejnjën e respektit më të thellë, nga gjuhët e më shumë se njëqindmilion njerëzve, duke i edukuar ata dhe duke ua pastruar shpirtërat dhe zemrat. Sa për shpirtërat, ai ka qenë mjeti i zhvillimit dhe i përparimit; për mendjet ka qenë një orientim e dritë; për jetën vetë jeta dhe lumturia. Një libër i tillë është i pakrahasueshëm e i pashoq, është një çudi, një mahnitje e një mrekulli.

PIKA E TRETË: Kur'ani, që nga ajo kohë e deri në ditët tona, ka treguar një elokuencë të tillë saqë shkaktoi zhvlerësimin dhe uljen poshtë të poemave të njohura si “shtatë poemat e varura”, të cilat ishin poemat e poetëve më elokuentë. Ato qenë shkruar me ar dhe u varën në muret e Qabes. Por, zhvlerësimi i tyre arriti deri në atë pikë saqë e bija e Lebidit, kur po zbriste poemën e babait të saj nga muri i Qabes tha: *“të krahasuara me versetet e Kur'anit, kjo nuk ka më vlerë.”*

Një poet nomad kur dëgjoi versetin kur'anor:

فَاَصْدَعَنَا نَوْمَنَا

“Atëherë shpalle hapur atë që je urdhëruar”, menjëherë ra në sexhde. Njerëzit e pyetën: A u bëre Musliman? Ai tha: Jo. Unë u përkula në sexhde përpara elokuencës së këtij verseti: (Kur'an, 15: 94)

Me mijëra studiues e letrarë të tillë, gjeni të e shkencës së retorikës, si Abdul-Kahir Xhurxhani, Sekkaki dhe Zemahsheri, kanë konstatuar me unanimitet se elokuenca e Kur'anit është përtej kapacitetit njerëzor dhe është i paaritshëm. Kur'ani, gjithashtu qysh nga koha që zbriti, vazhdon të sfidojë duke i ftuar në fushë të betejës të gjithë letrarët egoistë dhe oratorët arrogantë. Ai u tha atyre në një mënyrë të llogaritur për të thyer arrogancën e tyre. »Ejani, prodhoni një sure të vetme si Kur'ani, ose përndryshe pranoni humbjen dhe nënshtrimin në këtë botë dhe në tjetrën.«

Pavarësisht nga kjo sfidë, oratorët kryeneçë të asaj periudhe e braktisën rrugën e shkurtër të bërjes së një sureje të vetme si Kur'ani, dhe në vend të saj zgjodhën rrugën e gjatë të hedhjes së personave dhe pronave të tyre në rrezik. Kjo provon se rruga e shkurtër nuk mund të merret. Me miliona libra në gjuhën arabe janë në qarkullim, disa të shkruara nga miqtë e Kur'anit, me qëllim që t'i gjasojnë dhe ta imitojnë atë, të tjerët të shkruara nga armiqtë e tij, me qëllim që të konfrontohen e ta kritikojnë atë. Sikur njeriu i zakonshëm ta dëgjonte kur këndohet e recitohet Kur'ani, do të detyrohej të thonte se asnjë nga ato libra nuk është në gjendje ta arrijë nivelin e Kur'anit, dhe natyrisht do të shprehej: Kur'ani nuk u ngjason këtyre librave të tjerë, as nuk është i të njëjtit grup si ato. Atëherë Ai duhet të jetë ose poshtë tyre në elokuençë, ose lartë tyre. “Asnjë jobesimtar, e asnjë idiot në botë nuk mund të thotë se ai është poshtë tyre. Prandaj shkalla e tij e elokuençës është mbi të gjithë.” Njëherë një njeri lexoi ajetin:

سَبِّحْ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ

“All-llahut i jep lavdërim gjithëçka është në qiejt e në tokë”, pastaj tha: Unë nuk shoh ndonjë elokuençë të mrekullueshme në këtë verset. Atij iu tha: “Kthehu prapa tek ajo periudhë, ashtu si udhëtari dhe

dëgjo versetin siç u recitua atje. Atëherë ai duke përfytyruar veten e tij të jetë atje para shpalljes së Kur'anit, shikoi se të gjithë qeniet në botë, jetonin në një hapësirë boshe, të pafund e të pakufizuar, në një botë të paqëndrueshme e kalimtare, në konfuzion, errësirë, në mungesë vetëdije e qëllimi. Papritmas ai dëgjoji këtë verset të shpallur nga gjuha e Kur'anit. Verseti hoqi perden nga ana ballore e Kozmosit dhe ndriçoi faqen e globit; kjo folje e parapërjetësisë, ky urdhër i përjetshëm dhe ky instruksion iu dha të gjitha qenieve të vetëdijshme sipas shekujve duke u shfaqur atyre në një mënyrë të tillë, që Kozmosi u bë si një xhami e madhe. I gjithë krijimi, me në krye qiejt e tokën, është futur në përmendjen dhe kujtimin e All-llahut dhe shpall lavdinë e Tij me vitalitet, gëzim e kënaqësi duke përmbushur funksionin e vet.

Të gjithë këtë udhëtari ynë e shikoi. Kështu duke provuar e shijuar shkallën e elokuencës së Kur'anit, dhe duke krahasuar versetet e tjera të tij, me analogji, ai kuptoi një nga mijëra arsyet e shëndosha për pushtimin e gjysmës së globit dhe një të pestën e njerëzimit nga elokuenca e pashoqe e Kur'anit për vazhdimësinë e pandërprerë të sovranitetit të tij të respektuar e madhështor për katërmbëdhjetë shekuj.

**PIKA E KATËRT:** Kur'ani ka demonstruar një ëmbëlsi të vërtetë; kur përsëritja e sendit më të ëmbël ngjall mërzitje. Ai, Kur'ani, nuk shkakton mërzitje te Ai që nuk i është prishur zemra dhe shija. Por leximi i shpeshtë i tij e shton ëmbëlsinë dhe kënaqësinë. Kjo çështje është e vetëkuptueshme te të gjithë njerëzit që nga koha e shpalljes së tij. Madje është bërë proverbiale se recitimi i përsëritur i Kur'anit shton ëmbëlsinë. Kur'ani për më tepër, tregon një freski të tillë, rinim dhe origjinalitet saqë edhe pse ka jetuar për katërmbëdhjetë shekuj dhe ka kaluar nëpërmjet shumë duarve, ai ruan freskinë e tij në një mënyrë sikur të ishte zbuluar pikërisht në atë moment. Çdo shekull e shikon Kur'anin të urdhërojë një brez të ri tamam sikur t'i drejtohet atij

shekulli në veçanti. E ngjashme me këtë, çdo degë e të mësuarit, edhe pse e mban Kur'anin vazhdimisht në anën e saj me qëllim që të përfitoj nga ai, dhe përjetësisht ndjek të njëjtën metodë apo referencë, shikon se Kur'ani mban e ruan origjinalitetin e stilit të tij dhe metodën e komentit.

**PIKA E PESTË:** Kur'ani ka njërin krah në të shkuarën dhe njërin në të ardhmen. Rrënjët e tij janë të vërteta të pranuar me unanimitet e të shpallura nga profetët e mëparshëm të cilët e vërtetojnë dhe e forcojnë atë. Po kështu evlijatë, të drejtit dhe shenjtorët janë frutet që kanë fituar jetën nga pema e Kur'anit. Të gjithë sufitetë e vërtetë dhe shkencat e vërteta të Islamit që tregojnë vitalitetin, begatinë dhe vërtetësinë e asaj peme të bekuar me evolucionin e tyre vital dhe jetojnë në mbrojtjen e krahut të dytë të Islamit. Të gjitha këto dëshmojnë se Kur'ani është vërtetësi, përmbledhje e vërtetësive dhe është një mrekulli e pakrahasueshme.

**PIKA E GJASHTË:** Drejtimet e gjashta të Kur'anit janë të gjitha dritëdhënëse; ato të gjitha demonstrojnë vërtetësinë dhe saktësinë. Poshtë tij janë shtyllat e argumentit e të provës; sipër tij shkëlqejnë xhevahirët e mrekullisë; përpara tij është qëllimi i tij, lumturia e dy botëve; prapa është mbështetja e tij, të vërtetat e shpalljes qiellore; në të djathtën është vërtetimi nëpërmjet dëshmive të nxjerra nga mendje të shëndosha të panumërta, në të majtën është qetësia, siguria serioze dhe nënshtrimi i sinqertë i zemrave të shëndosha dhe ndërgjegjeve të pastërta. Të gjashta këto, duke u marrë së bashku, provojnë se, Kur'ani është kështjella e fortë qiellore që shtrihet nga toka drejt lartësive qiellore.. Atëherë, gjithashtu, Kontrollori i këtij kozmosi, rregulli i vazhdueshëm i sjelljes së të Cilit është të tregojë bukurinë në krijim, të mbrojë mirësinë e ndershmërinë, të shkatërrojë e të zhdukë mashtrimin e gënjeshtëtrën. Ai ka pranuar faktin se Kur'ani është e vërteta dhe e drejta, se nuk është fjala e njeriut dhe nuk ka të meta. Zoti e ka mbështetur Kur'anin dhe e ka vërtetuar

me çfarë i dha pozitën me dominim më të lartë, më të respektuar dhe shkallën më të lartë të nderimit në botë.

Pastaj Pejgamberi i nderuar, Muhammedi (*sal-l All-llahu alejbi ve sel-lem*) burimi i Islamit dhe interpretuesi i Kur'anit, besoi në të dhe e respektoi më shumë se çdo njeri tjetër.

Ndonjëherë shpallja i vinte atij ndërsa ishte në një gjendje midis gjumit dhe zgjimit dhe i pandikueshëm nga fjalë të tjera, por pavarësisht nga natyra e tij analfabete, ai shtjellonte pa ngurrim dhe me besimin më të madh shpalljet e vërteta, në lidhje me të shkuarën dhe të ardhmen, nëpërmjet Kur'anit. Këtë ai e bën nën shqyrtimin e syve të vëmendshëm dhe asnjë gabim nuk u vërejt tek ai. Ai besoi dhe pranoi çdo urdhëresë të Kur'anit dhe asgjë nuk mundi ta lëkundte atë; kjo gjithashtu përbën një provë për natyrën e vërtetë e qiellore të Kur'anit, për faktin se ajo është fjala e bekuar e Krijuesit të Gjithëmëshirshëm.

Lidhja e përrshpirtshme e një të pestës së njerëzimit apo madje e pjesës më të madhe të tyre me atë Kur'an, përkushtimi i zellshëm dhe vëmendja e madhe që ata kanë për urdhërat e tij dhe dashuria e pastër për të. Fakti se me dëshminë e shumë treguesve, vizioneve, zbulesave, e xhindëve, e engjëjve dhe e qenieve shpirtërore që mblidhen si fluturat dashuruese të dritës kudo që Kur'ani recitohet. Ky është një tregues që Kur'ani është libri më i pranuar gjërësisht në Kozmos dhe zë vendin më të lartë të respektit. Fakti që të gjitha klasat e njerëzve, nga më e ulta e më e paditura gjer te më e larta dhe e shkolluara, marrin shumë përfitime nga mësimi i Kur'anit dhe kapin të vërtetat e tij më të thella. Vetë fakti që çdo klasë shkollarësh, në lidhje me qindra nga degët e ndryshme të shkencës islame dhe veçanërisht studiuesit e shariatit apo të ligjit të shenjtë, nga parimet e fesë e të shkencës islame gjejnë përmbushjen e nevojave të tyre dhe përgjigjet e

pyetjeve të tyre në Kur'an. Kjo është një provë se Kur'ani është burim i të vërtetës dhe minerali i realitetit.

Midis letrarëve arabë, njerëz të shquar në retorikë, ata që nuk kanë përqafuar Islamin kanë dështuar në përpjekjen që të prodhojnë një sure apo një pjesë si elokuenca e atyre të Kur'anit, vetëm si elokuenca e qenies së Kur'anit një nga shtatë aspektet e mrekullisë së tij, pavarësisht dëshirës së tyre të madhe për të sfiduar Kur'anin. Përveç kësaj, retoricienë të shquar dhe studiuesit e talentuar, që kanë dëshiruar të fitojnë famë duke ngritur kundërshtime kanë qenë të pamundur të përballen madje vetëm me një aspekt të mrekullisë së Kur'anit, dhe në vend të asaj kanë mbetur të heshtur. E gjithë kjo është një tregues tjetër për Kur'anin si mrekulli dhe përtej kapacitetit njerëzor.

Vlera, lartësia dhe elokuenca e fjalëve matet duke ditur se nga kush erdhën, kujt i erdhën dhe për çfarë qëllimi erdhën. Nga kjo pikëpamje, Kur'ani është i pashoq e i pakrahasueshëm, sepse Kur'ani është një mesazh dhe fjalë nga Zoti, Krijuesi i të gjitha botërave, është një fjalim që nuk mund të imitohet në asnjë mënyrë, nuk ka shenjë që të mund të tregojë mundësinë e mashtrimit e të shtirjes. Ai iu drejtua atij, i cili u dërgua për të përfaqësuar të gjithë njerëzimin ose madje të gjitha krijesat, më të dëgjuarit dhe më të famshmit të llojit njerëzor, fuqia dhe gjërësia e besimit të të cilit i dha ngritje Islamit dhe e ngriti atë te mekami i *Kâb-i Kawsejnit* (distances së dy pjesëve të harkut). Kur'ani shpjegon e qartëson besimin më të lartë e të gjerë, sqaron të gjitha çështjet që lidhen me lumturinë në këtë botë dhe në tjetrën, përfundimin e Kozmosit, qëllimet Hyjnore dhe të gjitha të vërtetat e Islamit; ai tregon çdo anë të universit duke e kthyer ashtu si dikush që kthen hartën apo orën para tij, duke i mësuar njeriut Shpikësin e tij, Krijuesin Fuqiplotë, nëpërmjet

periudhave dhe transformimeve të tij. Atëherë, natyrisht është e pamundur të prodhosh si Kur'anin e mrekullueshëm e të arrish shkallën e tij të mahnitshme.

Atëherë, gjithashtu, karakteristikat e larta të Kur'anit, pikat e tija të holla, veçoritë e tij të larta, misteret dhe kuptimet e tij të thella si dhe parashikimet e tij të shumta përsa i përket të panjohurës me llojet e tyre të ndryshme janë pranuar e vërtetuar me prova e dëshmi nga mijëra studiues ekspertë të nivelit të lartë intelektual dhe të mendjemprehtësisë, të cilët kanë shkruar komente për Kur'anin në tridhjetë, dyzet ose shtatëdhjetë vëllime, sidomos hollësitë e Kur'anit të vërtetuara secila me argumente në njërën nga njëqind e tridhjetë pjesët e Risalein-Nurit, në mënyrë të veçantë, *“Trajtesa e mrekullive të Kur'anit”*, (mekami i dytë i “Fjalës së njëzet”), e cila nxjerr shumë nga mrekullitë e civilizimit prej tekstit të Kur'anit si shembull, i trenave dhe avionit.

Rrerrja e parë (treguesit e Kur'anit) që shfaq treguesit e Risalein-Nurit dhe elektricitetin që gjendet në Kur'an, tetë trajtesat e shkurtëra (të quajtura tetë misteret) që tregojnë shkallën e sistemit të hollë - tek shkronjat e Kur'anit dhe sa shumë sekrete e kuptime kanë ato, dhe trajtesat e shkurtëra që tregojnë pesë aspektet e mrekullisë së versetit të fundit të sures el-Fet'h. Shfaqja e çdo pjese nga pjesët e Risalein-Nurit është një e vërtetë nga të vërtetat e Kur'anit dhe është dritë nga dritat e tij. E gjithë kjo që u tha është një tregues i veçantisë së Kur'anit, i faktit se ai është mrekulli e mahnitje, se ai është gjuha e botës së padukshme, e ardhur në botën e dukshme; Fjala e Krijuesit, Njohësit të së panjohurës. Është për shkak të këtyre karakteristikave dhe veçorive të lartëpërmendura të Kur'anit të treguara në gjashtë pika, gjashtë drejtime e gjashtë mekame (vendqëndrime), që madhështia e tij, pushteti i Tij ndriçues dhe shkëlqimi e autoriteti i shenjtë i tij, kanë ndriçuar vazhdimisht faqen e tokës për një mijë e treqind vjet, dhe kanë marrë respektin më të madh. Është po për shkak të këtyre veçorive që çdo shkronjë e Kur'anit ka fituar dallimin e

dhënies, të paktën dhjetë shpërblime, dhjetë të mira e dhjetë frute të përjetshme. Madje çdo shkronjë e disa verseteve dhe sureve bën të fitosh njëqind, njëmijë ose më shumë nga frutat e përjetshme të Ahiretit, dhe në disa kohë të bekuara drita, shpërblimi dhe vlera e secilës shkronjë rritet nga dhjetë deri në njëmijë.

Udhëtari e perceptoi këtë dhe iu drejtua zemrës së tij. Kur'ani që është kështu mrekulli në çdo anë përmes konsensusit të sureve të tij, përmes harmonisë dhe pajtimit të verseteve, përputhjes së dritave dhe mistereve të tij, korrespondencës së frutave dhe efekteve të tij, dëshmon ekzistencën, Njësinë, Atributet dhe Emrat e Ekzistencës së domosdoshme në një mënyrë të tillë e të qartë saqë dëshmi të pakufishme nga të gjithë njerëzit e besimit të vërtetë mund të thuhet të kenë ardhur nga ajo dëshmi.

Një aluzion i shkurtër për mësimin në lidhje me Njësinë Hyjnore dhe besimin të cilin udhëtari e nxori nga Kur'ani u tha në shkallën e shtatëmbëdhjetë të vendqëndrimit të parë.

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْوَاحِدُ الْأَحَدُ الَّذِي دَلَّ عَلَى وُجُوبِ  
 وَجُودِهِ فِي وَحْدِيَّتِهِ الْقُرْآنُ الْمُعْجَزُ الْبَيِّنَاتِ الْمَقْبُولِ الْمَرْغُوبِ  
 لِاجْتِنَاسِ الْمَلَكِ وَالْإِنْسَانِ وَالْحَيَاةِ الْمَقْرُوءِ كُلِّ آيَاتِهِ فِي كُلِّ دَقِيقَةٍ  
 بِكَمَالِ الْإِحْتِرَامِ بِالْيَسْتِوِيَّاتِ مِليونٍ مِنْ نَوْعِ الْإِنْسَانِ الدَّائِمِ سُلْطَنَتُهُ  
 الْقُدْسِيَّةِ عَلَى أَقْطَارِ الْأَرْضِ وَالْأَكْوَانِ وَعَلَى وُجُودِ الْأَعْصَارِ وَ  
 الزَّمَانِ وَالْحَاكِمِ حَاكِمِيَّتُهُ الْمَعْتَوِيَّةِ التَّوْرَانِيَّةِ عَلَى بَيْضِ الْأَرْضِ  
 وَخُمْسِ الْبَشَرِ فِي أَرْبَعَةِ عَشَرَ عَصْرًا بِكَمَالِ إِحْتِسَامِهِ ۝ وَكَذَلِكَ  
 شَهِدَ وَبَرَّهَنَ بِاجْتِمَاعِ سُورَةِ الْقُدْسِيَّةِ السَّمَاوِيَّةِ وَبِاتِّفَاقِ آيَاتِهِ  
 التَّوْرَانِيَّةِ الْإِلَهِيَّةِ بِتَوَافُقِ أَشْرَارِهِ وَأَنْوَارِهِ وَبِتَطَابُقِ حَقَائِقِهِ  
 وَتَعَرَّيْتِهِ وَأَشَارِهِ بِالشَّاهِدَةِ وَالْعَيَانِ

\*\*\*

Udhëtari ynë, turisti nëpër jetë, tani mësoi se besimi është kapitali më i çmuar që mund të ketë njeriu. Sepse ai i dhuron njeriut të varfër jo më një fushë e banesë të përkohsme e kalimtare, por një pallat, e në të vërtetë, një mbretëri të përjetshme aq të madhe sa i gjithë Kozmosi ose sa vetë bota. Besimi gjithashtu i dhuron njeriut kalimtar gjithçka që atij do t'i nevojitet për jetën e përhershme; e shpëton atë njeri të mjerë, i cili është në pritje të litarëve të exhelit të vdekjes nga asgjësimi i përhershëm. Ai i hap njeriut thesarët e përjetshme të lumturisë së përhershme. Udhëtari, atëherë tha me vete, ec përpara! me qëllim që të fitojmë një shkallë tjetër nga shkallët e pafundme të besimit, le t'i referohemi planit total të Kozmosit e të dëgjojmë çfarë thotë ai.

Atëherë ne do të jemi në gjendje të plotësojmë e ndriçojmë mësimet që kemi marrë nga komponentet dhe pjesët e tij.

Duke shikuar me anë të teleskopit të madh e gjithëpërfshirës, të cilin e kishte marrë nga Kur'ani, ai e pa Kozmosin aq kuptimplotë e të mirëorganizuar saqë kishte marrë formën e një libri të mishëruar i Krijuesit të vetëm e të Gjithëlavdishëm, dhe kishte marrë trajtën e një Kur'ani të trupëzuar Hyjnor dhe formën e një qyteti të bukur e të stolisur të Mëshirëplotit të vetëm. Të gjitha suret, versetet dhe fjalët e atij libri, madje edhe vetë fletët e tij, kapitulli, ndarjet dhe rreshtat, përmes *“fshirjes dhe riafirmimit”* domethënës e të vazhdueshëm të tyre dhe ndryshimi e këmbimi me urtësi i tyre tregojnë në një mënyrë të pakontestueshme dhe unanimisht ekzistencën dhe praninë e Krijuesit të Gjithëditur për gjithçka si Autor i librit, si Përshkrues i Gjithëlavdishëm e i plotë, i Cili shikon çdo gjë në gjithçka dhe që njih lidhjet e të gjitha gjërave me gjërat e tjera.

Kështu të gjitha llojet dhe pjesët e Kozmosit, të gjithë banorët dhe çfarë përfshihet në të, gjithçka që hynë e largohet, të gjitha ndryshimet dhe proceset e holla të ripërtitjes që ndodhin në të gjitha këto, shpallim njëzëri ekzistencën dhe Njësinë e Krijuesit të Lartësuar, e Shpikësit të parival, i Cili vepron me një fuqi të pakufishme e me një urtësi të pafund.

Dhe vërtetohej në këtë dëshmi të madhe të Kozmosit – për ekzistencën e Krijuesit dhe Njësinë e Tij – dy të vërteta të mëdha e të gjëra të përshtatshme me gjërësinë e madhësinë e Kozmosit.

**E VËRTETA E PARË:** Ndodhen të vërtetat e krijimit dhe parashikime të vërtetuara me prova të panumërta nga dijetarët e principeve të fesë dhe të shkencës islame si dhe nga të urtit e Islamit. Ata thonë: meqenëse ndryshimi dhe ndërrimi vërehen në botë e në të gjitha gjërat, bota duhet të

jetë kalimtare dhe e krijuar; ajo nuk mund të jetë e pakrijuar. Në qoftë se ajo është e krijuar, atëherë duhet të jetë një Krijues që ta ketë krijuar atë; dhe meqenëse, çdo gjë në qoftë se nuk është në vetvete as shkak për ekzistencën e vet, dhe as për mosekzistencën e vet, por njëlloj, padyshim ajo gjë nuk mund të jetë e domosdoshme.

Gjithashtu është vërtetuar me prova vendim-tare se nuk është e mundur për gjërat të krijojnë njëra-tjetrën vazhdimisht, në këmbim e me rradhë, pasi kjo është e pamundur, do të shkaktonte një mendim absurd.

Prandaj, ekzistenca e Ekzistuesit të domos-doshëm bëhet e domosdoshme, ngjashmëria e të Cilit nuk mund të ekzistojë, shembëllesa e të Cilit është e pamundur dhe çdo gjë tjetër përveç Atij është e mundur dhe e krijuar prej Tij.

Po, e vërteta e Krijimit ka sunduar e depërtuar në të gjithë Kozmosin dhe shumë sfera të tij janë të dukshme për syrin; pjesa tjetër mund të shihet veçse me mendje, sepse përpara syve, një botë shumë e madhe vdes në çdo stinë të vjeshtës dhe së bashku me të vdesin qindra e mijëra lloje të ndryshme bimësh dhe kafshësh të vogla ku çdo anëtar i çdo specie ngjason në vetvete me një Kozmos të vogël, por megjithatë ajo është një vdekje aq me rregull dhe e disiplinuar saqë të gjitha gjërat lënë prapa në vendin e tyre farëra dhe vezë që në pranverën vijuese do të jenë mjete ringjalljeje e rilindjeje, mrekulli të Mëshirës dhe urtësisë si dhe mrekulli të fuqisë e të lindjes. Ato ia dorëzojnë farërat dhe vezët, fletët e punëve të tyre dhe planin e veprimit duke ua lënë ato atyre në besim e amanet nën kujdesin dhe mbrojtjen e Ruajtësit të Lavdishëm dhe vetëm atëherë ato vdesin.

Në pranverë pemët e vdekura rrënjët e tyre dhe kafshët vijnë përsëri në jetë ashtu siç ishin duke siguruar e sjellë qindra e mijëra shembuj e modele dhe prova të “Mahsberit”, Ringjalljes së Madhe. Në vendin e të tjerave, bimët dhe kafshët duke u ngjasuar tamam atyre vijnë në ekzistencë e në jetë duke shpërndarë dhe përhapur fletët e qenieve të pranverës së mëparshme së bashku me veprat dhe funksionet e tyre, ashtu si një reklamë. Kështu ato demonstrojnë një kuptim të versetit:

وَإِذَا الصُّفُوفُ نُشِرَتْ

»...dhe kur fletët të shpërndahen.«

(Kur'an, 81: 1)

[Dhe kur fletët e shkruara të veprave të çdo njeriu do të happen]

Po kështu, përsa i përket tërësisë së qenies, në çdo vjeshtë vdes një botë e madhe, ndërsa në pranverë një botë tjetër e freskët vjen në ekzistencë. Ajo vdekje dhe ai krijim veprojnë me një mënyrë shumë të rregullt, dhe vdekjet dhe lindjet e panumërta brenda tyre ndodhin me një rregull të madh e në atë mënyrë sikur bota të ishte një shtëpizë ku qeniet e gjalla banojnë për një kohë të caktuar, ku botërat udhëtuese dhe ato emigruese vijnë, përmbushin detyrat e tyre dhe atëherë largohen.

Kështu me qartësinë e diellit, për të gjitha mendjet bëhet e qartë ekzistenca e domosdoshme, Fuqia e pafund, Urtësia e pakufishme e Krijuesit të lavdishëm i Cili krijon dhe sjell në këtë ekzistencë botëra vitale dhe qenie të qëllimshme me urtësi të plotë, njohuri e ekuilibër, me

balancë, rregull e discipline, dhe i Cili atëherë i përdor ato për qëllime e synime Hyjnore e për objektiva mëshire, me fuqi e mëshirë të plotë. Këtë e lëmë për Risalein-Nurin dhe për librat e tjerë fetarë, që t'i diskutojnë më tej çështjet që lidhen me krijimin.

Sa për mundësinë, ajo sundon dhe rrethon të gjithë Kozmosin, sepse ne shohim që të gjitha gjërat, të përgjithshme a të veçanta, të mëdha apo të vogla, nga Ffroni i Zotit gjer në tokë, dhe nga atomi gjer te planeti; të gjitha dërgohen në botë me esencë të veçantë, në formë specifike, me identitet të dallueshëm, me attribute të veçanta, me cilësi urtësie dhe organe të dobishme.

Tani t'i dhurosh asaj esence a thelbi veçoritë e veta nga mundësi të pakufishme të përdorshme; ta veshësh atë me specifikën e saj, me formën dalluese e të përshtatshme prej një mori mundësish e probabilitetesh aq të shumta sa format që mund të kapen; t'a dallosh atë qenie me identitetin e përshtatshëm për të midis mundësive aq të shumta sa vetë numri i anëtarëve të species së saj; të pajisësh me cilësi të veçanta, të përshtatshme e të dobishme për objektin e krijuar që është i paformë e I ngurrhtë midis mundësive dhe probabiliteteve që janë aq të shumta sa llojet apo varietetet e cilësive dhe shkallëve të tyre. Pajisja e asaj krijese që s'ka qëllim e objektiv, që është e hutuar dhe e turbulluar në mes të mundësive dhe probabiliteteve të panumërta, që rezultojnë nga pafundësia e rrugëve dhe modaliteteve të kapshme - ta pajisësh atë me cilësi e urtësi dhe me organe të dobishme, e ta mbështesësh me ato të gjitha, natyrisht këto janë tregues, prova dhe afirmim i ekzistencës së domosdoshme, e Fuqisë së pafund dhe e Urtësisë së pakufishme e Ekzistuesit të domosdoshëm, i Cili skicon, rregullon, specifikon thelbin dhe identitetin, formën dhe trajtën, cilësinë dhe situatën e të gjitha qenieve të mundshme, qofshin të përgjithshme apo të veçanta. Ato tregojnë gjithashtu se asnjë objekt dhe asnjë gjë nuk mund t'i fshihet Atij dhe asgjë nuk është e vështirë për Të dhe se detyra më e madhe për Të është e lehtë ashtu si më e vogla; se

Ai mund të krijojë një pranverë aq lehtë sa një pemë, dhe të krijojë një pemë me aq lehtësi sa një farishte. Atëherë e gjitha lidhet me të vërtetën e mundësisë dhe formon një krah të dëshmisë së madhe të mbajtur nga Kozmosi.

Meqenëse dëshmia e Kozmosit, me dy krahët e me dy të vërtetat, është provuar dhe shpjeguar në pjesë të ndryshme të Risalein-Nurit dhe veçanërisht tek *“Fjalët e njëzet e dy dhe e tridhjetë e dy”*, gjithashtu, te *“Letra e njëzet dhe tridhjetë e tre”*. Ne i referojmë lexuesit tek ato shkrime dhe e presim shkurtë këtë histori tej mase të gjatë.

**E VËRTETA E DYTË:** Sa për të vërtetën e dytë që vjen nga skema e plotë e Kozmosit, e që është gjithashtu krahu i dytë i dëshmisë së tij të madhe e të përgjithshme është çka vijon:

Shihet një e vërtetë kooperimi midis qenieve që përpiqen të vetmuara të ruajnë ekzistencën e tyre dhe të përmbushin funksionet e tyre përmes ndryshimeve të vazhdueshme të trazuara dhe të revolucioneve, një e vërtetë kjo që shtrihet shumë matanë kapacitetit të tyre.

Për shembull, elementet nxitojnë të ndihmojnë qeniet e gjalla; retë ndihmojnë bimët; bota bimore ndihmon botën e kafshëve dhe kjo e fundit ndihmon botën njerëzore. Qumështi çurgon nga kraharorët ashtu si burimi i parajsës – Keutheri- për t'u dhënë ndihmë foshnjëve; fakti se qenieve të gjalla u jepen nevojat dhe ushqimi në një mënyrë që kalon kapacitetin e tyre, në vendet ku nuk e parashikonin; mbushja e qelizave të trupit me grimcat e ushqimeve nëpërmjet nënshtrimit të tyre ndaj Zotit dhe vënies në shërbim të tyre nga Krijuesi Mëshirues. Të gjitha këto dhe shumë shembuj të tjerë nga e vërteta e kooperimit tregojnë Hyjninë Universale e të mëshirshme të Krijuesit të botërave, i Cili e drejton Kozmosin ashtu si një pallat. Objektet e pandjeshme e të pavetëdijshme, megjithëse kooperojnë me njëri-tjetrin në një mënyrë të ndjeshme e të

vetëdijshme, duhet domosdo t'u shkaktohet të nxitojnë për të ndihmuar njëri-tjetrin nga fuqia, mëshira dhe nga Komanda e të Gjithëmëshirshmit, të Urtit, Zotit të lavdishëm.

Kooperimi universal i dukshëm kudo në Kozmos, ekuilibri gjithëpërfshirës sundues me rregullin më të madh në të gjitha gjërat nga planetet tek anëtarët, organet dhe pjesët trupore të qenieve të gjalla; stolisja e penës së të Cilit shtrihet e kalon sipër faqes së ndritshme të qiejve, sipër faqes së zbukuruar të tokës dhe faqeve të bukura të luleve; rregulli që dominon mbi gjithçka, nga rruga e qumshtit e sistemi diellor gjer te frutat si misri e shega; përcaktimi i detyrave tek të gjitha gjërat - nga dielli e hëna; retë e deri te bletët e mjaltit, të gjitha nga këto të vërteta japin dëshmi të madhështisë së përpjesëtuat dhe dëshmia e tyre formon krahun e dytë të dëshmisë së dhënë nga Kozmosi.

Megenëse Risalein-Nuri e ka dëshmuar e sqaruar këtë dëshmi të madhe, ne do të mjaftohemi këtu me këtë tregues të shkurtë.

Një aluzion i shkurtër për mësimin e besimit të nxjerrë nga udhëtari ynë nga Kozmosi, ne e thamë në shkallën e tetëmbëdhjetë të vendqëndrimit të parë.

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْوَاحِدُ الْوَحِيدُ الْمُنْتَعِبُ نَظِيرُهُ الْمُنْكَرُ كُلُّ مَا سِوَاهُ أَنْوَاعِ  
الْأَحَادِ الَّذِي دَلَّ عَلَى وُجُوبِ وُجُودِهِ فِي وَحْدِيَّتِهِ هَذِهِ الْكَيْفِيَّاتُ  
الْكِتَابُ الْكَبِيرُ الْحَقُّ وَالْقُرْآنُ الْبَيِّنَاتُ الْمُنْتَعِبُ وَالْقَضْرُ الْمُرْتَبِطُ الْمُنْتَعِبُ  
وَأَبْلَدُ الْمُحْتَسَمِ الْمُنْتَعِبُ بِإِحْتِمَاعِ سُورِهِ وَأَيَاتِهِ وَكَلِمَاتِهِ وَحُرُوفِهِ  
وَأَنْوَاعِهِ وَفُصُولِهِ وَصُفْوَيْهِ وَسُطُورِهِ وَإِتْفَاقِ أَزْكَائِهِ وَأَنْوَاعِهِ وَ  
أَجْزَائِهِ وَجُزْئِيَّاتِهِ وَسُكُونِهِ وَمُشْتَمَلَاتِهِ وَوَارِدَاتِهِ وَمَصَارِفِهِ  
بِشَهَادَةِ عَظَمَةِ إِحَاطَةِ حَقِيقَةِ الْحُدُوثِ وَالْتَعَاوُنِ وَالْإِمْتِنَانِ بِإِجْمَاعِ  
جَمِيعِ عُلَمَاءِ عِلْمِ الْكَلَامِ بِشَهَادَةِ حَقِيقَةِ تَبْدِيلِ صُورَتِهِ وَمُشْتَمَلَاتِهِ بِالْحِكْمَةِ  
وَالْإِنْتِظَارِ وَتَجَدِيدِ حُرُوفِهِ وَكَلِمَاتِهِ بِالنِّظَامِ وَالْمِيزَانِ وَبِشَهَادَةِ  
عَظَمَةِ إِحَاطَةِ حَقِيقَةِ التَّعَاوُنِ وَالنَّجَاوِي وَالنَّسَائِدِ وَالْتِدَاخِلِ  
وَالْمُؤَازَنَةِ وَالْمُخَافِظَةِ فِي مَوْجُودَاتِهِ بِالنِّشَاطَةِ وَالْعِيَانِ

Pastaj udhëtari i ndezur e kureshtar, i cili po kërkonte Krijuesin e botës e që tashmë kishte përparuar nëpërmjet tetëmbëdhjetë shkallëve dhe u afrua në fund të ngjitjes së fronit të së vërtetës, te vendqëndrimi që u drejtua drejtëpërsëdrejti me njohurinë e të padukshmes dhe ndërkohë i drejtohet shpirtit të tij, duke i thënë: tek *Sureja e madhe* me të cilën hapet Kur'ani, ajetet

që shtrihen nga fillimi e gjer tek fjala **إِيَّاكَ** (vetëm Ty) janë si një formë lavdërimi e lartësimi të shprehura në mungesën e të Lavdëruarit të Vetëm; por fjala **إِيَّاكَ** do të thotë ardhje në prezencën

e Tij dhe adresim i drejtëpërsëdrejt për tek Ai. Ne, gjith-ashtu duhet ta lëmë këtë kërkim në mungesë e ndarje dhe të kërkojmë e të pyesim për objektin e kërkimit nga kërkimi i objektit tonë. Sepse duhet të pyesim diellin, i cili tregon gjithçka në lidhje me diellin dhe Ai që tregon gjithçka do ta tregojë vetveten në formën më të qartë. Ashtu siç e kapim dhe e njohim diellin nga rrezet e tij, po kështu ne mund të përpiqemi për të njohur Krijuesin tonë me kapacitetet tona nëpërmjet Emrave të Tij të Bukur dhe Atributeve të shenjta.

Ne do të parashtrojmë këtu shkurtazi dhe në formë koncize dy nga shumë rrugë që të çojnë tek ky objektiv; dy nga shkallët e pambarueshme të atyre dy rrugëve, dy nga të vërtetat e shumta dhe detajet e atyre dy shkallëve.

**E VËRTETA E PARË:** Shfaqet e dukshme për syrin tonë një e vërtetë gjithëpërfshirëse, e përhershme, me rregullsi e madhështore; është ajo e vërtetë që shkakton ndryshime, transformon dhe ripërtërinë të gjitha qeniet në qiell e në tokë me autoritet urdhërues e me aktivitet të vazhdueshëm. Brenda të vërtetës së saj, në çdo mënyrë aktiviteti urtësie, kapet menjëherë e vërteta e treguesit të Hyjnisë, dhe me rradhë, brenda të vërtetës së saj, në çdo mënyrë të treguesit të mëshirshëm të Hyjnisë, njihet e vërteta e shfaqjes së Hyjnisë. Nga ky aktivitet i autoritetshëm, veprat e Autorit të Plotëfuqishëm dhe të Gjithëditurit mund të dallohen dhe nga prapa perdeve. Ndërsa pas perdes së këtyre veprave zhvilluese e admiruese të Hyjnisë kapen menjëherë Emrat Hyjnorë dhe treguesi në të gjitha gjërat; atëherë prapa perdes së Emrave të bukur, treguesit me shkëlqim e bukuri, mund të shfaqet ekzistenca dhe realiteti i shtatë attributeve të shenjta me shkallën e njohjes së sigurt që është afër shkallës vizionale apo shkallës eksperimentale të sigurisë.

Përmes treguesit të këtyre shtatë attributeve, sipas dëshmisë së të gjithë krijimit, në dhënien e jetës, fuqisë, njohurisë, gjithëdëgjimit, gjithë-shikimit, dëshirës dhe të folurit që i shfaqet syrit të besimit në zemër, në mënyrë të pashmangshme e të vetvetishme dhe me plot siguri, reflekton ekzistenca e Ekzistuesit të domosdoshëm, i Cili përshkruhet me këto attribute. Krijuesi i Vetëm i njohur nga këto emra, Autori i pashoq e i përjetshëm, në formën më të dukshme e të ndritshme se sa Dielli, sepse një libër i bukur e i thellë, domosdoshmërisht kërkon aktin e të shkruarit; një shtëpi e ndërtuar mirë, kërkon aktin e të ndërtuarit. Me rradhë, aktet e të shkruarit bukur e të mjeshtresë perfekte në ndërtim kërkojnë Emrat e shkruarit dhe të ndërtuesit. Dhe titujt e shkrimtarit dhe të ndërtuesit nënkuptojnë qartë artet dhe atributet e të shkruarit e të ndërtuarit. Këto arte dhe këto attribute presupozojnë një person, padyshim Atë që do të kualifikohet nga Emrat dhe atributet në çështjen dhe që ushtron artet në ate çështje. Nuk është e mundur të ekzistojë një veprim pa vepruesin ose një emër pa ndonjë të emërtuar me atë emër. E ngjashme me këtë, është e pamundur të gjendet një cilësi atë që është cilësuar me atë cilësi apo të gjendet një zeje pa një zejtar. Duke u bazuar tek ajo e vërtetë dhe mbi këtë princip, Kozmosi, me të gjithë qeniet që ai përmban, ngjason me një koleksion librash të thellë dhe letrash të shkruara me lapsin e Kaderit, paracaktimit, ose u ngjason ndërtesave të pafund dhe pallateve të ndërtuara me çekiçin e fuqisë së Zotit të Lartësuar. Çdo pjesë e Kozmosit me qindra mënyra të ndryshme, është treguesi i veprave të pakufishme të Zotit të Mëshirshëm dhe i njëmijë e një emrave të cilat janë burim i atyre veprimeve. Emrat e Bukur janë tregues të njëpasnjëshëm të burimit të tyre, të shtatë attributeve të lavdisë së jashtëzakonshme. Dhe së fundi ato shtatë attribute të shenjta e të larta, përbëjnë tregues të panumërt dhe prova të pafundta për ekzistencën e domosdoshme në Njësinë e Sundimtarit të Vetëm e të Gjithëlavdishëm, i Cili është burimi i tyre, dhe Ai të cilin ato attribute e përshkruajnë. Gjithashtu, e gjithë bukuria, mirësia, vlera dhe përsosmëria e përfshirë në të gjitha qeniet

dëshmojnë qartë bukurinë dhe përsosmërinë e veprave Hyjnore, dëshmojnë Atributet Hyjnore, Atributet e përjetshme dhe cilësitë e lavdishme. Ato tregojnë gjithashtu bukurinë e shenjtë dhe përsosmërinë e Vetë Esencës së Shenjtë.

Kështu e Vërteta Hyjnore e shfaqur përmes realitetit të aktivitetit dominues dhe autoritar zbulon vetveten dhe e bën të njohur me anë të cilësive dhe veprimeve si ai i krijimit, shpikjes, formimit dhe sjelljes në jetë me plot njohuri e urtësi. E bën të njohur vetveten nëpërmjet para-caktimit, formimit, administrimit dhe ndryshimit me rregullsi e balancë; me anë të transformimit, shkaktimit të zbritjes dhe të plotësimit të cilat bëhen me qëllim e vullnet; nëpërmjet të ushqyerit, të furnizuarit dhe të dhuruarit bujari e mirësi me butësi e mëshirë.

Dhe brenda të vërtetës së treguesit të Hyjnisë kapet menjëherë e vërteta e zbulimit të Hyjnisë dhe bën të njohur vetveten me treguesit e bukur e të lavdishëm të shtatë Atributeve afirmuese: jeta, njohja, fuqia, dëshira, dëgjimi, shikimi dhe të folurit.

Ashtu si atributi i të folurit, i cili e bën Esencën më të Shenjtë të njohur nëpërmjet shpalljes dhe frymëzimit, në të njëjtën mënyrë, atributi i fuqisë e bën të njohur Krijuesin nëpërmjet veprave të famshme dhe efekteve; secila nga ato është si një fjalë që merr formë të jashtme. Duke prezantuar Kozmosin nga cepi në cep, nëpërmjet mënyrës së librit dallues të mishëruar, ai përshkruan dhe bën të njohur Një të Plotfuqishëm Madhështor.

Sa për atributin e njohurisë, ai bën të njohur Njësinë e Esencës më të shenjtë, nëpërmjet çdo objekti të vënë me urtësi, rregullsi e simetrikisht në krijim, nëpërmjet çdo krijese të administruar, të drejtuar, të stolitur dhe e bërë e dallueshme nga Njohuria e Zotit të Lartësuar. Sa për atributin e jetës, ai provohet jo vetëm nga vetë dëshmitë e saj, por gjithashtu nga të gjitha veprat që e

njoftojnë fuqinë e Zotit të Lartësuar nga të gjitha format edhe situatat e mirërregulluara, të bëra me urtësi, të stolisura e të vendosura simetrikisht të cilat tregojnë Njohurinë e Zotit të Lartësuar, të gjitha provat e të gjitha Atributeve të tjera.

Kështu jeta, duke treguar të gjitha qeniet e gjalla që veprojnë si pasqyra reflektuese të atyre provave të shumta, bën të njohur Një të Vetëm Ekzistues të përhershëm.

Gjithashtu është ky atribut që vazhdimisht ndryshon Kozmosin me qëllim që të sjell freski, tregues të ndryshëm e vizatime dhe e transformon atë në një pasqyrë të përbërë nga pasqyra të panumërta më të vogla. E ngjashme me këtë, Atributet e të shikuarit, të dëshirës, të dëgjuarit dhe të folurit, secili zbulon e bën të njohur Esencën më të shenjtë ashtu siç bën Kozmosi. Në të njëjtën mënyrë, ashtu si atributet që tregojnë ekzistencën e Krijuesit të Gjithëlavdishëm ato gjithashtu tregojnë në formën më të qartë ekzistencën dhe realitetin e jetës, të jetuarit dhe përjetësisë së asaj Essence. Sepse njohja është shenjë e jetës; të dëgjuarit është një tregues i jetës; të shikuarit i përket vetëm të jetuarit; dëshira ndodh vetëm me jetën, fuqia e qëllimshme gjendet vetëm në të jetuarit, dhe të folurit është një detyrë për ato që janë pajisur me njohjen e jetës.

Nga këto pika kuptohet se Atributi i Jetës ka prova e argumente sa shtatë herë madhësia e Kozmosit dhe bën të njohur ekzistencën e saj dhe Ekzistencën e Atij, të Vetmit, që ajo përshkruan. Kështu ajo vjen të jetë themeli dhe burimi i të gjitha attributeve, origjina dhe mbështetja e Emrit më të madh.

Meqenëse Risalein-Nuri e vërteton këtë të vërtetë të parë me prova të fuqishme, ne do të mjaftohemi vetëm me një pikë të përmendur nga ky oqean.

E VËRTEËTA E DYTË: Fjala Hyjnore që buron nga Atributi i të folurit

لَوْ كَانَ الْبَحْرُ مِدَادًا لِكَلِمَاتِ رَبِّي

“Sikur deti të bëhej bojë” për fjalët e Zotit tim...

Sipas kuptimit të brendshëm të këtij verseti, Fjala Hyjnore është e pafund. Shenja më e qartë që tregon ekzistencën e diçkaje është të folurit e saj. Prandaj, kjo e vërtetë përbën një dëshmi të pafund për ekzistencën dhe Njësinë e Folësit të Përrjetshëm. Për këtë të vërtetë të shpalljes dhe inspirimit, erdhën dy dëshmi të fuqishme që u shtjelluan në shkallën e katërmbëdhjetë e të pesëmbëdhjetë të kësaj trajtese. Një provë tjetër e madhe jepet nga librat e shenjtë qiellore, siç u tregua në shkallën e dhjetë. Mëtej jepet prova më brilante e gjithëpërfshirëse nga Kur'anit i mrekullueshëm e plot urtësi, siç u diskutua në shkallën e shtatëmbëdhjetë. Për të gjitha këto arsye, ne i referojmë lexuesit tanë tek ato shkallë për komentimin dhe afirmimin e kësaj të vërtete, pasi janë të mjaftueshme për ne dhe për udhëtarin tonë i cili qe i pamundur të kalonte përtej kësaj pike. Dritat dhe misteret e përfshira në këtë verset sublim të Kur'anit e tregojnë këtë të vërtetë në mënyrë të mrekullueshme dhe u shton dëshminë e vet të gjitha atyre të mëparshmeve.

شَهِدَ اللَّهُ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ وَالْمَلَائِكَةُ وَأُولُو الْعِلْمِ  
قَائِمًا بِالْقِسْطِ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ

*“Zoti dëshmon se nuk ka zot tjetër përveç Atij. Siç bëjnë melekët dhe dijetarët e vërtetë; të qëndrueshëm e të paanshëm në drejtësi; nuk ka zot tjetër përveç Atij, të Plotëfuqishmit, të Urtit.”*  
(Kur'an, 3: 18)

Një aluzion për thelbin e mësimin të mësuar nga udhëtari ynë në këtë vendqëndrim të shenjtë, ne e thamë në *shkallën e nëntëmbëdhjetë të vendqëndrimit të parë*.

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْوَاحِدُ الْوَاحِدُ الْوَاحِدُ الْأَمَدُ الْأَمَدُ الْأَمَدُ الْحُسْنَى  
 وَالصِّفَاتُ الْعُلْيَا وَالْمَثَلُ الْأَعْلَى الَّذِي دَلَّ عَلَى وُجُوبِ وُجُودِهِ  
 فِي وَحْدِيَّتِهِ اللَّذَاتُ الْوَاحِبُ الْوَاحِدُ بِالْجَمَاعِ جَمِيعُ صِفَاتِهِ الْقُدْسِيَّةِ  
 الْمَحِيظَةُ وَجَمِيعُ أَسْمَائِهِ الْحُسْنَى الْمُبْتَلِيَّةِ بِاتِّفَاقِ جَمِيعِ شُؤْنَاتِهِ  
 وَأَفْعَالِهِ الْمُتَصَرِّفَةِ بِشَهَادَةِ عَظَمَةِ حَقِيقَةِ تَبَارُزِ الْأُلُوْهِيَّةِ فِي  
 تَطَاهُرِ رُبُوبِيَّتِهِ فِي دَوَامِ الْفَعَالِيَّةِ الْمَسْئُولِيَّةِ بِفِعْلِ الْإِبْحَادِ وَالْخَلْقِ  
 وَالصَّنْعِ وَالْإِبْدَاعِ بِإِرَادَةٍ وَقُدْرَةٍ وَيَفْعَلُ الْقُدِيرِ وَالصُّمُورِ  
 وَالْقُدِيرِ وَالسُّدُورِ بِإِخْتِيَارٍ وَحِكْمَةٍ وَيَفْعَلُ التَّضْرِيْفِ وَالنَّظْمِ  
 وَالْمَحَافِظَةِ وَالْإِدَارَةَ وَالْإِعَاشَةَ بِقَضْدٍ وَرَحْمَةٍ وَيَكْمُلُ  
 الْإِنْتِظَامَ وَالْمُوَازَنَةَ وَبِشَهَادَةِ عَظَمَةِ إِحَاطَةِ حَقِيقَةِ أَسْرَارِ  
 شَهَادَةِ أَنْهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ وَالْمَلِكُ وَأُولُو الْعِلْمِ قَائِمًا  
 بِالْقِسْطِ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ

## SHËNIM:

Secila nga të vërtetat që japin dëshminë e tyre në nëntëmbëdhjetë shkallët e kapitullit të parë të vendqëndrimin të dytë, jo vetëm që tregojnë domosdoshmërinë e ekzistencës përmes ekzisten-cës dhe pranisë, por gjithashtu përmes gjithëpër-fshirjes së tyre vërtetojnë unitetin dhe Njësinë Hyjnore duke provuar ekzistencën e Zotit në mënyrë të qartë.

Sa për kapitullin e dytë, të vërtetat e Njësisë jepen shumë qartë me çfarë përmban ai kapitull në lidhje me vërtetimin e ekzistencës së Zotit të Lartësuar. Ky kapitull u emërua “*Provat e Njësisë*”.

Në realitet të dy kapitujt së bashku vërtetojnë ekzistencën dhe Njësinë, por për hir të dallimit midis tyre, ne thamë në mënyrë të përsëritur në kapitullin e parë:

بِشَاهَادَاتٍ عَظَمَتْ إِحَاطَتِ حَقِيقَتِ

“Nëpërmjet dëshmisë së madhështisë së gjithëpërfshirjes së të vërtetës...” Ndërsa në kapitullin e dytë:

مُشَاهَدَاتٍ عَظَمَتْ إِحَاطَتِ حَقِيقَتِ

“Nëpërmjet shikimit të madhështisë së gjithëpërfshirjes së të vërtetës...” duke treguar kështu shikimin e qartë të Njësisë. Unë kisha si qëllim t'i shpjegoja shkallët e kapitullit të dytë ashtu siç bëra në kapitullin e parë, por për shkak të pengesave të ndryshme, që më dolën përpara do ta jap atë të përmbledhur.

Unë do t'ua lë pjesëve të tjera të Risalein-Nurit t'i shpjegojnë këto çështje siç meritojnë të komentohen.

## **KAPITULLI I DYTË PROVAT E NJËSISË HYJNORE**

Ai udhëtari i dërguar në këtë botë me qëllim që të gjejë besimin, që udhëtoi përmes të gjithë kozmosit me mendjen e tij, me qëllim që të pyesë e të kërkojë të gjitha gjërat që lidhen me Krijuesin e tyre; që të kërkojë Zotin e tij në çdo vend e të gjejë Krijuesin e tij me sigurinë më të plotë, te pika e ekzistencës së domosdoshme. Udhëtari i tha mendjes së tij: Eja të marrim një udhëtim të ri me qëllim që të shohim provat e Njesisë së Ekzistuesit Krijues. Ndërkohë u nisën së bashku. Në vendqëndresën e parë ata panë katër të vërteta të shenjta të cilat sundonin të gjithë Kozmosin, të vërteta që në mënyrë të pakontestueshme bënë të domosdoshëm Njesisin e Zotit të Lartësuar.

## E VËRTETA E PARË – ABSOLUTE

Marrja dhe shqetësimi i çdo klase njerëzore me një mënyrë adhurimi të diktuar nga gjendjet e pozitave të tyre natyrore, llojet e adhurimit që ndërmerren nga gjallesat e tjera si dhe nga qeniet e pashpirta përmes kryerjes së funksioneve të tyre esenciale, mënyra në të cilën të gjitha mirësitë natyrore e shpirtërore dhe dhuratat në Kozmos bëhen mjete që nxisin njerëzit për adhurim, falenderime, lavdërime e mirënjohje; mënyra në të cilën të gjithë treguesit e të padukshmes, të shpirtit, shpalljes dhe inspirimit tregojnë me unanimitet përshtatshmërinë ekskluzive të Zotit të vetëm për t'u adhuruar. E gjithë kjo, në formën më të qartë, provon realitetin dhe dominimin e një Hyjnie të Vetme e Absolute. Në qoftë se e vërteta e një Hyjnie të tillë ekziston, atëherë Ajo kurrësesi nuk mund të pranojë rivalitet e ortakëri sepse ata që i përgjigjen Hyjnisë - domethënë, përshtatshmërisë për t'u adhuruar - me falenderime e adhurim janë të ndërgjegjshëm dhe fruta të vetëdijshme në degët më të larta të pemës së Kozmosit. Në qoftë se të tjerët do të mundeshin t'i kënaqnin, t'i shpërblenin e t'i vendosnin nën obligimin e tyre ato qenie të ndërgjegjshme në një mënyrë që t'i bënin ato të devijojnë e të harrojnë objektin e tyre të vërtetë të adhurimit, i Cili, në të vërtetë mund të harrohet shpejt për shkak të padukshmërisë së Tij. Kjo do të ishte një kontradiktë e tillë për Esencën e Hyjnisë dhe për qëllimet e saja të shenjta saqë në asnjë mënyrë nuk mund të lejohet. Është pikërisht kjo arsyeja që Kur'ani aq shpesh dhe me aq vrull e hedh poshtë politeizmin dhe i kërcënon politeistët me zjarrin e Ferrit.

## E VËRTETA E DYTË: PERËNDIA ABSOLUTE.

Veprat e kudondodhshme nga një Dorë e fshehur gjithandej Kozmosit, e veçanërisht te gjallesat me plotë ertësi e mëshirë, për rritjen e zhvillimin e tyre të realizuara kudo në të njëjtën mënyrë dhe në një formë krejtësisht të papara-shikuar, padyshim duhet të jetë burimi dhe drita e një Zoti Absolut, madje një provë vendimtare e Realitetit të Tij. Një Zot i Tillë Absolut nuk mund të pranojë partneritet. Sepse synimet dhe qëllimet e rëndësishme të Zotit, si treguesit e Bukurisë së Tij, shpallja e plotësimit të Tij dhe i veprave të Tij të çmuara e artistike dhe e mrekullive të mahnitshme janë kombinuar e grumbulluar te çdo gjallesë, madje edhe tek ato të pjesshmet. Prandaj Perëndia Absolute kurrësesi nuk mund ta pranojë shirkun (të përshkruarit ortakë Zotit) apo partneritetin. Sepse një ndërhyrje rastësisht e ortakërisë tek çdo ekzistencë, sado e pjesshme të jetë ose tek çdo gjallesë sado e vogël a e thjeshtë, padyshim do të prishte arritjen e atyre qëllimeve dhe do t'i shkatërronte ato synime. Të largosh fytyrat e qenieve të ndërgjegjshme nga ato qëllime dhe nga Ai i Vetmi që i krijoi e i ngjizi ata, me qëllim që t'i orientosh ata tek shkaqet, do të ishte krejtësisht kundërshtim e armiqësi ndaj Esencës së Perëndisë. Perëndia Absolute do ta mohonte me çdo mënyrë ortakërinë dhe llojet e tij. Udhëzimet e shumta e të vazhdueshme të Kur'anit për Njësinë e Zotit, për shenjtërinë dhe lartësinë e Tij, në versetet e Tij, në fjalët e madje shkronjat dhe format e tyre natyrisht burojnë nga ky sekret i madh.

## **E VËRTETA E TRETË: PËRKRYERJET DHE PLOTËSIMET.**

Dëshmia e pakundërshtueshme për ekzisten-cën e të vërtetës së përkryerjeve që jepet nga të gjitha shembujt e lartë të urtësisë në krijim, në të gjitha bukuritë mahnitëse, në ligjet e Tij të drejta, në qëllimet e Tij të urta dhe, në veçanti, dëshmia e Tij për përkryerjet e Krijuesit, i Cili e nxori në dritë Kozmosin nga asgjëja dhe atëherë e drejtoi atë në çdo anë për bukuri e mrekullueshëm. Dhe përderisa është plotësimi i njeriut, i cili është pasqyra e vetëdijshme e Krijuesit - një dëshmi e tillë është tej mase e qartë: përderisa ekziston e vërteta e plotësimit dhe e sigurisë që Krijuesi i Cili i dha formën kozmosit me përkryerje, padyshim duhet që Ai vetë të ketë plotësimin dhe përkryerjen. Për më tepër, plotësimet e njeriut, frytit më të rëndësishëm të krijimit, kalifit (zëvendësit) të Zotit të Lartësuar në tokë, objektit më të dashur e të vyer të krijimit të Tij, që edhe këto provohen të vërteta. Atëherë t'i përshkruash ortakë Zotit të Lartësuar është e papranueshme dhe gënjeshtër. Sepse ortakëria do të dënonte me shkatërrim të gjitha ato qenie të krijuara me plotë urtësi e përkryerje të cilat ne i shohim para syve tonë; kjo do ta shndërronte kozmosin në një lodër të kotë të rastësisë; një vend argëtimi për natyrën, një thertore të egër për gjallesat dhe një shtëpi të llahtarshme fatkeqësishtë për krijesat e ndërgjegj-shme; kjo do ta zbriste e zvogëlonte njeriun, plotësimet e të cilit janë të dukshme në veprat e tij, do ta zbriste tek niveli i kafshës së mjerë, të turbulluar e të pavlefshme; dhe do të vendoste një perde përmes plotësimeve të pafund të Krijuesit që reflektohen në pasqyrën e të gjitha qenieve, duke shfrytëzuar kështu rezultatin e Aktivitetit të Tij e duke mohuar forcën e Tij krijuese.

Kjo ortakëri kurrësi nuk mund të mbështetet mbi ndonjë vërtetësi dhe kurrësi nuk mund të gjendet në ekzistencë. Meqenëse kontradikta e shirkut, plotësimet e njeriut e të Kozmosit dhe

përgënjeshtrimi i tij prej tyre meqë është vërtetuar e shpjeguar në vendqëndrimin e parë të “Rrezes së dytë” (kushtuar tre frutave të Njësisë Hyjnore), me prova të fuqishme e vendimtare, ne i referojmë lexuesit tonë tek ajo punë dhe e presim shkurt diskutimin këtu.

## **E VËRTETA E KATËRT: SOVRANITETI ABSOLUT.**

Kushdo që e sodit Kozmosin me një vëmendje të plotë e të gjërë do ta shikojë se ai i ngjason një mbretërie shumë aktive e të lulëzuar, i gjason një qyteti të administruar me shumë urtësi e rregull; Ai shikon se të gjitha gjërat dhe llojet i janë nënshtruar me bindje e merren me një detyrë të veçantë.

Sipas metaforës ushtarake që përmban ky ajet:

وَلِلَّهِ جُنُودُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ

“(Të) Zotit janë ushtritë e qiejve e të tokës” (Kur'an, 48: 4) - komandat plotë urtësi, urdhërat e autoritetshme dhe ligjet mbretërore të shpallura në ato ushtri të shumta që shtrihen nga ushtritë e atomeve, batalionet e botës bimore, brigadat e mbretërisë së kafshëve gjer tek ushtritë e yjeve, të gjitha këto janë ushtri që përqafojnë ushtarin më të ulët dhe komandantin më të lartë - dhe të gjitha këto tregojnë në mënyrë të pakundërshtueshme ekzistencën e sovranitetit absolut dhe të autoritetit universal. Atëherë është e vërteta e sovranitetit absolut dhe nuk ka të vërtetë që t'i përshkruajë ortak Zotit të Lartësuar, sepse sipas të vërtetës vendimtare të ajetit kur'anor:

## لَزَكَانَ فِيهِمَا إِلَهًا لَّهُ لُفْسَدَاتَا

“Po të kishte në qiej e në tokë zotra (të tjerë) përveç All-llahut, sigurisht ato, do të prisheshin (pra qiejt e toka do të shkatërroheshin.” (Kur'an, 21: 22)

Në qoftë se shumë duar do të futeshin në të njëjtën detyrë, rezultati do të ishte i ngatërruar. Po të ishin dy mbretër në një vend apo dy kryetarë në një rreth, rregulli do të prishej dhe administrata do të shndërrohej në anarki.

E vërteta është se ne shohim kudo një rregull të tillë duke filluar nga qelizat e trupit deri te shenjat e planeteve, saqë nuk ka ndonjë mundësi për ndërhyrjen e ndonjë ortaku në punët e Zotit të Lartësuar.

Sovraniteti në vetvete është një pozitë dinjiteti; kjo pozitë nuk pranon rival, pasi do të bënte të shpërfillet dinjiteti dhe do të shkaktonte thyerjen e atij sovraniteti. Fakti se njeriu i cili ka nevojë të ndihmohet nga të gjithë njerëzit për shkak të pafuqisë së tij, ose fakti që ai do të vriste vëllezërit e tij apo djemtë në mënyrën më mizore, për hir të një monarkie të përkohshme e të pjesshme, në aparcë, tregon se sovraniteti refuzon çdo nocion të ortakërisë apo rivalitetit. Në qoftë se një njeri kaq i dobët sillet kështu për hir të një sovraniteti të pjesshëm, atëherë Monarku i fuqisë Absolute, Autori i Gjithëkrijimit, nuk do të lejonte në asnjë mënyrë tjetërkënd përveç vetvetes, që të marrë pjesë në sovranitetin e Tij të shenjtë, i cili është boshti i Hyjnisë së Tij të vërtetë e Absolute.

Meqenëse kjo e vërtetë është konfirmuar me prova të forta nëpër vende të shumta të Risalein-Nurit dhe veçanërisht në vendqëndrimin e dytë të “Rrezes së dytë”, ne i referojmë lexuesit tonë tek ato faqe për diskutim më të hollësishëm të saj.

Nëpërmjet dëshmisë së këtyre katër të vërtetave, udhëtari ynë arriti të njohë Njësinë Hyjnore me shkallën e sigurisë e me dëshminë e qartë. Ndërkohë besimi i tij ndriçoi, dhe me gjithë fuqinë e tij tha:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ

“Nuk ka zot tjetër përveç All-llahut një të vetëm e të pashoq”.

Një aluzion të shkurtër për mësimin që ai nxori nga ky vendqëndrim, ne e thamë në kapitullin e dytë të vendqëndrimit të parë.

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْوَاحِدُ الْأَحَدُ الَّذِي دَلَّ عَلَى وَحْدَانِيَّتِهِ وَوَجُوبِ  
 وَجُودِهِ مُشَاهَدَةٌ عَظِيمَةٌ حَقِيقَةٌ تَبَارُزُ الْأَوْهِيَّتِ الْمَطْلُوقَةِ ﴿١﴾  
 وَكَذَا مُشَاهَدَةٌ عَظِيمَةٌ إِحَاطَةٌ حَقِيقَةٌ تَطَاهَرُ الرُّبُوبِيَّتِ الْمَطْلُوقَةِ  
 الْمُفْتَضِيَّةِ لِلْوَحْدِ ﴿٢﴾ وَكَذَا مُشَاهَدَةٌ عَظِيمَةٌ إِحَاطَةٌ حَقِيقَةٌ  
 الْكَمَالَاتِ النَّاشِئَةِ مِنَ الْوَحْدِ ﴿٣﴾ وَكَذَا مُشَاهَدَةٌ عَظِيمَةٌ  
 إِحَاطَةٌ حَقِيقَةٌ الْحَاكِمِيَّةِ الْمَطْلُوقَةِ الْمَانِعَةِ وَالْمُسَافِيَةِ لِلشَّرِكَةِ

\*\*\*

Atëherë udhëtari i paqetë iu drejtua zemrës së tij e i tha: Fakti që njerëzit e besimit e veçanërisht ai i ndjekësve të sufizmit, që janë vazhdimisht duke përsëritur fjalët: **لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ** “*Nuk ka zot tjetër përveç All-llahut*”, përfshin disa shkallë.

Një vërtetim i tillë është për më tepër detyra më e kënaqshme, më e vlefshme, më e larta dhe më e shenjta, është funksionimi natyral dhe akti më i lartë i adhurimit. Atëherë, me qëllim që të ngjitemi edhe më lartë në shkallë, eja o zemër të hapim derën e një vendqëndreseje tjetër në këtë shtëpi edukimi. Sepse afirmimi i vërtetë i Njësisë së Zotit të Lartësuar, që ne kërkojmë, nuk është thjeshtë një lloj njohurie e imagjinueshme, por është një lloj vërtetim që me termat e logjikës gjykohet si e kundërta e imagjinatës., d.m.th. është shumë më e vlefshme se sa pranimi i bazuar në imagjinatë. Ai është rezultati i provës dhe është e përcaktuar si njohje.

Afirmimi i vërtetë i Njësisë së Zotit të Lartësuar është gjykim, vërtetim, pohim e pranim ku njeriu mund të drejtohet te Zoti i tij i Lartësuar dhe nëpërmjet çdo gjëje dhe mund të shikojë çdo gjë rrugën e ndritshme që çon tek Zoti i tij Bujar dhe asgjë nuk e pengon qetësinë e zemrës së tij dhe praninë e Zotit të tij. Përndryshe, njeriu gjithmonë, do të detyrohej të grisë e të flakë mënjane perden e Kozmosit me qëllim që të gjejë Krijuesin e tij. Për këtë arsye, udhëtari tha me vete ndërsa trokiti tek dera e Lavdisë dhe e madhësisë së Zotit të Lartësuar.

Ndërkohë, ai futet në një vendqëndrim të veprave dhe punëve të All-llahut, në botën e krijimit e të zanafillës. Aty ai pa se pesë të vërteta gjithëpërfshirëse sundonin të gjithë Kozmosin dhe jepnin prova të pakundërshtueshme për Njësinë Hyjnore.

**E VËRTETA E PARË:** E vërteta e Krenarisë dhe e Madhësisë.

Meqenëse kjo e vërtetë është shpjeguar me prova të ndryshme në vendqëndrimin e dytë të “*Rrezes së dytë*” dhe në vende të ndryshme të Risalein-Nurit, ne mjaftohemi këtu me çka vijon: Ai që krijon e pastaj drejton në një kohë të vetme dhe në një mënyrë të vetme yjet që janë me mijëra vite larg njëri-tjetrit; Ai që krijon në një kohë të vetme dhe në të njëjtën formë anëtarë të panumërt të të njejtit lloj të një luleje të mbjellur në lindje ose në perëndim, në veri ose në jug të globit; që administron, ushqen, gjallëron, dallon dhe zbukuron më shumë se dyqindmijë lloje të ndryshme bimësh dhe specie kafshësh për pesë ose gjashtë javë, me rregullin më të madh, me ekuilibër pa ndonjë konfuzion, defekt e gabim me qëllim që të sjell në çdo pranverë në faqen e tokës më shumë se njëqind mijë shembuj e modele të ringjalljes së madhe, duke provuar para syve të njeriut e duke bërë të ditur një ngjarje të jashtëzakonshme që i përket të shkuarës dhe botës së padukshme, kryesisht Krijimit të qiejve e të tokës për gjashtë ditë, siç tregohet në versetin kur'anor:

هُوَ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ

“Ai është i Cili krijoi qiejt dhe tokën në gjashtë ditë.” (Kur’an, 57: 4)

Është Ai që e çon tokën të rrotullohet siç deklarohet në ajetin kur'anor:

يُوجِبُ اللَّيْلَ فِي النَّهَارِ وَيُوجِبُ النَّهَارَ فِي اللَّيْلِ

“Ai shkrinë natën me ditën dhe ditën me natën.” (Kur'an, 31: 29)

Duke regjistruar e fshirë, me anë të këtij rrotullimi, ngjarjet e përditshme dhe ndryshimet e tyre në faqen e natës e të ditës. Ai në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin çast njuh dhe administron sipas vullnetit të Tij të gjitha sekretet dhe mendimet e errëta që ndodhin në zemrat e njerëzve. Meqenëse të gjitha aktet e lartëpër-mendura janë në realitet një akt, atëherë duhet që edhe Bërësi i tyre të jetë gjithashtu Një i vetëm, i Plotëfuqishëm që gëzon një Shkëlqim e Madhështi të tillë saqë, asgjëkund, kurrësesi, nuk lejon as edhe mundësinë më të vogël për pranimin e ortakërisë, përkundrazi, Ai e shkul nga rrënjët politeizmin dhe çdo shenjë e mundësi të tij.

Atëherë Zoti i Lartësuar posedon një Krenari e madhështi të tillë force. Krenaria e Tij është në kulmin e Plotësimi e të Gjithëpërfshirjes. Prandaj është krejtësisht e pamundur që Ai të lejojë apo të lërë rrugën të hapur për pranimin e partnerëve, apo t'i shkaktojë pafuqi krenarisë së Tij, t'i përcaktojë limite Gjithëpërfshirjes së Tij, apo t'i vëjë një cak pakufshëmërisë së Tij. Asnjë logjikë e shëndoshë nuk do ta vlerësonte të mundur këtë. Atëherë t'i përshkruash ortakëri Zotit të Lartësuar përbën një krim të madh ndaj Krenarisë së Tij, ndaj dinjitetit të Madhështisë së Tij, dhe ndaj gjithëlavdisë së Tij; ky është një krim aq i madh saqë Kur'an i shenjtë dekreton me kërcënimin më serioz:

إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ

“Dhe Zoti nuk e fal të përshkruarit ortakëri për Të; Ai fal çdo gjë që është më e vogël se ajo...”  
(Kur'an, 4: 48)

## E VËRTETA E DYTË:

Absolutësia, Gjithëpërfshirja dhe shfaqja e formës së pafund e veprave Hyjnore që shihet tek vepra në Kozmos.

Është vetëm Urtësia e Zotit të Lartësuar dhe Vullneti i Tij që vendosin limite dhe përcaktojnë ato vepra si dhe kapacitetet e brendaqenësishme të objekteve dhe vendeve në të cilat ato tregojnë vetveten. Rastësia e humbur, natyra e shurdhër, forca e errët, shkakësia e pavetëdijshme dhe elementet që pa masa kufizuese janë shpërndarë në çdo anë. Asnjë nga këto nuk mund të kenë ndonjë pjesë në ato vepra që janë bërë me balancën më të madhe, me urtësinë e me rregullin më perfekt të Krijuesit. Ato vihen në veprim me komandën, me vullnetin dhe me fuqinë e Autorit të Lavdishëm. Shkaqet nuk janë veçse perde të dukshme për të maskuar fuqinë e Tij.

Ne do të shtjellojmë tri nga shumë pika të holla që lidhen në veprat që tregojnë tre versete të njëpasnjëshme kur'anore në suren En-Nahl.

Verseti i parë:

وَأَوْحَىٰ رَبُّكَ إِلَى النَّحْلِ أَنْ اتَّخِذِي مِنَ الْجِبَالِ بُيُوتًا

“Dhe Zoti yt inspiroi tek bleta se ajo duhet të kërkojë një vendbanim në male.” (Kur'an, 16: 68)

Bleta, në lidhje me pozitën dhe funksionin e saj është një mrekulli e tillë e fuqisë së Zotit të Lartësuar sa që një sure e plotë, sura En-Nahl, është quajtur me emrin e saj. Sepse të përshkruash në kokën e vogël të asaj makine të vockël mjalti një program të plotë për përmbushjen e detyrës

së saj të rëndësishme; të vendosësh në stomakun e saj të vockël më të shijshmit e ushqimeve e t'i pjekë ato atje; të zgjedhësh një vend të përshtatshëm për të vendosur helmin vrasës i aftë për të shkatërruar e vranë qeniet e gjalla, e pa u shkaktuar ndonjë dëm gjymtyrëve të tjera të trupit; ta realizosh këtë me kujdesin më të madh, me dije e urtësi shumë të madhe, me vullnet, rregullsi dhe ekuilibër të jashtëzakonshëm, atëherë natyra e pavetëdijshme, e paorganizuar dhe e ç'ekuilibruar dhe rastësia e verbër kurrësesi nuk mund të ndërhyjnë apo të marrin pjesë në ndonjë vend këtu.

Aparenca dhe gjithëpërfshirja e kësaj mjeshtrie Hyjnore, kjo vepër prej Hyjnie e cila është e mahnitshme dhe mrekulli në tri kënd-vështrime të veçanta, në sasi të mëdha të bletëve që gjenden të shpërndara anembanë tokës, me të njëjtën urtësi, të njëtin kujdes, me të njëjtën simetri dhe në të njëjtën kohë e në të njëjtën formë. Kjo padyshim është një provë e vetëkuptueshme për Njësinë e Zotit të Lartësuar.

Verseti i dytë:

وَأَنَّ لَكُمْ فِي الْأَنْعَامِ لَعِبْرَةً لَتُنظُرُوا مَا فِي بُطُونِهِمْ مِنْ بَيْنِ فَرْثٍ وَدَمٍ لَبَنًا خَالصًا سَائِغًا لِلشَّارِبِينَ ﴿٦٦﴾

“Me të vërtetë që edhe te bagëtisë ka mësim për ju. Ne ju japim juve të pini nga ajo që është në barkun e tyre nga bashkimi ndërmjet sekrecio-neve të gjëndrave dhe të gjakut, qumësht të pastër, i shijshëm e i përshtatshëm për ata që e pinë.” (Kur'an, 16: 66)

Ky verset është një gradë e mbushur plot me instruksione të dobishme. Të vendosësh në thithat e lopëve, deveve, dhive e deleve, si dhe tek nënat humane, në mes të gjakut dhe kullimit, por pa u

ndotur nga ato, të vendosësh një substancë tamam të kundërtë, të pastër, të papërzier, të këndshme, ushqyese, pra qumështin e bardhë, dhe të inspirosh në zemrat e nënave të tyre butësinë e dhemb-shurinë për të vegjëlit e tyre që është akoma më e këndshme, më e ëmbël dhe më e vlefshme se sa qumështi; kjo kërkon një shkallë të tillë mëshire, urtësie, njohurie, fuqie, dëshire e kujdesi sa që kurrësesi nuk mund të jetë vepra e rastësisë së trazuar, e elementeve të ngatërruara apo e forcave të verbëta.

Treguesi, veprat dhe gjithëpërfshirja e këtij arti kaq të mrekullueshëm e Hyjnor dhe e këtyre akteve plotë urtësi Hyjnore gjithandej në faqen e globit dhe në zemrat dhe krahërorët e panumërt të nënave të panumërta të qindra e mijëra specieve, në të njëjtin shembull, në të njëjtën formë, me të njëjtin kujdes, kjo gjithashtu përbën një provë të vetëkuptueshme të Njësisë së Zotit të Lartësuar.

Verseti i tretë:

وَمِنْ ثَمَرَاتِ النَّخِيلِ وَالْأَعْنَابِ تَتَّخِذُونَ مِنْهُ سَكَرًا وَرِزْقًا حَسَنًا  
إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً لِّقَوْمٍ يَعْقِلُونَ ﴿٦٧﴾

“Dhe nga frutat e hurmave dhe nga rrushi ju merrni lëng të ushqyeshëm dhe ushqim të mirë. Pa dyshim që këtu ka shenjë të qartë për njerëzit që mendojnë.” (Kur'an, 16: 67)

Ky verset tërheq vëmendjen tonë për te hurmat dhe rrushi duke thënë: “për ata që kanë logjikë”, ndodhet një provë e madhe, një argument e dëshmi të Njësisë Hyjnore në këto dy frute. Këto dy frute konsiderohen ushqim e furnizim, fruta të freskëta e të thata dhe burimi i shumë lëndëve

ushqyese, megjithatë pemët që i mbajnë ato qëndrojnë në një rërë të pa ujë dhe të thatë. Prandaj ato janë mrekulli të fuqisë dhe çudira të urtësisë. Secila nga ato janë si një fabrikë që prodhon sheqer të ëmbël, një makineri që prodhon shurup si mjaltë. Një vepër arti e krijuar me një rregull perfekt, urtësi e kujdes.

Atëherë kushdo që ka një grimcë inteligjence kur i shqyrton ato do të thonte: *Ai që i bëri ato në këtë mënyrë, padyshim Ai është Krijuesi i të gjithë kozmosit*”, sepse përpara syve tonë çdo degë rrushi mban njëzet vila (vesh) rrushi dhe çdo degë, me rradhë, përmban qindra nga kokërrat sheqerore të rrushit ku secila kokërr, si një pompë e vogël, nxjerr shurup. Të veshësh sipërfaqen e çdo kokërre rrushi me një mbrojtje të mirë, delikate e të hollë e të ngjyrshme; të vendosësh në zemrën delikate e të butë të asaj kokërre farëra me lëvoret e tyre të forta, të cilat në realitet janë mjete për mbrojtjen e tyre, programin dhe historinë e jetës së saj; të krijosh një numër të madh kokërrash të tilla kudo në faqen e të gjithë tokës me të njëjtin kujdes e urtësi dhe në të njëjtën kohë e formë. Kjo provon në mënyrën e saj të vetëkuptueshme se Ai që kryen këto punë është Krijuesi i të gjithë Kozmosit dhe ky veprim duke kërkuar, siç bën, një fuqi të pafund dhe urtësi të pakufishme mund të jetë vetëm vepra e Krijuesit të lavdishëm. Po, fuqitë e verbëra, natyra e shurdhër, shkaqet e pavetë-dijshme e të ngatërruara nuk mund të shtrinë duart e tyre e të ndërhyjnë në atë rregullsi e ekuilibër të ndjeshëm, në këtë art të hollë dhe në këtë skemë plot urtësi, por ato janë në shërbim e u janë nënshtruar urdhërave të Krijuesit të atyre veprave Hyjnore, janë objekte pasive, janë perde e sherbetorë të Komandës së Zotit të Lartësuar.

Ashtu siç tregojnë këto tre versete tri të vërteta, ku secila tregon Njësinë e Zotit të Lartësuar në tri pika, po ashtu, tregues të panumërt dhe vepra të funksioneve të pafund Hyjnore dëshmojnë me unanimitet Njësinë e Krijuesit, njësinë e Esencës së lavdishme.

E VËRTETA E TRETË: Krijimi i qenieve, sidomos i bimëve dhe i kafshëve, me shpejtësinë absolute dhe rregullin absolut; me lehtësinë absolute, me shkathtësinë absolute, me talent, aftësi e rregull; me vlerë të madhe e dallim, pavarësisht dendësisë së skajshme, përzierjes dhe formës së tyre të përbashkët. Po, të prodhosh me shpejtësinë më të madhe dhe në shumicë të skajshme, me profesionalizmin dhe mjeshtrinë më të madhe dhe me lehtësinë më të madhe të kombinuar me kujdesin dhe rregullin më të madh, me vlerën më të madhe dhe dallimin, pavarësisht nga dendësia e ndryshimeve, pa ndonjë ngatërresë apo mangësi. Kjo përsosmëri nuk mund të bëhet veçse me fuqinë e të Plotfuqishmit të Vetëm, fuqia e të Cilit është e tillë saqë asgjë nuk duket e vështirë për të. Për atë fuqi, krijimi i yjeve është aq e lehtë sa krijimi i atomeve, i gjërave të mëdha aq sa i të voglave; të gjitha speciet i krijojnë me aq lehtësi si një anëtar i një specie, të lartën, gjithëpërfshirësen, universalen, si të kufizuarën, të pjesshmen e të veçantën; është e lehtë për Të t'i japë jetë gjithë tokës si me i dhënë një pemë, dhe të ngrejë lart një pemë të lartë sa mali duke e bërë me aq lehtësi sikur të prodhonte një farë shumë të vogël. Të gjitha këto vepra Ai i kryen përpara syve tonë.

Ky shpjegim, kjo zgjidhje, ky zbulim dhe kjo provë e misterit të kësaj shkalle të pohimit të Njësisë Hyjnore, i kësaj të vërtetës së tretë, i kësaj fjale të Njësisë - e këtij misteri që më e madhja dhe universalja është e lehtë si më e vogla dhe e veçanta pa ndryshimin më të vogël midis tyre. Kjo urtësi e dobishme, kjo mbrojtje supreme, kjo enigmë përtej konceptimit të inetelektit, ky themel shumë domethënës i Islamit, ky burim shumë i thellë besimi, baza më e madhe e Njësisë së Zotit të Lartësuar, vendosja e të gjithë kësaj zbulon vlerën dhe enigmën e Kur'anit dhe bën të mundur të njohësh sekretin më të madh dhe urtësinë e panjohur të krijimit të të gjitha qenieve të cilën nuk e kapën as filozofët.

Njëqindmijë falenderime e lëvdata sa shkronjat e Risalein-Nurit, qofshin për Krijuesin e Gjithëmëshirshëm që Risalein-Nuri ka zgjidhur, zbuluar e vërtetuar këtë enigmë të mahnitshme, këtë mister të çuditshëm. Ajo e ka provuar me argumentet më vendimtare, me atë shkallë sigurie sa dy plus dy baraz katër, veçanërisht në diskutimin e “*Ai është i plotfuqishëm mbi gjithçka.*” Në fund të letrës së njëzet, në pjesën:

وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

“*vepruesi i plotfuqishëm*” nga “*Fjala e njëzet e nëntë*” që i dedikohet ringjalljes; në pjesën që vërtetohet fuqia Hyjnore në shkallët

اللَّهُ أَكْبَرُ

“*Zoti është më i Madhi*” nga “*shkreptina e njëzet e nëntë*”, e shkruajtur në gjuhën arabe. Për këtë arsye ne po ua lëmë atyre pjesëve të Risalein-Nurit shpjegimin e kësaj çështjeje. Megjithatë dëshirojmë të parashtrijmë shkurtazi themelet dhe provat që zgjidhin këtë mister dhe të prekim shkarazi trembëdhjetë misterët që u ngjasojnë trembëdhjetë shkallëve. Unë në të vërtetë kam shkruar misterin e parë e të dytë, por fatkeqësisht dy pengesa të fuqishme, morale e materiale më shkaktuan t'i lë të tjerat.

## MISTERI I PARË:

Në qoftë se diçka është esenciale, e kundërta e saj nuk mund të hyjë në esencën e përcaktuar nga ajo gjë. Sepse kjo do të ishte e barasvlershme me *“bashkimin e dy të kundërtave”* që është absurditet. Tani në bazë të këtij principi, meqenëse fuqia e Zotit të Lartësuar lidhet me esencën e Tij dhe është bashkëshoqëruese thelbësore e Esencës më të shenjtë, atëherë pafuqia - e kundërta e fuqisë - kurrësi nuk mund të fitojë hyrje në atë Esencën e të Plotfuqishmit. Për më tepër, Ekzistenca e shkallëve brenda një gjëje ndodh nëpërmjet ndërhyrjes së të kundërtës së saj në të. Për shembull shkallët e forta e të dobëta të dritës rezultojnë nga ndërhyrja e errësirës; gradat e larta e të ulëta të nxehtësisë vijnë nga përzierja e të ftohtit; masat e mëdha e të vogla të fuqisë përcaktohen nga ndërhyrja dhe opozita e qëndresës. Kështu është e pamundshme që të ekzistojnë shkallë në atë fuqi të Esencës Hyjnore. Ajo fuqi krijon të gjitha gjërat si një gjë të vetme. Meqenëse shkallët nuk ekzistojnë në fuqinë e Esencës Hyjnore dhe ajo fuqi nuk pranon dobësi e mangësi, atëherë kurrësi asnjë pengesë nuk mund ta bllokojë atë fuqi ,dhe krijimi i çdo gjëje nuk mund t'i shkaktojë ndonjë vështirësi asaj fuqie. Atëherë, meqenëse asgjë nuk është e vështirë për Zotin të Lartësuar. Ai e krijon rringjalljen e madhe me aq lehtësi sa pranverën; pranverën me aq lehtësi sa një pemë; një pemë e krijon me lehtësinë e një luleje. Për më tepër, Ai e krijon një lule me aq mjeshtri e art sa mjeshtria e pemës. E krijon pemën me aq mrekulli sa pranverën, e krijon pranverën me aq gjithpërfshirje e mahnitje sa ringjalljen. Të gjithë këtë Ai e realizon përpara syve tonë.

Është provuar në Risalein-Nur me prova të fuqishme e vendimtare saqë po të mos ekzistonte Njësia Hyjnore, bërja e një luleje do të ishte aq e vështirë sa bërja e një peme ose edhe më e

vështirë; bërja e një peme do të ishte aq e zorshme sa ajo e pranverës ose më e vështirë; dhe krijimi madje do të humbiste vlerën e vet dhe cilësinë artistike. Një qenie e gjallë që krijohet për një minutë do të prodhohej për një vit ose mund të mos prodhohej fare. Për shkak të këtij misteri që frutat, lulet, pemët dhe kafshët që janë tej mase të vlefshme, pavarësisht shumicës dhe kudondodhjes së tyre, dhe pavarshisht se janë të krijuara në mënyrë artistike e plotë mjeshtri; pavarësisht lehtësisë dhe shpejtësisë së formave të tyre, dalja e tyre me një rregullsi, duke ruajtur funksionet e tyre e duke deklaruar lavdinë e Zotit të Lartësuar, ata përmbushin detyrat e tyre e largohen duke lënë prapa farërat e llojit të vet në vendet e tyre.

## **MISTERI I DYTË:**

Përmes misterit të shkëlqimit, tejdukshmërisë dhe bindjes, ashtu si një diell i vetëm që reflektohet në një a më shumë pasqyra, po kështu një tregues i vetëm i fuqisë së esencës së Zotit të Lartësuar, i asaj Fuqie të pafund - dhuron të njëjtin reflektim ndriçues mbi pasqyra të panumërta mbi objekte të shndëritshme dhe mbi pika uji përmes aktivitetit të saj intensiv dhe urdhërit të Zotit të Lartësuar. E vogla dhe e madhja janë si një e vetme për Atë fuqi dhe Ajo nuk bën dallime midis tyre. Në të njëjtën mënyrë, Zoti i Lartësuar shfaq një fjalë dhe për shkak të aftësisë së Tij të pashoqe krijuese dhe gjithëpërfshirjes së pashoqe, ajo fjalë me leje të Zotit të Lartësuar do të futet në veshët e milionave me të njëjtën lehtësi, ashtu siç futet në veshët e një njeriu. Një dëgjues është i barabartë me mijëra; nuk ka ndryshim midis tyre. Atëherë një dritë e vetme si syri dhe një qenie shpirtërore e vetme si Xhebraili, për shkak të gjithëpërfshirjes perfekte të veprimtarisë

Hyjnore e përfshirë brenda treguesit të mëshirës, do të gjendet, do të mbështesë e do të vlerësojë mijëra vende të ndryshme me të njëjtën lehtësi si një vend i vetëm. Kjo ndodh në saje të fuqisë së Zotit të Lartësuar. Nuk ka ndryshim këtu midis të shumtës e të paktës. Fuqia e parapërrjetësisë, e esencës së Zotit të Lartësuar është nga dritat më të holla e të zgjedhura. Drita e të gjitha dritave, thelbet, substancat dhe dimensionet e brendshme të të gjitha gjërave janë ndriçuese e të ndritshme si pasqyrat; të gjitha gjërat nga atomi, bimët, qeniet e gjalla gjer tek yjet, dielli e hëna janë shumë të bindura dhe të nënshtruara ndaj komandës së asaj fuqie të Esencës Hyjnore dhe varen tek urdhërat e asaj fuqie të parapërrjetësisë. Nuk ka dyshim se ajo fuqi i krijon gjërat e panumërta si një gjë e vetme, vjen te çdo gjë e çdo kohë e në çdo vend. Asnjë detyrë nuk ndërhytë tek tjetra, e madhja e vogla, e shumta, e pakta, e veçanta, e përgjithshmja; të gjitha janë të njëjtat për Atë fuqi dhe asgjë nuk është e vështrirë për Të.

Siç u tha tek fjalët *“E dhjeta dhe e njëzet e nënta”* përmes mistereve të rregullit, ekuilibrit, bindjes ndaj urdhërit dhe nënshtrimit ndaj një urdhëri, ajo fuqi shkakton që një anije aq e madhe sa njëqind shtëpi të lëvizë e të avancojë me aq lehtësi, siç drejton e lëviz fëmija lodrën e tij me gisht.

Ashtu si një komandant që dërgon një ushtar këmbësorie në betejë me një urdhër nga fronti i tij, po kështu Ai mund të hedh në përleshje një ushtri të bindur me të njëjtin urdhër të veçantë.

Le të supozojmë se dy male janë në një gjendje baraspeshimi; në një balancë të madhe e të ndjeshme. Ashtu si një kokërr arë që do t'i shkaktonte njëres pjatë të ulej po të vendosej në njërën anë të peshores e cila përmban dy vezë; ajo do të shkaktonte të njëjtin rezultat me shkallën që përmban dy male; Me anë të një ligji urtësie ajo do të shkaktonte që njëra pjatë peshoreje me malin e saj të ngrihet në maje të malit, dhe tjetra të zbresë me malin e saj në fund të luginës. Meqë

çështja është kështu, në të njëjtën mënyrë është ajo edhe me Fuqinë Hyjnore. Meqenëse ajo Fuqi është absolute dhe e pakufishme, dritëdhënëse, esenciale dhe e përjetshme dhe gjendet në të urtësia absolute dhe drejtësia Hyjnore, të cilat janë burimi, origjina, themeli dhe zanafilla e të gjithë rregullit, organizimit dhe ekuilibrit në krijim; dhe meqenëse të gjitha gjërat, e veçanta dhe e përgjithshmja, e vogla dhe e madhja, i binden komandës së asaj Fuqie dhe i nënshtrohen në veprat e saj, atëherë dalim në përfundim se ajo fuqi i bën yjet të lëvizin e të rrotullohen, nëpërmjet urtësisë së rregullit të Zotit të Lartësuar me aq lehtësi sa rrotullimi dhe lëvizja e atomeve.

Ajo fuqi, ashtu siç sjell në jetë, në pranverë, një mizë të vetme me një rregull të vetëm, gjithashtu u dhuron jetë po me aq lehtësi e me të njëjtin urdhër të gjitha specieve të mizave si dhe të gjitha llojeve të bimëve dhe kafshëve nëpërmjet misterit të urtësisë dhe ekuilibrit të brenda-qenësishëm në fuqinë e Tij dhe atëherë i nxjerr ato në fushën e jetës.

Ajo fuqi ashtu siç mbjell një pemë në pranverë me një shpejtësi të madhe e i jep jetë e vitalitet në rrënjët e saj që u ngjasojnë kockave, në të njëjtën mënyrë, ajo fuqi absolute, plot urtësi e drejtësi, ringjall në pranverë, me të njëjtin urdhër, tokën e gjërë dhe sjell në jetë qindra e mijëra modele që tregojnë ringjalljen ashtu siç erdhi në jetë pema, duke e realizuar këtë me lehtësinë më të madhe. Me komandën e Tij formuese Ai sjell në jetë tokën me anë të dekretit:

إِنْ كَانَتْ إِلَّا صَبْحَةً وَاحِدَةً فَأَدِّأَهُمْ جَمِيعًا لَدَيْنَا مُحْضَرُونَ

“Do të jetë vetëm një klithmë e vetme dhe atëherë të gjithë do të sillen pranë nesh.” (Kur'an, 36: 53)

Të gjithë njerëzit dhe xhindët, me një klithmë e komandë të vetme do të sillen pranë nesh e do të jenë prezent në fushën e ringjalljes, përsëri me dekretin e Tij:

وَمَا أَمْرًاكَ لَعَلَّ الْأَكْفَانَ الْبَصِيرِ أَوْ مَوَافِرُ

“...Ora e fundit (ndodhja e kijametit) do të jetë veçse një pulitje (hap e mbyll sytë) e kapakëve të syrit ose më e afërt.” (Kur'an, 16: 77).

Domethënë, shkaktimi i ringjalljes dhe grumbullimi që do të vijojë nuk do të marr më shumë kohë se sa pulitja e kapakëve të syrit, ose më pak kohë. Atëherë është verseti:

مَا خَلَقْتُكُمْ وَلَا بَعَثْتُكُمْ إِلَّا كَفَنٍ وَاحِدَةٍ

“Krijimi dhe ringjallja e juaj është si krijimi i një shpirti (njeriu) të vetëm.” (Kur'an, 31: 28), që do të thotë: “O njeri! Për të të krijuar dhe për të të sjellë në jetë, për të të ringjallë e sjellë në Mahsher (në fushën e tubimit të madh), është aq e lehtë për Mua sa sjellja e një shpirti në jetë; ajo nuk paraqet problem për fuqinë Time. Sipas kuptimit të brendshëm të këtyre verseteve, Vullneti i Zotit të Lartësuar do të sjellë të gjithë njerëzit, xhindët, të gjitha kafshët, qeniet e gjalla dhe engjujt në fushën e Mahsherit dhe peshores së drejtë, me një komandë të vetme dhe me lehtësinë më të madhe dhe kurrë, një veprim nuk pengon një tjetër.

Misteret e mbetura nga e treta, e katërta e deri tek e trembëdhjeta janë shtyrë për një kohë tjetër, edhe pse e papajtueshme për mua.


E VËRTETA E KATËRT:


Ekzistenca dhe aparenca e të gjitha qenieve shpall Njësinë Hyjnore në mënyrë të vetëkuptueshme përmes pikave të tyre të shumta të unitetit dhe konvergencës si qenia e tyre e përbashkët.; duke qenë miniaturë ose model më i madh për njëra-tjetrën; duke qenë disa universale e specie, dhe disa të veçanta dhe individe; duke i ngjasuar njëra-tjetrës në vulën e dispozitës së natyrshme; duke pasur ngjashmëri në skalitjen artistike e në mjeshtrinë; dhe duke ndihmuar e plotësuar njëra-tjetrën në lidhje me funksionet e tyre të natyrshme. Ato vërtetojnë Njësinë e Shpikësit të tyre. Ndërsa në lidhje me treguesin Hyjnor, në krijim, ato prarojnë se ndodhet një qenie universale që nuk pranon ndarje e pjesëtum. Për shembull, në çdo pranverë për të krijuar, urdhëruar e mbështetur anëtarët e panumërt të katërqindmijë specieve të ndryshme të bimëve dhe kafshëve, pavarësisht qenies së tyre së bashku e të përziera, në një moment të vetëm, në të njëjtën mënyrë, pa ndonjë defekt e gabim, me urtësinë më të madhe dhe përsosmërinë në art e mjeshtri; të krijosh të gjitha speciet e ndryshme të zogjve, që nga mizat të cilat u ngjasojnë zogjve të zvogëluara, gjer te shqiponjat që janë modelet më të larta të specieve, pastaj t'i pajisësh ato me mjetet e fluturimit dhe jetesën, dhe t'u shkaktosh atyre të udhëtojnë nëpër botën e ajrit; të ngulitësh e të vendosësh në fytyrën e secilit zog, në mënyrë të mrekullueshme, një stampo urtësie dhe në trupin e secilit nga ato një vulë- urtësie dhe në substancën e secilit prej tyre, në formë mbështetëse shenjë e Njesisë së Zotit të Lartësuar; t'u shkaktosh grimcave të ushqimit në mënyrë të mrekullueshme e plotë urtësi, të nxitojnë për të ndihmuar qelizat e trupit, të turren me vrull për të ndihmuar kafshët, t'u shkaktojë të gjitha nënave të shkojnë me shpejtësi për t'u dhënë ndihmesë të vegjëlvë të tyre të pafuqishëm; të veprosh mbi të gjitha gjërat e veçanta e universale, duke filluar nga rruga e qumështit, sistemi diellor dhe elementet e tokës e deri tek perdet e bebes së syrit, petalet e trëndafilin, lëvoret e misrit, farërat e bostanit si zinxhir rrathësh të ndërftuara tek njëri-tjetri, me të

njëjtën përkryerje artistike, tek e njëjta vepër e veçantë e me urtësi të bollshme, ta realizosh të gjithë këtë vërteton me një siguri bindjeje të vetëkuptueshme çka vijon:

Ai që kryen këto vepra është Një dhe i Vetëm; Ai vendos shenja mbi të gjitha gjërat. Ai ashtu siç nuk përkufizohet nga ndonjë vend, prapëseprapë është i pranishëm në çdo vend. Ashtu si dielli, të gjitha gjërat janë larg Atij, por Ai është afër të gjitha gjërave. Ashtu siç nuk janë të vështira për Të objektet më të mëdha si rruga e qumështit dhe sistemi diellor, gjithashtu edhe qelizat në gjakun e njeriut dhe në mendimet që kalojnë përmes zemrës së tij nuk mund t'i fshihen Atij dhe asgjë nuk mbetet përtej arritjes së fuqisë së Tij. Sado e madhe dhe e shumtë të jetë diçka, ajo është e lehtë për Të si gjëja më e vogël, sepse Ai krijon mizën e vockël në sistemin e shqiptonjës dhe perfeksionimin e saj. Ai krijon farën në formën e një peme, pemën në formën e kopshtit, kopshtin me mjeshtërinë e pranverës dhe pranverën në madhësinë e ringjalljes.

Ai na i ofron gjërat më të vlefshme e të punuarta me mjeshtri të pashoqe dhe na i dhuron me

çmimin më të lirë. Çmimi që Ai na kërkon neve është vetëm të themi:  Bismil-lah -

Në emër të All-llabut! dhe  El-hamdu lil-lah- *Lavdi Zotit!*. Me fjalë të tjera, çmimi i pranueshëm për të gjitha ato shumë dhurata të çmuara është të themi në fillim të të gjitha gjërave: Bismil-lahirr-Rrahmanirr -Rrahim - *Me emrin e Zotit, Mëshirëbërësit, Mëshirëplotit*, dhe në fund: El-hamdu lilah - *Lavdia i takon All-llabut të Lartësuar.*

Meqenëse e vërteta e katërt shpjegohet e shtjellohet diku tjetër në Risalein-Nur, ne mjaftohemi me këtë aluzion të shkurtër.

E VËRTETA E PESTË: që u perceptua nga udhëtari ynë ishte Ekzistenca në tërësinë e kozmosit, shtyllat e tij, pjesët dhe të gjitha qeniet që përfshihen në të me rregullsinë dhe organizimin më perfekt; veçoria e substancave dhe e qenieve të qëllimshme që janë mjetet për rrotullimin dhe drejtimin e asaj mbretërie të gjërë dhe që lidhen me skemën e saj të përgjithshme. Fakti që emrat Hyjnor dhe veprat që janë në veprim në atë qytet madhështor dhe në atë fushë të mahnitshme, rrethojnë e përfshijnë të gjitha gjërat ose shumicën e gjërave, pavarësisht ndërfutjes së tyre tek njëra-tjetra dhe duke qenë secila i njëjti emër dhe e njëjta vepër në çdo vend. Fakti se elementet dhe speciet që janë mjetet themelore për ndërtimin e atij pallati të zbukuruar mirë, për administrimin e tij dhe për argëtimin në të kanë mbuluar të gjithë faqen e tokës në shpërndarjen e tyre, pavarësisht ndërfutjes së tyre tek njëra-tjetra, ku secila posedon thelbin e saj të veçantë dhe duke mbetur vetë elementi dhe lloji i njëjtë kudo. Të gjitha këto kërkojnë, provojnë dhe vërtetojnë në mënyrë të pakontestueshme çka vijon: Ai, Shpikësi dhe Rregullatori i këtij kozmosi, Sunduesi dhe Furnizuesi i kësaj bote, Pronari dhe Ndërtuesi i këtij pallati është Një, i Vetëm dhe Unik. Atij nuk i ngjason asgjë, dhe është i pashoq. Ai nuk ka as ministër, as ndihmës, Ai nuk ka as partner e as oponent. Ai nuk ka as paaftësi, as mangësi.

Po, Rregulli në vetvete është shprehja më perfekte e Njësisë, pasi ai kërkon një rregullator të vetëm dhe kështu që nuk lë vend për t'i përshkruar ortakëri Zotit të Lartësuar, sepse të pranosh ortakëri është burimi i polemikës dhe i përçarjes. Ndodhet një rregull preciz e plotë urtësi që është i brendaqenësishëm të të gjitha gjërat, qofshin universale ose të veçanta, nga skema totale e kozmosit dhe nga rrotullimi i përditshëm e vjetor i tokës deri tek fizionomia e njeriut, kompleksi i ndjenjave në kokën e njeriut dhe qarkullimi i qelizave të bardha e të kuqe në gjakun e tij. Atëherë asgjë përveç Krijuesit të Plotëfuqishëm e të Urtit absolut nuk mund të shtrijë dorën e vet e të

ndërhyjë, në mënyrë të qëllimshme e krijuese, në ndonjë gjë. Përkundrazi, të gjitha gjërat janë përfituese, mjete treguesish dhe pasive.

Tani, vendosja e rregullit, ndjekja e disa qëlli-meve dhe ngritja e sistemit me pikëpamjen e disa përfitimeve mund të bëhet vetëm nëpërmjet njohjes dhe urtësisë dhe kryhet vetëm me vullnet e përzgjedhje. Pa dyshim kjo rregullsi që rrotullohet me urtësi, këto lloje të ndryshme të vendosura në organizimin e krijesave të pafund, që shfaqen para syve tonë e që rrotullohen pas përfitimeve, provon e vërteton në mënyrë të pakontestueshme se Krijuesi dhe Rregullatori i qenieve është Një, Ai është Vepruesi, në dorën e Tij është përzgjedhja, çdo gjë del në ekzistencë me Fuqinë e Tij, merr një gjendje të veçantë me Dëshirën e Tij dhe merr një formë të veçantë nëpërmjet zgjedhjes së Tij.

Përderisa llamba flakëruese e kësaj bujtine, e kësaj bote, është një, kandili i saj që është baza për llogaritjen e kohës është një; shtiza e saj e mëshirshme është një; kuzhina e saj zjarrmore është një; pija e saj jetëdhënëse është një; fusha e saj e mirëmbrojtur është një, si dhe një mijë e një shembuj të tjerë të Njesisë. Pa dyshim këta shembuj Njësie dëshmojnë në mënyrë të pakundërshtueshme se Shpikësi dhe Pronari i kësaj bujtine është gjithashtu Një, që Ai është shumë Zemërgjërë e Bujar, sepse Ai vë në shërbim nëpunës me dinjitet e rang shumë të lartë për t'i shërbyer miqve të gjallesave.

Emra të tillë si “I Gjithëditur”, “I Gjithëmëshirshëm”, “Dhënësi i formave”, “Gjallëruesi” dhe “Ushqyesi”, përshtypja dhe treguesi i të cilëve shihen te puna në çdo vend të botës. Atributet si “Urtësia”, “Mëshira” dhe “Mirësia” dhe aktet si “Formimi”, “Dispozitat” dhe “Furnizimi”, të gjitha janë një. Ato përqafojnë çdo vend, në shkallën më të lartë dhe çdo emër e akt duke qenë

prezent atje. Ato gjithashtu plotësojnë skalitjet e njëra-tjetrës, në një mënyrë të tillë saqë në qoftë se ato emra e vepra do të bashkohen në një mënyrë të tillë, që fuqia bëhet vetë urtësi, ndërsa urtësia të bëhet vetë mirësia e jeta. Për shembull: Me t'u shfaqur aktiviteti i emrit “Jetëdhënës”, në një gjë, aktiviteti i shumë emrave të tjerë si “Krijues”, “Furnizues”, “Dhënësi i formave” gjithashtu shfaqen në të njëjtën masë. Nuk ka dyshim se kjo dëshmon e provon në mënyrë të pakontestueshme se Ai që cilësohet nga ata emra si Bërës i veprave gjithëpërfshirëse që shfaqen kudo në të njëjtën mënyrë, duhet gjithashtu të jetë Një i vetëm e i pashoq. Ne këtë e besojmë dhe e vërtetojmë.

Elementet që janë substanca dhe lënda e krijimit përfshijnë të gjithë tokën. Secila nga speciet e krijimit që mban një shenjë, me të cilën dëshmon Njësinë, është shpërndarë gjithandej tokës dhe e sundon atë. Kjo gjithashtu provon në mënyrë të pakundërshtueshme se ato elemente, së bashku me elementet bashkëvepruese me çfarë ato përqafojnë, ato specie së bashku me anëtarët e tyre të veçantë janë produktet dhe sherbetorët e këtij Krijuesi të Vetëm e të Plotëfuqishëm, i Cili i përdori ato elemente të mëdha si sherbetorë të bindur dhe i përdori ato specie të shpërndara anëmbanë tokës si ushtarë të disiplinuar mirë. Meqenëse kjo e vërtetë gjithashtu ka qenë e provuar dhe e shpjeguar tek vendet e tjera në Risalein-Nur, ne mjaftohemi me një tregues të shkurtër.

Në përmbledhje të dëshmimeve që udhëtari i nxori nga këto pesë të vërteta përmes begatisë së besimit dhe të shijuarit të Njësisë Hyjnore, dhe në shprehjen e ndjenjave të Tij, udhëtari i tha zemrës së tij:

Vështro faqen e larmishme të librit të madh të Kozmosit! Shiko çfarë formash ka dhënë pena e artë e fuqisë!


Asnjë pikë e errët nuk mbetet për syrin ngulmues të zemrës;

Është sikur Zoti i Lartësuar ka përshekruar shenjat e Tij me atë dritë.

Gjithashtu mëso se: Gjethet e librit të botës janë dimensione të pafund;

Përshkrimet e Kaderit (paracaktimit) janë vepra të panumërta, të shkruajtura në tablonë e ruajtur të së vërtetës.

Si një fjalë e thellë, është çdo qenie në këtë botë. Gjithashtu dëgjoje këtë kur të gjitha gjërat shpallin:



“Nuk ka zot tjetër veç Zotit Një”, ato njëzëri thonë: O i Vërtetë! dhe kërkojnë me harmoni: O i Gjallë!

Po. Në të gjitha gjërat ndodhet një shenjë që tregon se Ai është NJË. Duke dëgjuar këtë, zemra e tij dhe shpirti pohuan për çfarë ato dëgjuan dhe thanë: Po, në realitet, të vërtetën!

Një aluzion i shkurtër për pesë të vërtetat e Njesisë të soditura nga udhëtari ynë nëpër botë, udhëtari përmes Kozmosit tek ky vendqëndrim, u tha në kapitullin e dytë të vendqëndrimit të parë.

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْوَاحِدُ الْأَحَدُ الَّذِي دَلَّ عَلَى وَحْدِيَّتِهِ فِي وُجُوبِ وُجُودِهِ  
مُتَشَاهِدَةٌ حَقِيقَتِ الْكِبْرِيَاءِ وَالْعَظَمَةِ فِي الْكَمَالِ وَالْإِحَاطَةِ  
وَكَذَلِكَ مُتَشَاهِدَةٌ حَقِيقَتُ طُهُورِ الْأَفْعَالِ بِالْإِطْلَاقِ وَعَدَمِ الْبِهَائِ  
لِالْتِقَادِ هَا إِلَّا الْإِرَادَةَ وَالْحِكْمَةَ ۞ وَكَذَلِكَ مُتَشَاهِدَةٌ حَقِيقَتُ  
إِحْجَادِ الْمَوْجُودَاتِ بِالْكَثْرَةِ الْمَطْلُوقَةِ فِي الشَّرْعَةِ الْمَطْلُوقَةِ وَخَلْقِ  
الْمَخْلُوقَاتِ بِالشُّهُورِ الْمَطْلُوقَةِ فِي الْإِنْفِاقِ الْمَطْلُوقِ وَإِنْدَاعِ الْمَصْنُوعَاتِ  
بِالْبِدْوِيِّتِ الْمَطْلُوقَةِ فِي غَايَةِ حُسْنِ الصَّنْعَةِ وَعُلُوِّ الْقِيَمَةِ ۞ وَ  
كَذَلِكَ مُتَشَاهِدَةٌ حَقِيقَتُ وُجُودِ الْمَوْجُودَاتِ عَلَى وَجْهِ الْكُلِّ وَالْكَلِّيَّةِ  
وَالْعِيَّةِ وَالْجَامِعِيَّةِ وَالْتِمَاطِخِ وَالْمُنَاسِبِ ۞ وَكَذَلِكَ مُتَشَاهِدَةٌ  
حَقِيقَتُ الْإِنْتِظَامَاتِ الْعَامَّةِ الْمُنَافِيَةِ لِلشَّرْكَةِ ۞ وَكَذَلِكَ مُتَشَاهِدَةٌ  
وَخَدَّتْ مَدَارَاتِ تَكْبِيرِ الْكَمَالِ الدَّالَّةِ عَلَى وَحْدَتِ صَانِعِهَا بِالْبَدَاهِ  
وَكَذَلِكَ وَخَدَّتْ الْأَسْمَاءُ وَالْأَفْعَالُ الْمُتَصَرِّفَةَ الْمُحِيطَةَ ۞ وَكَذَلِكَ وَخَدَّتْ الْعُنَاصِرِ  
وَالْأَنْوَاعِ الْمُتَشَرِّعَةَ الْمُسْتَوْلِيَةَ عَلَى وَجْهِ الْأَرْضِ

\* \* \*

Ai udhëtari nëpër botë, duke shëtitur përmes shekujve të ndryshëm, hasi me shkollën e Rifreskuesit (Muxheddîd), Reformatorit të mijëvjeçarit të dytë, Imam Rabbani Ahmed Faruki. Ai hyri në të dhe dëgjoi mësimin që po jepej nga vetë imami, i cili ndër të tjera përmendi:

Rezultati më i rëndësishëm i tarikateve të sufive është zbulimi i të vërtetave të besimit. Zbulimi për qartësinë e një të vërtete të vetme të besimit është më e preferueshme se njëmijë keramete (prova) apo vizione mistike. Imami gjithashtu tha: Në kohët e hershme, njerëz të mëdhenj thonin se do të shfaqet një njeri midis dijetarëve dhe studiuesve të shkencës islame. Ai do të provojë të gjitha të vërtetat e besimit dhe islamit me prova racionale dhe me qartësinë më të madhe. Unë do të dëshiroja të isha ai njeri dhe ndoshta unë jam. (Koha ka provuar se njeriu për të cilin bëhet fjalë këtu nuk është në fakt një individ, por vetë Risalein-Nuri. Ndoshta njerëzit e zbulesës kanë vërejtur parëndësinë e interpretuesit dhe shpallësit të Risalein-Nurit dhe kështu ata thanë për të se është një person...


Imami vazhdoi mësimin e tij duke thënë se besimi dhe pohimi i Njësisë Hyjnore janë themeli, esenca, drita dhe jeta e gjithëpërsosmërisë njerëzore; dhe se hadithi (thënia e Pejgamberit):

تَفَكُّرُ سَاعَةٍ خَيْرٌ مِنْ عِبَادَةِ سَنَةٍ

“Të meditosh një orë do të ishte më e mirë se adhurimi i një viti” i referohet meditimit në besim; dhe se mënyra e heshtur e lutjes së praktikuar në tarikatën Nakshibendi është një formë e këtij meditimi

të lartë. Ndërsa imami jepte mësim, udhëtari e dëgjonte me një vëmendje të madhe e pastaj u kthye e iu drejtua vetvetes: Është kjo që ky imam heroik thotë: të shtosh apo të zhvillosh forcën e besimit të dikujt qoftë edhe sa pesha e atomit, ajo do të ishte më e vlefshme se tonelata e dijeve dhe formave të plotësimit dhe njëqind herë më e ëmbël se mjalti i eksperiencave vegimtare.

Nga ana tjetër, filozofët e Evropës janë grumbulluar së bashku për më shumë se njëmijë vite me qëllim që të ngjallin e shkaktojnë kundërshtime e dyshime në luftën kundra fesë dhe Kur'anit, e për të sulmuar besimtarët. Ata dëshirojnë të shembin shtyllat e besimit, të cilat janë çelësi, burimi dhe themeli i lumturisë së përjetshme, i jetës së pavdekshme dhe i parajsës së amshuar. Ne atëherë duhet të forcojmë besimin tonë duke e transformuar atë nga besim imitues në besim të vërtetë e konfirmues. Prandaj, o shpirt! eja me ne të avancojmë me këto njëzet e nëntë shkallë besimi që i kemi gjetur ku secila është aq e fuqishme sa një mal, dhe të arrijmë te numri i bekuar tridhjetë e tre - numri i tesbihateve e i dhikrit (falenderimeve dhe i përmendjes së Zotit) që ndiqen në falje, dhe me qëllim që të shohim një vendqëndrim të tretë në këtë botë instruksioni. Le të trokasim te dera e furnizimit Hyjnor tek bota e gjallesave, dhe ta hapim ate me çelësin:




Bismil-Lahirr-Rrah-manirr-Rrahîm (*Me emrin e Zotit, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit*). Duke folur kështu, ai me lutje e përgjërime trokiti te porta e kësaj vendqëndrese të tretë, ku ishte një përmbledhje çudirash e spektakël mrrekullishë. Duke thënë: Bismil-lah, El-Fet-tah, Hapësi. Ai e hapi derën.

Vendqëndrimi i tretë u bë i dukshëm për të. Ndërkohë ai futet dhe pa se ai ishte ndriçuar nga katër të vërteta të mëdha e gjithëpërfshirëse të cilat demonstrojnë Njësinë Hyjnore në mënyrë aq të shndritshme si Dielli.

E VËRTETA E PARË: E vërteta e hapjes.

Domethënë, hapja ose dalja në pah e një lënde shumë të thjeshtë nga lloje të panumërta e forma të veçanta, dhe shfaqja e tyre kudo së bashku në një kohë të vetme dhe me një veprim të vetëm përmes treguesit të emrit “Hapës”.

Po, ashtu si fuqia krijuese e Zotit të Lartësuar që ka hapur e ka nxjerrë në pah qenie të panumërta si lulet në kopshtin e Kozmosit, dhe i ka dhënë secilës një formë të rregullt dhe identitet të dallueshëm me anë të treguesit “Hapës”, gjithashtu ndonëse në një mënyrë më të mrekullueshme, Ai u ka dhënë katërqindmijë specieve të qenieve të gjalla në kopshtin e tokës, secilës prej tyre, formën e saj simetrike, të stolisur e të dallueshme.



يَخْلَقَكُمْ فِي بُطُونِ أُمَّهَاتِكُمْ خَلْقًا مِّنْ بَعْدِ خَلْقٍ فِي ظُلُمَاتٍ  
ثَلَاثٍ ذَٰلِكُمْ اللَّهُ رَبُّكُمُ لَهُ الْمُلْكُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ فَأَنَّى تُصْرَفُونَ ﴿٣١﴾  
إِنَّ اللَّهَ لَآيْحَىٰ عَلَيْهِ شَيْءٌ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي السَّمَاءِ هُوَ الَّذِي  
يُصَوِّرُكُمْ فِي الْأَرْحَامِ كَيْفَ يَشَاءُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿٣٢﴾

»...Ai ju krijon juve në mitrat e nënave tuaja, krijim pas krijimi në tre errësira. Ai është All-llahu, Zoti juaj. Atij i përket mbretërimi, nuk ka zot tjetër përveç Atij. Atëherë si pra i shmangeni (adhurimit të Tij)?« (Kur'an, 39: 6)

»Asgjë nuk mund t'i fshihet All-llahut, as në tokë e as në qiell. Ai është i Cili ju krijon (formon) juve në mitra siç Ai dëshiron, nuk ka Zot tjetër përveç Atij, i Plotëfuqishëm e i Gjithëditur.« (Kur'an, 3: 5-6)

Këto dy versete tregojnë provën më të fuqishme të Njesisë Hyjnore dhe se mrekullia më e madhe e Fuqisë Hyjnore është Hapja e formave nga Zoti i Lartësuar.

Për shkak se hapja e formave është vërtetuar në mënyrë të përsëritur dhe është shtjelluar në mënyra të ndryshme në Risalein-Nur, dhe veçanërisht në shkallët e gjashtë dhe të shtatë të kapitullit të parë të vendqëndrimit të dytë të kësaj trajtese, ne ua lëmë diskutimin e kësaj çështje e atyre vendeve dhe përkufizojmë veten tonë këtu si më poshtë vijon:

Sipas dëshmisë së botanikës dhe biologjisë, të bazuara në kërkime të thella, në hapjen dhe zbulimin e formave, ndodhet një gjithëpërfshirje, dhe një mjeshtri e hollë e tillë saqë përveç një të vetmi e me fuqi absolute që mund të shikojë çdo gjë e të prodhojë; çdo gjë, askush tjetër përveç Tij nuk mund të ndër marrë këtë vepër gjithë-përfshirëse dhe përmbledhëse, sepse kjo vepër e zbulimit të formave kërkon një urtësi, vëmendje dhe një gjithëpërfshirje, që janë të pranishme në të gjitha kohërat dhe përfshihen brenda një fuqie të pafund. Kjo fuqi, me rradhë, mund të gjendet vetëm tek Ajo Qënie e Vetme që administron të gjithë kozmosin.

Siç u tha në versetin e lartëpërmendur, Atributi i Zotit “*Hapës*” i shprehur në hapjen dhe krijimin e formave të njerëzve në mitrat e nënave të tyre, prej një materiali të thjeshtë (sperma), brenda tri errësirave, të ndara me ekuilibër, dallueshmëri e rregull, pa ndonjë gabim, ngatërresë apo defekt. Kjo e vërtetë e zbulimit të formave të të gjithë njerëzve dhe kafshëve anembanë tokës, me të njëjtën fuqi, me të njëjtën urtësi, dhe me të njëjtën mjeshtri është prova më e fuqishme e Njesisë së Zotit të Lartësuar.

Sepse të përfshishë e të përfaqosh të gjitha gjërat është në vetvete një formë Njësimi dhe nuk lë vend për t’i përshkruar ortakë Zotit të Lartësuar..

Ashtu si nëntëmbëdhjetë të vërtetat e kapitullit të parë që dëshmojnë ekzistencën e Zotit të Lartësuar, dhe vërtetojnë ekzistencën e Krijuesit nëpërmjet vetëekzistencës së tyre, gjithashtu ato dëshmojnë Njësinë përmes gjithëpërfshirjes së tyre.

**E VËRTETA E DYTË:** E vërteta e gjithëmë-shirës.

Ne shikojmë me sytë tanë se ndodhet Një që ka mbuluar faqen e tokës me mijëra dhurata mëshire dhe e ka bërë atë si një vend feste. Ai ka shtruar për ne me atë mëshirë një tryezë që përmban qindra e mijëra ushqime të shijshme e të ndryshme, dhe ka bërë brenda tokës një magazinë që përmban mijëra mirësi të çmueshme nga mëshira dhe urtësia. Ajo qenie na e dërgon neve gjithashtu tokën, nëpërmjet rrotullimit të saj vjetor, si një anije apo tren, të ngarkuar me qindra e mijëra nga domosdoshmëritë më të holla e më jetike për njeriun, të cilat vijnë nga bota e paduk-shme; Ai gjithashtu na dërgon pranverën si një vagon duke transportuar ushqime e veshje për ne. Kështu Ai na ushqen neve me mëshirën më të madhe, me qëllim që të na bëjë të

përfitojmë nga ato dhurata e mirësi. Ai, për më tepër, na ka dhënë qindra e mijëra dëshira, nevoja, ndjenja, ndijime e shqisë.

Siç u shtjellua në: *“Rezzen e katërt”* e cila shpjegon ajetin kur'anor: “Është i mjaftueshëm për ne All-llahu, dhe sa Garant i mirë është Ai”. Aty vërtetohet se Zoti i Lartësuar na ka dhënë një stomak që mund të gjejë kënaqësi në varietete të pafund ushqimi; Ai na ka dhënë një jetë të tillë nëpërmjet shqisave që e shoqërojnë atë, që ne mund të përfitojmë mirësi të panumërta nga bota e madhe fizike sikur të ishte një tryezë e shtruar me mirësi. Ai na ka favorizuar me një humanizëm, me qëllim që ne të kënaqemi me dhurata të panumërta si në botën shpirtërore ashtu edhe në atë materiale, përmes instrumenteve të tilla siç janë mendja dhe zemra. Ai na ka mësuar neve Islamit me qëllim që ne të marrim dritë nga thesaret e pakufishme të botërave të padukshme e të dukshme.

Ai na ka drejtuar neve në besim me qëllim që ne të ndriçohemi nga drita të shumta dhe dhurata të kësaj bote dhe botës tjetër. Ky kozmos është si një pallat i përshtatur e i zbukuruar nga cilësia Hyjnore e Mëshirës me gjërat dhe ekzistencat më të vyera, e cila atëherë i jep dorës së njeriut çelësat për të hapur të gjitha arkat dhe dhomat në atë pallat, si dhe duke i dhuruar natyrës së njeriut të gjitha nevojat dhe shqisat që do ta mundësojnë atë për të përfutur prej tyre.

Kjo mëshirë që përqafton Dynjanë dhe Ahiretin, dhe në fakt të gjitha gjërat, është padyshim një tregues i unitetit brenda Njësisë.

Ashtu si drita e diellit që është shembull njësie përmes përfshirjes së tij të gjitha gjërat që janë përballë tij, atëherë po ashtu çdo objekt i ndritshëm e i tejdukshëm që merr reflektimin e dritës, nxehtësinë dhe shtatë ngjyrat e diellit janë gjithashtu një shembull dhe simbol i unitetit. Kushdo

që shikon dritën e tij gjithëpërfshirëse do të përfundojë me mendimet se dielli i kësaj toke është Një. Duke dëshmuar ngrohtësinë dhe reflektimin ndriçues të diellit në të gjitha objektet ndriçuese, madje edhe te pikat e ujit, kjo do të thotë se uniteti i diellit në vetë diellin është i pranishëm me atributet e tij afër të gjitha gjërave.

Gjithashtu, përfshirja e të gjitha gjërave nga mëshira e shtrirë e të Gjithëmëshirshmit të Vetëm, Zotëruesit të bukurisë, demonstroi Njësinë e Atij të Gjithëmëshirshmi të Vetëm.

I ngjashëm me këtë, mënyra në të cilën Ai i Gjithëmëshirshmi mbështet të gjitha gjërat, qëniet e gjalla, e sidomos njeriun me një gjithëpërfshirje jetike, që ka treguar çdo individ dhe ka vendosur një hallkë përmes të gjitha gjërave si një tregues i dritave të Emrave më të shumtë të Atij të Gjithëmëshirshmi dhe ekzistencën e Tij. Kjo, gjithashtu, provon Njësinë e të Gjithëmëshirshmit dhe faktin se është Ai që bën çdo gjë për çdo gjë. Po, i Gjithëmëshirshmi tregon krenarinë e lavdisë së Tij në të gjithë kozmosin, dhe në të gjithë tokën përmes unitetit dhe gjithëpërfshirjes së Mëshirës së Tij. Me treguesin e unitetit të Tij, Ai grumbullon së bashku te çdo anëtar i të gjitha specieve të gjalla, e veçanërisht te njeriu, shembuj të mirësisë së Tij në rregullat dhe instrumentet e qenieve të gjalla, dhe shpall përkujdesjen e bukurisë së Tij për çdo individ, dhe kjo bëhet pa thyer unitetin e Kozmosit. Sa për njeriun, Zoti i Lartësuar bën të njohur tek ai në mënyrë të përqëndruar format e ndryshme të mirësisë së Tij.

E ngjashme me këtë, një pjepër mund të koncentrohet brenda farës së tij. Qenia e Cila e ka bërë farën, medoemos, duhet të jetë Ai që e prodhon pjeprin. Atëherë me një balancë të veçantë të njohurisë së Tij dhe ligjit të veçantë të urtësisë së Tij, Ai vizaton dhe skicon farën, e bashkon dhe

e vesh atë në trup. Askush përveç Krijuesit të vetëm që prodhoi pjeprin nuk mund ta bëjë farën e tij. Kjo do të ishte krejtësisht e pamundur.

Atëherë përmes treguesit të gjithëmëshirës, kozmosi bëhet një pemë ose një kopsht, toka bëhet si një frut ose një shalqi, dhe njeriu bëhet si një farë. Atëherë sigurisht Krijuesi i gjallesës më të vogël duhet të jetë krijuesi i tokës dhe i gjithë kozmosit. Në mënyrë të përmbledhur konkludojmë se krijimi i të gjitha formave të organizuara për të gjitha ekzistencat dhe hapja e tyre nga një lëndë e thjeshtë nëpërmjet të vërtetës së Atributit gjithëpërfshirës të “*Hapësit*” provon unitetin në formë të pakontestueshme. Gjithashtu esenca e atributit gjithëpërfshirës së të Gjithëmëshirshmit përmes furnizimit të të gjitha gjallesave që vijnë në ekzistencë dhe hyjnë në jetën e kësaj bote, veçanërisht ato të sapoardhura, me organizimin dhe rregullin më të madh; prodhimi i instru-menteve të tij të domosdoshme pa ndonjë mangësi, dhe arritja e tij tek çdo individ në çdo vend, e në çdo moment me të njëjtën mëshirë. Ky atribut gjithashtu demonstroi Njësinë brenda unitetit.

Risalein-Nuri është një tregues i Emrit “*I Gjithëditur*” (*Hakîm*) dhe i emrit “*Rabîm*” (*I Gjithëmëshirshëm*) dhe i pikave të ndryshme të treguesve të esencës së mëshirës. Por, meqenëse këto janë shpjeguar e vërtetuar në vende të shumta të tij ne do të mjaftohemi këtu me treguesin e një pike nga oqeani e ta presim shkurt këtë histori të gjatë.

**E VËRTETA E TRETË:** E vërteta e drejtimit dhe e administrimit.

Domethënë të administrosh me rregullin e plotë dhe ekuilibër trupat shumë të shpejtë e të mëdha qiellorë dhe të administrosh elementet e ndërthurur e të përzier me njëri-tjetrin, të administrosh krijesat e tokës që janë shumë të nevojshme e të dobëta; t'i nxitësh ata për të ndihmuar njëri-tjetrin, t'i drejtosh ato të bashkuar me njëri-tjetrin, të marrësh masat e domosdoshme që u takon

atyre, dhe ta bësh këtë botë të madhe si një mbretëri perfekte, një qytet të madh, një pallat të zbukuruar mirë. Duke lënë mënjanë sferat e gjëra të këtij administrimi të gjithëmëshirshëm autoritar. Por kjo është shpjeguar e vërtetuar në pjesë të rëndësishme të Risalein-Nurit të tilla si *“Fjala e dhjetë”*. Ne do të tregojmë, nëpërmjet një metafore, një faqe të vetme dhe një fazë të atij administrimi, siç ai tregon vetveten në pranverë në faqen e tokës.

Le të supozojmë, për shembull, se një njeri i madh, i mrekullueshëm do të formonte një ushtri të përbërë nga katërqindmijë grupe të ndryshme e nacionalitete; të gjitha furnizimet e veshmbathjet, armët, instruksionet, shpërndarjet dhe rrogat e çdo grupi dhe nacionaliteti të ishin veç e veç të ndryshme, pa ndonjë defekt e gabim, pa të meta e mangësi, në rregullin më të madh dhe në formën më perfekte, në kohën e duhur, pa vonesë e ngatërresë. Asnjë shkak përveç fuqisë së jashtëzakonshme të Atij komandanti të mreku-llueshëm nuk mund të shtrijë duart e tij që të shkelë e cënojë atë administratë të gjërë, komplekse, të hollë, të balancuar, të madhe e të drejtë. Në qoftë se ndonjë shkak do të shtrinte duart e tij, padyshim do të shkatërronte ekuilibrin e do të shkaktonte ngatërresë.

Kështu ne shikojmë me sytë tonë, se një dorë e padukshme, krijon dhe administron në çdo pranverë një ushtri të madhe të përbërë nga katërqind mijë specieje të ndryshme. Pastaj në stinën e vjeshtës, që është një model kijameti, treqind mijë nga katërqind mijë lloje nga bimët dhe kafshët shkarkohen nga detyrat e tyre dhe vazhdojnë të largohen nëpërmjet aktivitetit të vdekjes e në emrin e vdekjes.

Në pranverë, një shembull i tubimit që ndjek ringjalljen, treqindmijë shembuj të ngritjes nga vdekja shkaktohen të dalin në një hapësirë kohore prej pak javësh, me rregullin dhe disiplinën më

të madhe. Në rastin e pemës, tre ringjallje të tilla ndodhin përsa i përket vetë pemës; gjethet e saj, lulet dhe frutet e saja. Pranvera shfaqet para syve tonë tamam si pranvera e kaluar dhe çdo specie e grup në atë ushtri lavdie që përmban katërqind mijë lloje të ndryshme, i jepet mbështetja e saj e përshtatshme dhe furnizimi, armët e saj mbrojtëse, rrobat e dallueshme e të përshtatshme për të, urdhëresat dhe tërheqjet dhe të gjitha pajimet dhe instrumentet që i nevojiten, me rregullin dhe disiplinën më të madhe, pa gabim e defekt, pa ngatërresë e mangësi, në mënyrë të paparashikuar dhe në kohën e duhur. Kjo vërteton brenda përsosmërisë së Hyjnisë, Sovranitetit, Urtësisë, Unitetit dhe Njësisë dhe shkruan urdhërin e Unitetit të Zotit të Lartësuar në faqen e tokës, në çdo faqe të pranverës me lapsin e Kaderit (paracaktimit).

Pasi lexoi një faqe të vetme të këtij urdhëri pranveror, udhëtari ynë iu drejtua shpirtit të tij duke i thënë:

Tortura e ferrit është thjeshtë drejtësi për ata që kryejnë mëkatin e mohimit të ringjalljes, sepse një mohim i tillë do të ishte të refuzosh shumë premtime e të mohosh fuqinë e të Plotëfuqishmit Absolut. Sunduesit dhe dënuesit, të rreptë, i Cili u ka premtuar dhe siguruar të gjithë pejgamberëve të Tij mijëra herë, dhe e ka parashtruar në mijëra versete të Kur'anit të shprehur qartë e me nënkuptime, se Ai do të bëjë ringjalljen dhe tubimin që është shumë më i lehtë për Të se sa mijëra tubime të mahnitshme që ndodhin çdo pranverë, secila më e mrekullueshme se sa Tubimi i madh.

Shpirti i Tij u përgjigj: Ne besojmë në ate që Ti thua.

E VËRTETA E KATËRT

Është ajo shkallë e tridhjetë e tre, është e vërteta e Gjithëmëshirës dhe dhënies së furnizimeve, domethënë, t'u dhurosh mbi të gjithë faqen e globit, brenda tokës, në ajrin sipër saj dhe në oqeanin përreth saj, të gjitha qenieve të gjalla, veçanërisht atyre të pajisura me shpirt dhe midis tyre veçanërisht të pafuqishmëve, të dobtëve, e të vegjëlve; t'u japësh të gjithë ushqimin e tyre të domosdoshëm, moral e material në mënyrën më të kujdesshme duke i nxjerrë nga dheu i thjeshtë e i thatë, nga copa druri të thata si kocka dhe veçanërisht nxjerrja e ushqimit më të hollë midis gjakut e urinës, në kohën e duhur, në mënyrë të rregullt, pa ndonjë mangësi e ngatërresë që ndodh përpara syve tanë nëpërmjet një dore nga bota e padukshme.

Po, ajeti:

إِنَّ اللَّهَ هُوَ الرَّزَّاقُ ذُو الْقُوَّةِ الْمَتِينُ ﴿٥٨﴾


“Zoti është Furnizuesi dhe Zotëruesi i forcës së pafund.” (Kur'an, 51: 58) përkufizon për Allahun e Lartësuar detyrën e furnizimit dhe sigurimit të mjeteve të jetesës për të gjitha gjallesat.

Dhe ajeti:

وَمَا مِنْ دَابَّةٍ فِي الْأَرْضِ إِلَّا عَلَى اللَّهِ رِزْقُهَا وَيَعْلَمُ مُسْتَقَرَّهَا  
وَمُسْتَوْذَعَهَا كُلٌّ فِي كِتَابٍ مُبِينٍ ﴿٥٩﴾

“Nuk ka ndonjë gjë që lëviz sipër tokës veçse varet tek Zoti për furnizimin e saj, Ai e di vendqëndrimin e saj dhe vendin e depozitimit të saj, gjithçka është në një libër të qartë.” (Kur'an, 11: 6)

Sjell një garanci dhe premtion të japë furnizime për të gjithë njerëzit dhe kafshët. Po kështu verseti:



وَكَايِنٍ مِّنْ ذَاتِنَا لَا يَحْمِلُ رِزْقَهَا اللَّهُ يَرْزُقُهَا وَإِيَّاكُمْ  
وَهُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ

“Kafshët nuk e sigurojnë ushqimin e tyre, Zoti i ushqen ato dhe ju, dhe Ai është Gjithë-dëgjues, i Gjithëditur.” (Kur'an, 29: 60)

vërteton dhe shpall se është Zoti i Lartësuar i Cili garanton dhe mbështet të pafuqishmit, të pamundurit, të dobëtit dhe krijesat e mjera që s'kanë mundësi të sigurojnë ushqimin e tyre. Zoti i Lartësuar ua sjell në një mënyrë të papritur, në të vërtetë, nga e padukshmja ose nga asgjekundi.

Për shembull, Ai që mban insektet në shtratin e oqeanit të cilat ushqehen pa asgjë dhe të gjithë të vegjëlve të tyre që u vjen furnizimi nga s'merret me mend. Kjo shpallje u drejtohet në mënyrë të veçantë atyre njerëzve të cilët adhurojnë shkaqet dhe janë të pavetëdijshëm se është Ai që sjell furnizime nga prapa perdes së shkakësisë.

Shumë versete të tjera të Kur'anit dhe pjesë të panumërta të dëshmisë së Kozmosit demonstrojnë me unanimitet se është mëshira e Furnizuesit të vetëm të Gjithëlavdishëm që ushqen e mban gjallesat.

Tani, pemët kërkojnë një formë të veçantë ushqimi, mirëpo nuk kanë as fuqi, e as dëshirë. Atëherë ato mbeten në vendet e tyre, duke besuar në Zotin e Lartësuar dhe furnizimi i tyre vjen duke shpejtuar për tek ata. Gjithashtu furnizimi i të vegjëlve gufon për gojat e tyre nga pompat e vogla të mrekullueshme të ndihmuar nga përkujdesja dhe butësia e nënave të tyre dhe ndërprerja e menjë-hershme e atij furnizimi sapo ata të fitojnë një pjesë mundësie dhe diçka nga zgjedhja dhe dëshira.

Këta shembuj të ndryshëm provojnë shkakun se furnizimi i ligjshëm nuk është rezultat i dëshirës dhe fuqisë, por si rrjedhojë r dobësisë dhe e pafuqisë që shkaktohet nga besimi në Zot.

Dëshira, fuqia dhe zgjuarësia shpeshherë nxisin lakmi e cila është burim humbjeje, dhe shpesh i shtyn disa njerëz të shkolluar drejtë një forme poshtërimi e lypjeje, ndërsa dobësia besëplotë e një njeriu të pagdhundur, të trashë e të rëndomtë, mund t'i shkaktojë atij të fitojë pasuri saqë është bërë proverb:

كَمْ عَالِمٍ عَالِمٍ أَعْيَتْ مَذَاهِبُهُ ۖ وَجَاهِلٍ جَاهِلٍ تَلَقَّاءُ مُرْزُوقًا

“Sa e sa të ditur janë munduar më kot, dhe sa e sa të paditur janë gjetur të pasuruar” vërteton se furnizimi hallall nuk fitohet nga fuqia dhe dëshira, por nga mëshira që e gjen punën dhe përpjekjen të pranueshme; ajo fuqi dhurohet nga butësia që ka keqardhje për ato që kanë nevojë.

Tani furnizimi e ushqimi është dy llojesh. I pari është i vërtetë dhe furnizim i natyrshëm që kërkohet për jetën dhe garantohet nga Zoti i Lartësuar.

Është në të vërtetë kaq e rregullt dhe e mirë-organizuar sa që ky ushqim i natyrshëm i depozituar në trup, në formën e yndyrës dhe gjërave të tjera, është i mjaftueshëm të sigurojë mbijetesën për të paktën njëzet ditë edhe sikur të mos hajë asgjë. Ata që në dukje vdesin nga uria para njëzet ose tridhjetë ditësh para se të shterojë ushqimi i tyre natyror, në realitet, nuk vdesin nga mangësia e ushqimit, por nga një sëmundje që vjen nga trazira dhe lënia e një zakoni të caktuar të tyre.

Forma e dytë e furnizimit, furnizimi është metaforik dhe artificial që buron nga zakoni i prishjes dhe keqpërodrimit, por duke marrë aparençën e domosdoshmërisë. Kjo formë nuk garantohet nga Zoti i Lartësuar, por varet në bujarinë e Tij. Ndonjëherë Ai mund të mos e jap atë. Në lidhje me formën e dytë të furnizimit dhe ushqimit, është i lumtur ai që vlerëson ekonominë e tij, Ai që di se kënaqësia me atë që ke dhe përpjekja në hallall janë burim i lumturisë e i gëzimit, janë një formë adhurimi dhe një lutje aktive për të fituar furnizim. Ai pranon mirësinë e Zotit të Lartësuar me mirënjohje e vlerësim dhe kalon jetën e tij në mënyrë të lumtur.

I mjerë në këtë furnizim është ai që heq dorë nga përpjekja hallall, që prish pa hesap e që ka lakmi të cilat janë burim mjerimi, humbjeje e dhembjeje dhe që e kalon jetën e tij duke trokitur në çdo derë me përtaci, shtypje e ankesa.

Ashtu si stomaku që kërkon ushqim, gjithashtu edhe aftësitë e holla dhe shqisat e njeriut kërkojnë ushqimin e tyre nga Furnizuesi i Mëshirshëm dhe me mirënjohje e marrin atë. Secilit nga ato veçmas dhe në formë të përshtatshme i paraqitet një ushqim i tillë nga thesari i mëshirës që do t'i gëzojë e do t'u japë kënaqësi. Në të vërtetë, Furnizuesi i Gjithëmëshirshëm me qëllim që t'u japë atyre furnizim në sasira të mëdha, Ai ka krijuar secilën nga aftësitë e holla të njeriut- syrin, veshin, zemrën, imagjinatën dhe mendjen në formën e një çelësi për thesaret e Tij të mëshirës. Për shembull, syri është një çelës për thesarin që përmban një xhevahir të tillë e të çmueshëm si stolia e bukuria për t'u parë në faqen e krijimit. Edhe organet e tjera të holla që u përmendën, secila është një çelës për një botë të veçantë prej të cilës përfitojnë me anë të besimit. Atëherë le t'i kthehemi temës sonë.

Qenia e Gjithëditur dhe e Plotë, që krijoi Kozmosin, gjithashtu krijoi jetën si përmbledhje gjithëpërfshirëse të Kozmosit dhe përqëndroi të gjitha qëllimet dhe treguesit e Emrave të Tij aty. Po kështu brenda botës së jetës Ai e bëri ushqimin një qendër gjithëpërfshirëse të aktivitetit dhe krijoi brenda qenieve të gjalla shijen për furnizim duke i shkaktuar kështu gjallesat t'i përgjigjen Hyjnisë së Tij e ta duan me mirënjohje të përherhshme e universale, me falenderime dhe adhurim që është një nga qëllimet domethënëse dhe një nga shembujt e urtësisë së brendaqenësishme në krijimin e Kozmosit. Për shembull: është një nga aktivitetet e Hyjnisë që i shkakton çdo zone të botës së gjërë të Hyjnisë të gëzohen - veçanërisht qiejve u është bërë të kënaqen me engjëj e me qenie shpirtërore; bota e padukshme me shpirtëra, dhe bota materiale, veçanërisht ajri dhe toka me ekzistencën e të gjitha qenieve të gjalla, sidomos me zogj të mëdhenj apo të vegjël në të gjitha kohët dhe vendet. Përmes urtësisë së kësaj duke u mundësuar të kënaqen e duke u ngjallë jetën dhe shpirtin. Kafshët dhe njerëzit janë sikur të fshikulloheshin me kamxhik nga nevoja për

furnizim, dhe kënaqësia që ato gjejnë për të shkuar në kërkim të ushqimit dhe mjeteve të jetesës duke u çliruar kështu nga dembelia. Kjo është gjithashtu nga aktivitetet me urtësi të Hyjnisë.

Po të mos ishte (për shkak të atyre shembujve të urtësisë), ushqimi i caktuar për kafshë do të shkactohej instinktivisht të shpejtonte drejt tyre për të kënaqur nevojat e tyre, pa ndonjë mundim nga ana e tyre, ashtu si furnizimi dhe ushqimi që u shkactohej që të shpejtojnë për t'i dhënë ndihmë pemës.

Po të gjendej një sy e të ishte i mundur për të dëshmuar e përfshirë të gjithë faqen e tokës në një kohë të vetme, me qëllim që të kapë bukurinë e Emrave të Furnizuesit Mëshirëplotë dhe dëshminë që ato japin për Njësinë, ai sy do të shihte se çfarë bukuri e ëmbël përfshihet në dhembshurinë dhe në treguesin e përkujdesjes së Furnizuesit Mëshirë-plotë, i Cili në fund të dimrit, kur furnizimi i tyre është gati në mbarim, u dërgon karvanëve të kafshëve ushqime e mirësi të ndryshme që nxirren vetëm nga thesari i padukshëm i Mëshirës së Tij, si ndihmë nga e padukshmja dhe bujaria Hyjnore e vendosur në duart e bimëve, në kurorat e pemëve dhe të varura në gjoksat e nënave. Ai që do ta kishte ate sy gjithëshikues, do ta kuptonte këtë.

Prodhimi i një molle të vetme që t'ia dhurosh një njeriu, si një furnizim të vërtetë, kjo mund të realizohet vetëm nga Qenia, që shkakton stinët, netët dhe ditët dhe që shkakton globin të rrotullohet si një anije tregtare dhe kështu u sjell frutat e stinëve miqve të nevojshëm të tokës që janë në pritje për to. Sepse shenja e mjeshtrisë, vula e urtësisë, stampoja e përjetësisë dhe vula personale e mëshirës që duhet të gjendet në sipërfaqen e mollës duhet të gjendet gjithashtu tek mollat dhe frutat e tjera si dhe te bimët e kafshët. Kështu pronari i vërtetë dhe Krijuesi i mollës duhet të jetë pronari i lavdishëm dhe Krijuesi Hirplotë i të gjithë banorëve të botës dhe i

vëllezërve të mollës, Krijuesi i tokës së gjerë që është kopshti i mollës, i pemës së Kozmosit që është fabrika e saj, i stinëve që janë punishtja e saj; pranverës dhe verës që janë vendi i saj i pjekjes. Me fjalë të tjera, çdo frut është një vulë e Njesisë, që demonstroi ekzistencën e Njesisë së shkruarit dhe Bërësit të tokës dhe e librit të Kozmosit që janë pema dhe kopshti ku rritet fruti.

Frutat tregojnë dekretin e Njesisë që i ka vulosur me vula konfirmimi të shumta sa numri i frutave. Meqenëse Risalein-Nuri është treguesi i emrave *“I Gjithëditur”*, *“I Gjithëmëshirshëm”* dhe i shumë shkëlqimeve dhe mistereve të së vërtetës së mëshirëgjërësisë, dhe meqë janë shpjeguar e vërtetuar në shumë pjesë të kësaj veprë, ne ia lëmë asaj diskutimin e mëtejshëm të çështjes dhe mjaftohemi këtu me një aluzion të shkurtër nga thesari i madh për shkak të rrethanave të papërshtatshme nga të cilat po vuajmë. Udhëtari ynë tani tha: *“El hamdu lil-lah”* (*Lavdia i takon Zotit të Lartësuar!*)

Unë kam parë e dëgjuar tridhjetë e tre të vërteta që dëshmojnë domosdoshmërinë e Ekzistencës, e Njesisë së Krijuesit, dhe të Sovranit të Vetëm, për të Cilin kam pyetur e kërkuar në çdo vend. Secila nga të vërtetat është brilante dhe nuk lë pas errësirë; është aq e fortë dhe e patundshme sa një mal. Secila nga ato, në sigurinë e saj, jep dëshmi vendimtare për ekzistencën e Tij dhe në gjithëpërfshirjen e saj provon Njësinë e Tij në mënyrë të qartë, duke provuar kështu në mënyrë të plotë të gjitha shtyllat e besimit.

Tërësia dhe konsensusi i këtyre të vërtetave i ndihmon besimit tonë të avancojë nga imitimi në konceptim të drejtë, nga ky konceptim i drejtë në njohurinë e sigurtë, nga njohuria e sigurtë për tek vizioni i sigurisë dhe nga vizioni i sigurisë të identitetit me sigurinë. Lavdia i takon All-llahut, kjo është nga mirësia e Zotit tim.

وَقَالُوا الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي هَدَانَا لِهَذَا وَمَا كُنَّا لِنَهْتَدِيَ  
لَوْلَا أَنْ هَدَيْتَنَا اللَّهُ لَفَدَّجَاءَتْ رُسُلٌ مِنَّا بِالْحَقِّ

Lavdi Zotit që na drejtoi te kjo. Sigurisht ne nuk do të ishim drejtuar po të mos na kishte drejtuar Zoti dhe të dërguarit e Zotit na kanë sjellë të vërtetën.” (Kur'an, 7: 43)

Një aluzion shumë i shkurtër për dritat e besimit të përfituara nga udhëtari ynë meditues prej të vërtetave sublime që ai i dëshmoi tek vendqëndrimi i tretë është folur në kapitullin e dytë të vendqëndrimit të parë, që lidhet me të vërtetat e vendqëndrimit të tretë.

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْوَاحِدُ الْأَحَدُ الَّذِي دَلَّ عَلَى وَحْدِيَّةِ فِي وُجُوبِ وُجُودِهِ  
مَشَاهِدٌ عَظَمَتْ إِحَاطَتُ حَقِيقَتِهَا تَقَاتِجَتِ بِنَجْمِ الصُّورِ لِأَدْمِجِ  
مَاتِ الْفِ نَوْعٍ مِنْ دَوَى الْحَيَاتِ الْمُكَمَّلَةِ بِأَفْصُورِ بِشَهَادَتِ  
قَوْلِ النَّبِيَّاتِ وَالْحَيَوَانِ وَكَذَا مَشَاهِدٌ عَظَمَتْ إِحَاطَتِ حَقِيقَتِ  
أَرْحَمَائِيَّتِ الْوَاسِعَةِ الْمُنتَظِمَةِ بِأَنْفُصَانِ بِالشَّاهِدَاتِ وَالْعِيَانِ  
وَكَذَا مَشَاهِدٌ عَظَمَتْ حَقِيقَتِ الْإِدَارَةِ الْمُحِيطَةِ لِجَمْعِ دَوَى  
الْحَيَاتِ وَالْمُنْتَظِمَةِ بِأَخْطَاءِ وَلَا أَنْفُصَانِ وَكَذَا مَشَاهِدٌ عَظَمَتْ  
إِحَاطَتِ حَقِيقَتِ الرَّجِيمِيَّتِ وَالْإِعَاشَةِ الشَّامِلَةِ لِكُلِّ الْمَرْفُوقِينَ

أَلْفَنَنْتَهُ فِي كُلِّ وَقْتِ الْحَاجَةِ بِلَا سَهْوٍ وَلَا نِسْيَانٍ ﴿٥﴾ جَلَّ جَلَالُهُ رَزَقَهَا  
 الرَّحْمَنُ الرَّحِيمُ الْحَنَانُ النَّسَانُ وَعَمَهُ نَوَالُهُ وَسَمِلَ إِحْسَانُهُ وَلَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ  
 مُحَمَّدٌ أَنْكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ لَنْزِيلُ الْعِلْمِ الْحَكِيمِ  
 يَا رَبِّ بِحَقِّ بَشِيرِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ يَا اللَّهُ يَا رَحْمَنُ يَا رَحِيمُ صَلِّ  
 وَسَلِّمْ عَلَى سَيِّدِنَا مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِهِ وَآخِصَائِهِ أَجْمَعِينَ بِعَدَدِ جَمِيعِ  
 حُرُوفِ رِسَائِلِ الثُّورِ الْمَضْرُوبِ تِلْكَ الْحُرُوفِ فِي عَاشِرَاتِ دَقَائِقِ  
 جَمِيعِ عُسْرِنَا فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ مَعَ ضَرْبِ تَجْمُوعِهَا فِي ذَرَاتٍ وَجُودِي  
 فِي مَدَّتِ حِكَايَ وَأَعْرِضْ لِي وَلِيَّنْ يُبَيِّنِي فِي نَشْرِ رِسَائِلِ الثُّورِ وَ  
 كِتَابَتِهَا بِصِدَاقٍ بِكُلِّ صَلَاةٍ مِنْهَا وَلَا بَأْسًا وَلَا سَادَاتِنَا  
 وَشُؤْمُونَنَا وَالْآخِرَاتِنَا وَالْأَوَّلَاتِنَا وَلِطَلْبَةِ رِسَالَةِ الثُّورِ الصَّادِقِينَ وَ  
 بِالْخَاصَّةِ لِمَنْ يَكْتُبُ وَيَسْتَسْمِعُ هَذِهِ الرِّسَالَةَ بِرَحْمَتِكَ يَا أَرْحَمَ  
 الرَّاحِمِينَ آمِينَ وَآخِرُ دَعْوَانِي لِلْمُحَمَّدِيِّينَ الْعَالَمِينَ

Nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut të vetëm e të pashoq. Domosdoshmërinë e ekzistencës së të cilit në Njësi e tregon shikimi i madhështisë së gjithëpërfshirjes së të vërtetës së Hapjes, përmes zbulimit të formave të ndryshme të katërqindmijë specieve të gjallesave me perfeksionim e pa defekt, sipas dëshmisë së biologjisë dhe botanikës; e tregon shikimi i madhështisë së gjithëpërfshirjes së të vërtetës së mëshirëgjërësisë që ka përqafuar gjithçka, me rregull e pa

mangësi, siç mund të shohë syri; e tregon shikimi i madhështisë së të vërtetës së administrimit, përfshirjes ,në mënyrë të rregullt të të gjitha gjallesave pa asnjë gabim e të metë; shikimi i madhështisë së gjithëpërfshirjes së të vërtetës së mëshirëgjërësisë dhe furnizimit duke përqafuar të gjithë konsumatorët e ushqimit në çdo kohë pa ndonjë gabim e harresë. Lavdi i takon Zotit, për Ushqyesit dhe Furnizuesit e Gjithëmshirshëm, të Kujdesshëm e Bujar, dhuratat e Tij janë

universale, bujaria e Tij është gjithëpërfshirëse, لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut, Lavdia të takon Ty o Zot! Ne nuk kemi njohuri përveç asaj që na ke mësuar, sigurisht Ti je i gjithëdijshtëm e i Urtë.

O Zot! Për hir të Bismil-lahirr-Rrahmanirr-Rrahimit, O Zot! O i gjithëdijshtëm, o Mëshirëplotë, jepi paqë e bekime Shkëlqesisë sonë, Pejgamberit Muhammed (*sal-l All-llahu alejhi ve sel-lem*), familjes së tij dhe shokëve të tij sa numri i shkronjave të Risalein-Nurit të shumëzuara me dhejtë herë dhe sa numri i të gjithë jetëve tona në këtë Botë dhe në Ahiret dhe pastaj të shumëzuara me numrin e grimcave të trupit tim gjatë gjithë jetës sime. Më fal, o Zot, mua dhe ata që më ndihmojnë me sinqeritet në kopjimin dhe shpërndarjen e Risalein-Nurit.. Veçanërisht ata që shkruajnë dhe kopjojnë këtë trajtesë. Me mëshirën Tënde, o Mëshiruesi më i madh. Amin! Përfundimi i lutjes sonë është: Falenderimi dhe lavdërimi I takon vetëm All-llahut, Krijuesit të të gjitha botërave!